



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pravur - Prilloga Më/Dana <u>23-01-2024</u> vitet			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Droj	Shtetë Prilog	Vlera Vendimesit
01-	060/01-		93



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e I të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **30.01.2024 (e Martë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## Rendite

1. a. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Kuvendit Komunal,  
b. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal e datës 13.01.2024
2. Informatë (raport) e punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar-dhjetor 2023.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2024.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Budrik të Epërme.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2024.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronat e paluajtshme ne pronësi te pronareve Kadri (Bislim) Emerllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim të vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë, vendimi me Nr. 01-110/05-49935 i datës 27.12.2023
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2026 të Komunës se Vitisë, vendimi me nr. 01-110/05-163, i datës 01-03-2023.
9. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2023.
10. Informatë mbi punën e komitetit për komunitete të komunës së Vitisë për periudhën Janar - Dhjetor 2023.
11. Informatë për zbatimin e planit te KKS-së për vitin 2023.

Viti, më 23.01.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJËS SË NJËMBËDHJETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 26.12.2023 (e martë) në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti, nënkryetari z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, z.Sokol Shaqiri, znj.Valentina Mehmeti, znj.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami,znj.Arbnora Hajredini, znj.Marigona Avdiu, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emimi, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, z.Veton Ramadani, znj.Zyrafete Rama, znj.Anisë Zejnullahu, z.Reshat Azizi, ndërsa mungoi, z.Ekrem Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike. Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**z.Bekim Azizi Kryesues i Kuvendit:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhë në mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal. Po fillojmë me seancën e fundit për këtë vit, duke ju faleminderuar për punën, angazhimin, kontributin gjatë tërë vitit në të gjitha pikat, në çdo seancë. Meqenëse është seanca e fundit, kemi shumë pika, materialin e keni marrë me kohë, do të kyqemi menjëherë. Pasi që kemi edhe planin zhvillimor komunal, kemi marrë një pjesë të mirë konfirmimin e ligjshmërive, nuk kemi asnjë ligjshmëri që na është kthyer, që është kundër ligjit. Vendimet që janë votu në kuvend, vendimet që i kemi sot, është një përmirësim. Pjesa e vendimit që kemi bërë para 2 seancave për trafo, kemi dhe një pikë, disa mjete të buxhetit që i kemi bartur në seancën e kaluar kanë shkuar në ministri të financave dhe ende nuk na është kthyer ligjshmëria. Po e presim, ndërsa tjerat janë konfirmuar, para se me hy në rend të ditës, pyetje dhe përgjigje. E dimë që në kohë të fundit është problematike çështja e furnizimit me energji elektrike. Sot para KEDS-it kanë protestu të paralajmëruara fshati Drobesh dhe Smirë, që më kanë bërë kërkesë dhe ne të bëjmë pjesë, mirëpo për shkak të seancës kemi tregu që ne do t'i përkrahim dhe t'i bëjmë thirrje KEDS-it, që të marrë masa, që të ketë energji elektrike, sepse për shkak të ngarkesave janë tu pas probleme një pjesë e madhe e vendeve, fshatrave dhe lagjeve në komunën tonë. Hapi diskutimin me pyetje përgjigje.

**z.Illir Zuka:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam 2 kërkesa prej banorëve të Pozheranit. Është rruga "Ibrahim Pira", që është në projekt prej 2021 dhe ende nuk është asfaltu. Për befasi ajo rrugë mbi 90% është e mërgatës dhe çdo here që vijnë mërgata, na kujtojnë që duhet me u asfaltu. Nuk e di çka ka ndodhur, pse nuk është asfaltu. E di që nënkryetari tha, ka mi thirrë dhe inxhinierat në Kuvend, por nuk po i shof këtu. Dashta të ju drejtohem atyre se, ne kemi dalë 2 vite radhazi, kemi bërë matjen e rrugës, kemi planifikuar, por me u asfaltu nuk është asfaltu. Problemi i dytë vazhdon tek "Lagjia e Muhaxherëve", që lidhë Sllatinën e Poshtme, Sllatinën e Epërme me kanalizimin që derdhet në kanal dhe po vazhdon të dëmton hektar të tërë. Dhe tjetra është një shqetësim. Në seancën e kaluar mbi gjysma e seancës nuk ka pas zë. Nuk është problemi apo dëgjohem unë a nuk dëgjohem, por besoj se shumë asamblast. Kush e ka ndëgju Plus Televizionin nuk ka dhanë zë hiq. D.m.th ne vetëm e kemi mbajtur mikrofonin, jemi parë në fotografi, por nuk na është dëgju zëri.

**z.Ali Bajrami:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Seanca e fundit e vitit 2023, nuk do të kem pyetje. E

morra fjalën në emër të grupit, të gjithë asamblistëve të ja uroj festat e fundvitit. Ju dëshiroj një vit të mbarë, të suksesshëm, personale dhe për familjet e juaja gjatë vitit 2024.

**z.Majlinda Shabani:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë i kam 3 çështje të cilat dua t'i adresoj në Kuvend dhe çështja e parë lidhet me një shqetësim të fermerëve të Komunës së Vitisë, të cilët kanë përfituar sivjet mekanizëm bujqësorë, përkatsisht nga Drejtoria e Bujqësisë, thujse shumica e përfituesve të këtyre pajisjeve bujqësore janë anku për cilësinë e dobët të makinave që kanë marr nga komuna, ku edhe kanë participu për këto subvencione, madje disa prej tyre thonë që nuk e dinë as prej nga janë prodhu, andaj unë kisha kërku një sqarim nga Drejtoria e Bujqësisë për këtë çështje, për cilësinë e këtyre pajisjeve, si janë siguru nga Komuna, sa është buxheti që ka shku për këto subvencione. Çështja e dytë ka të bëjë me KKSJ-në. Në bazë të informatave që kemi në mbledhjen e fundit, z.Husamedin Hoxha nuk ka qenë prezent në këtë mbledhje. Pyetjen ja adresoj nënkryetarit, se a ka pas ftesë zyrtare, z.Husamedin Hoxha për me marrë pjesë në atë mbledhje. Nëse nuk ka pas ftesë: a mendoni që keni bërë vendim insitucional dhe legjitim që ju ka pamundësu pjesëmarrja? Meqenëse e dimë që është shumë i rëndësishëm për sigurinë e qytetarëve në përgjegjësi. Pyetja tjetër ka të bëjë me një shqetësim lidhur me investimet e fundit, sepse kemi përmend shumë. E dimë që në fshatin Dobëllde shkolla është e mbyllur, atje është një fushë sportive e cila është ndërto tani e një vit. Meqenëse shkolla është e mbyllur, fusha sportive përpos kualitetit të dobët që ka pas, d.m.th nuk është funksionale dhe nuk është e përdoret nga fshati, andaj pyetja ime është çfarë planifikimi bëni ju në këtë rast për investime, dhe sa është ai planifikim afatgjatë, sepse kemi parë që fshati Dobëlldeh kohëve të fundit ka pasë problem edhe me çështjen e rrugëve, ku për shkak të dëborës ju është pamundësu me kalu qytetarët aty.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë deshta të lidhem me parafolsen, kolegen Majlinda Shabani. Unë e pash që e ka mbajt mbledhjen e 7 të KKSJ-së dhe 3 anëtarë të saj e kanë lëshu mbledhjen. Tani nuk pe di për çfarë arsye e kanë lëshu mbledhjen. Unë i pash dhe emrat i kam dëgju përmes mjeteve të informimit. A ka qenë për shkak se disa persona që kanë dashtë me qenë aty nuk janë fitu. Po është mirë me ditë se çdo informatë që e kam marrë e kam marrë prej Tv Plusit. Kështu diçka më konkrete nuk di. Unë para disa seancave kam diskutu këtu për një kompani e cila ka operu dhe ka marrë për hartimin e hartave zonale UBT. Sipas informatave që kam unë tash, është shkëput një marrëveshje me UBT-në. Unë më herët kam thanë që, UBT-ja është një kompani e konsultimeve, që në Viti po bënë eksperimente, se është për herë të parë dhe tani po më duket sipas informatave që kemi shkëputje të kontratës. Dua ta di a kemi apo jo? Është e 10-ta seancë që foli për lagjen time, aty ku jetoj unë, rruga "Hasan Prishtina" saktësisht rruga e Pozheranit, ku ne kemi problem për një trafo, rrymën e kemi aq të dobët, sa në katin e parë kemi rrymë në të dytin jo. Ne e kemi dërgu një kërkesë edhe tek KEDS, por pa inicimin e pushtetit lokal nuk besoj që shpejtohet, që aty të kemi trafë. Është një ndër lagjet më të banushme të Komunës së Vitisë, që ju mungon një trafë e rrymës. Po ta thamë më shumë përgjegjësi nënkryetar, duhet pak edhe ndihma e inicimi juaj që trafo të vie sa më shpejtë në lagjen "Hasan Prishtina".

**z.Zyrafete Rama:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! E nderuara drejtoresha e arsimit, unë dua të shpreh një shqetësim që kam marrë nga shumë koleg të mi të arsimit. Siç e dimë, përgjegjës për arsimin fillor dhe të mesëm të ulet në Komunën e Vitisë është Drejtoria e Arsimit dhe për këtë ekziston një rregullore për sjellje dhe deciplinën e nxënësve, e cila rregullore është miratuar në vitin 2014 po në këtë Kuvend. Kjo rregullore ka nevojë urgjente për plotësim ndryshimin, pasi që nga viti 2014 ka ndryshim të madh në sistemin arsimor. Andaj nga ju kërkoj drejtoresh që, nga janari i vitit 2024 të filloni rishikimin e kësaj rregullore për plotësim ndryshimin, sepse ka nevojë.

**z.Musli Neziri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Fillimisht ju uroj festat e krishtlindjeve për të gjithë shqiptarët e besimit katolik. Gjithashtu ju uroj mirëseardhje dhe diasporës sonë, e cila është një aset për Komunën tonë dhe mbarë Kosovën, që të kalojnë sa më mirë pranë familjeve të tyre për këtë fundvit. Unë kam 2 pyetje rreth ndriçimit publik. Pyetja parë, ndriçimi publik rreth rrugës "14 Qershori", apo si e quajmë ne, nga poligoni rruga që shkon në drejtim të Pozheranit, që është lidhë së fundmi me asfalt ajo rrugë duke parë që është kry si asfalt i ri. Gjithashtu ju kanë ndërru edhe komplet dritat e ndriçimit nga kompania kontraktuese dhe ka punu 2-3 ditë

ndriçimi dhe më nuk ka punu fare. Për këtë kam kontakti dhe kam ngritë si shqetësim edhe te drejtoritë që nuk është tu ba ndriçimi. Prapë ai më ka thanë që do të marrim masa, por ndriçim nuk ka. D.m.th janë ndërru dritat, është kry puna nga kompania, ndriçim nuk ka. Pytja dytë, tek ndriçimi i fshatit Ballancë, për arsye se atje është thanë që kur të përfundon trotuari që është përfundu, së paku ne po e shohim që është përfundu me letra. Nuk e di aty ndriçim ende nuk kemi. Si lokalitet jemi mbetë ndoshta lokaliteti i fundit, mos të themë zorrë qorre sa i përket ndriçimit, prandaj kërkesë e qytetarëve të fshatit Ballancë është që të mundësohet, të përfundohet sa më shpejt ky projekt.

**z.Sejdi Emini:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Një çështje për Drejtorinë e Bujqësisë. Disa fermer që janë me të vërtetë fermer që i njoft, personalisht kanë disa shqetësime dhe ankesa. Njëra ndër to është edhe ajo që, mjetet të cila po i përfitojnë, ka raste edhe ka ndodh që i kanë shitë për përfitime personale. Nuk e di sa ka mujtë me i kontrollu Drejtoria e Bujqësisë këto, mirëpo nëse është kështu atëherë është e dhimbshë, sepse humbin ata të cilët punojnë. Pos kësaj, ankesat të cilat i kanë bërë thojnë që Drejtoria e Bujqësisë nuk ka as makinë për me shku me i vizitu këto ankesa të cilat i kanë ato, e kjo është mjaft shqetësuese, kur e dimë që vetëm sa para kemi nda për mirëmbajtje të automjeteve, e mos me pas drejtoria me shku mi vizitu këto ankesa është e pafalshme. E dyta ka të bëjë me një ide që është në interes të Komunës dhe të gjithë qytetarëve të Komunës së Vitisë. Në kohë të fundit nëpër të gjitha komunat po shohim që po bëjnë parkinge nëntokësore dhe po e shohim që komuna jonë hapësirat i ka mjaftë të vogla edhe ka shumë probleme për parkingun e makinave. Do të ishte mirë që të fillohet së paku të bëhet një projekt dhe në të ardhmen të bëhet një parking nëntokësor dhe pse jo ku bëhen parqet. Në parqe, parkinge që do të ishte edhe shumë profitabile për komunën me atë sistemin elektronik të pagesave do të sjelljet mjaftë të hyra, ku do të ishte interes i përgjithshëm. Kam dhe një ankesë të një banori të fshatit Shusht, Aziz Hyseni, pasi që atje është bërë një minihidrocentral, i cili i ka shkatrru mjaft shumë edhe faunën, mirëpo tek shtëpia e tij është vendos një trafo dhe ai është anku që nuk po mund të hy as në oborr me makina të rënda aty dhe po paraqet rreziqe për familjen e tij. Do të ishte mirë të merret kjo kërkesë seriozisht me shqyrtu, se përndryshe ai ishte shumë i mllëfost. Dhe një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Inspeksionit. Më herët disa banorë të fshatit Goshicë kanë bërë një ankesë, ku me atë ankesë jemi marrë personalisht edhe ne. Faktikisht në teren kanë dalë për disa barriera tek shtëpia e Islam Metallarit. Ai ka shqetësim se, banorët mujnë me psu pasoja prej makinave që po vozitin shumë shpejtë aty, mirëpo ka disa kërkesa dhe në disa vende tjera me i bërë, mirëpo me thanë të drejtën, tani është duke më ardh marre me i dal para, sepse i kemi thanë po dhe se kemi bërë, i ka do vite njeri, është mirë me shqyrtu dhe me qu deri në fund.

**z.Remzi Salihu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Dua të ju drejtohem drejtorit për shërbime publike lidhur me sanimin e mbeturinave apo deponive ilegale. E dimë që kohëve të fundit është marrë një aksion dhe disa vende janë sanu këto mbeturina, po megjithatë nuk është bërë pastrimi ashtu siç duhet, është bërë pastrimi në mënyrë të shpejtë apo s' di si ta themë, plus tjetra është që, në ato vende ku janë pastru nuk është vendos tabela që paralajmëron një sanksion nëse ndermerret një veprim i tillë në të ardhmen. Nuk e di a është mëndu në këtë aspekt të vihen tabela të tilla apo është investu në inspektor ku do të jenë më aktiv.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Përshendetje për të gjithë! Ju falënderoj për angazhimet e juaja 1 vjeçar, të cilët unë konsideroj se kishte vendime shumë të rëndësishme të cilët ata u kaluan përmes procedurave të Kuvendit dhe përmes gishtit të juaj. Faleminderit dhe për bashkëpunimin të cilin e kemi pas me relacionin ekzekutiv dhe Kuvendi. Faleminderit për të gjitha adresimet dhe pyetjet të cilat ju drejtohen ekzekutivit. Unë sot e morra fjalën, sepse ingjinerat për të cilët ju kam thanë në seancën e fundit që do të jenë këtu prezent, tani i kemi këtu. Më lejoni që të gjithë bashkëatdhetarëve të ju uroj pushime sa më të mira në shtëpitë e tyre, familjet e tyre. Uroj që viti 2024 të jet vit edhe më i suksesshem për të gjithë popullin shqiptar. Urime edhe Festën e Krishtlindjeve! Majlindë, në seancën e parë do ta sjellin një informatë lidhur me kualitetin dhe me përzgjedhjen e kriterëve. E di, kam dëgju që ka pas shqetësime, po do ta keni një informatë të plotë për këtë. Ishte pyetje për shqetësimin, pse kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame nuk ka marr pjesë në mbledhje të KKS-së. Po e thamë me sinqeritetin më të madh që, unë vazhdoj me qenë unë, pa dashtë me e kërcnu kerkon ai ka qenë i ftuar rregullisht. Në seancën e pestë, unë besoj e keni lexu të gjithë, edhe sjelljet e tij për mua kanë qenë jo konform të

një anëtar i të KKS-së. Kanë qenë qaq ofenduese për mu, kame pritë nga ju që doshta do të merrni iniciativë për shkarkim dhe zëvendësim. Po ju me tepër të kokshi tu interesu pse nuk është thirr, e ai që se kam thirr jam unë, dhe këtu po ju thamë se, aty ku marr pjesë në mbledhje, unë që e kryesoj, ai nuk mundet me marr pjesë. Ai merr pjesë, nuk tham që ai nuk mundet, po ai nëse vjen unë dal. Ai është çështje e kryer, për shkak se unë pranoj çdo sen për të cilën mundeni me i thanë një personaliteti, të njëjtën ditë unë e kam thirr kryesuesin e Kuvendit, e kam njoftu detajisht në zyrën time, ai sa me perket mu, kryetari nuk ka qenë këtu, ka qenë jashtë vendit, e kam njoftu edhe kryemiftium në nivel të Republikës së Kosovës, e kam njoftu edhe kryeimamin në nivel të Republikës së Kosovës dhe ende asnjë përgjigje nuk e kam marr, asnjë punë nuk e kam bë mësheftas. Në përfundim të asaj mbledhje i kam thanë që, unë dhe ti shifem vetëm ne gjyq dhe të njëjtën ditë ja kam bë padinë. Tash gjykata ka me vlerësu. Ndoshta unë jam fajtor, është një ingjizim, për fat të mirë e kam marr ingjizimin e kam dërgu në gjykatë, për shkak se kam mendu se për shkak të bagazhit tim politik po edhe një që e mbaj me vite si pajtimtar, nuk kam dashtë rrugë tjetër me ndjek. Konsideroj rruga me e drejtë u kanë e ndjekjes në vij institucionale. Nuk e kam pas let me e bindë familjen time me e shu si problem mos me u marr në aspekt qyshë dimë ne shqiparët, po megjithatë ja kam arritë dhe ne do të shifemi në gjyq. Udhëzimi administrativ dhe rregullorja nuk thotë që duhet me qenë kryetari i Bashkësisë Islame, po thotë një përfaqësues që ne kurdush jemi në gjendje me pranë cilin dush, por edhe ai që vjen dhe për gabime të veta ofendon në atë rast kryetarin e Komunës, se unë kam qenë duke udhëheq takimin. Konsideroj se edhe juve duhet me ju ardh keq sikur më ka ardh dhe mu për veten time. Në Dobollde, askush ndoshta me marrë periudhën e pas luftes nuk ka mujtë me parapa zbrazen e fshtrave në drjetim të qytetit, dhe nëse marrim në këtë drejtim, nuk kemi mujtë ndoshta edhe ne dhe struktura politike që ka qenë para neve në udhëheqje, por gjendjen e kemi këtë që e kemi dhe tani momentalisht nuk kemi nxënësja që po rrezikohemi ndoshta edhe në 2-3 lokalitete mos me pas. Në KKS kanë qenë 3 të cilët e kanë lëshu mbledhjen. Konsideroj se pasi informacionit të cilët ja kam bërë unë, që kam pas bisedë dhe me kryesuesin e kuvendit, që ma ka dhanë një informacion bukur të mirë, se KKS është një mekanizëm të cilët bekimin e merrë nga Kuvendi komunal, por pozitat e tyre caktohen në bazë të Udhëzimit administrativ dhe kryesuesi me njoftoj në KPF se, tani momentalisht zbatohet Ligji mbi Pagat dhe momentalisht ata nuk paguhen, dhe kur e kam dhanë këtë informacion ata e kanë lëshu mbledhjen, se kanë thënë në rastë se nuk paguhemi ne nuk kemi nevojë me nejt prapë. Kam bërë përpjekje maksimale, se konsideroj e kanë gabim në qendër se ai mekanizëm është formu para 2 viteve dhe duhet me vlejti gjithëhere norma e cila është në favor të palës, në këtë rastë që është dasht mëditjet të ju paguhen nga 50 euro. Kam marrë informacione se, Ministria e Financave qenka tu e përgatit një udhëzim administrativ. Tani a do të ja pagun në mënyrë retroaktive, a do të fillon prej vitit 2024, nuk kam informacion. Me siguri do të ju njoftoj në kohë. Kompania UBT. Taulant, ne kemi pas 2 marrëveshje. Një marrëveshje ka qenë lidhur me hartimin e planit zhvillimor komunal, të cilën e kemi sjellë sot dhe kur e kemi bërë dhe marrëveshjen tjetër për hartimin e hartave zonale, e kishim fiksuar një afat 18 muaj. Në rastë se e marrim periudhën 18 muaj, dhe sot ne jemi diku në përfundim të marrëveshjes, që është e pamundur ne me i hartu, ne jemi obligativ me njoftu se, ky afat ka kalu, dhe në rastë se kalon afati duhet me ardhë deri tek prishja e marrëveshjes. Ende nuk na kanë kthy, por megjithatë procedurën ligjore ne kemi me njëk deri në fund. Taulant, unë besoj se mandati i parë ka qenë një prej mandateve më të frytshme në relacion me KEDS-in, tani ndoshta dhe vetë politika e tyre e zhvillimit dhe ndërtimit të trafëve dhe ndërtimit të rrjetit sikur na ka ngecë, kemi bërë shumë ne si Kuvend Komunal. Kur themë ju si Kuvend Komunal, ne si propozues shumë çështje jemi kanë në gjendje me i rregullu, veç që ata të sjellin investime që me të vërtet qytetarët ta bëjnë një jetë normale, Sa i përket rrymës elektirke, tani është tu na shku kjo punë si me ma vështirësi, ndoshta edhe mungesës së atyre komplikimeve që i kanë financiare vetë KEDS-i, ne do të jemi në ballë të gjitha kërkesave. Sa i përket me kry anën tonë, së bashku me juve, se ne duhet me qitë çdo propozim vendim këtu tek ju. Unë besoj se disa lagje, si lagjja jote e disa janë zhvillu shumë më tepër se që kanë mujtë me i parapa dhe kërkon nevoja tani. Unë kisha thanë që, mirë është me ja drejtu me banorët e lagjes një kërkesë drejtorit të shërbimeve publike, që unë kisha me firmos automatikisht, që ne të jetë kërksa që po kërkohet një trafë për shkak të mungesës së rrymës. Zyrafete, faleminderit për pytjen. Besoj që drejtoresh ishte shqetësim me vend, se koha e bjenë që duhet dhe plotësim ndryshimin e rregullores. "14 qershori", Xhelal, besoj se ti je

menaxher, është një shqetësim i këshilltarit të Kuvendit Komunal, Musli Nezirit, thotë: sa e kanë vendos ndriçimin e ri, kanë bërë zëvendësimin, por është pa ndriçim. Rastet që i kanë shitë mekanizmin bujqësor, unë e di, mund të ndodhë. Kjo që kanë thanë nuk kanë me pas nëse e ka marrë këtë informacion makina me dalë me kqyr vendin e ngjarjes, nuk ndodh, se edhe atëhere kur nuk kemi, jemi në koordinim të plotë me drejtorin e administratës, japim autorizim që me shku me makinë të vetë dhe pse e kemi një gjendje të makinave shumë të vjetruar. Parkingje nëntokësore. Ky propozim është shumë me vend, por kur të bëhet aprovimi i buxhetit në debate, tani besoj jemi vonë, nuk kemi kurrësi mundësi, si ide shumë e qëllumë. Trafo me rreziqe. Unë besoj se i kanë parapa ata gjithë rreziqet, por megjithatë unë si shqetësim do ta ngriti tek shefi për Njësi në Viti dhe me i spjegju se një prej këshilltarëve që ja ka shfaq një familjar ka paraqitë rrezik. Remzi, çështja e tabelave është shumë me vend, dilemë nuk ka, jo vetëm në lokalitet Remnik, por në të gjitha vendet. Unë e di që ndoshta nuk e kanë pas boll efektshmërinë e vetë, por megjithatë ne duhet të mësohemi vazhdimisht, gradualisht mi qitë, edhe pse ndoshta munden me dëmtu, por duhet gradualisht të pajisemi, që në rastë se kemi efekt veç 5% i ndalojmë me atë tabelë vitin e parë. Unë konsideroj se është sukses dhe plotësisht pajtohem se duhet me pas.

**z.Taulant Haxhiu:** Nën kryetar, faleminderit! Unë për KEDS-in do t'i ndër marr hapat menjëherë. Ato që m'i the se, kam kërkesa të vazhdueshme, është hera 10 që e kam bërë si temë këtë. Unë të njoftoj ty që 20 vjet që je në institucione komunale në Viti. Nifesh si njeri institucionalist dhe nifesh si një intelektual që të njeh Viti, por fjalët që i the pak më herët, nuk kam besu që asnjëherë në jetë që thuhet prej teje. Komuna nuk është pronë e jotja, ti je i emruar, unë jam i emruar, dhe me thanë nënkryetari i Komunës për një anëtar që, sa të jem unë ai nuk hinë aty. Kjo fjali nuk më pëlqej. Si me thanë Husamedini, ti shkon të premtën me falë xhuman unë nuk e fali xhuman në qoftë se vejn Hasan Aliu. Njëjtë është, si xhamia si Komuna, nuk besoj që kanë dallim, janë shtëpia të popullit të dyat, edhe komuna shtëpia e qytetareve. Ne jemi këtu disa që jemi pak më eurofirk dhe folim fjalë, por prej Hasan Aliut, këtë fjalë nuk e di, mua më erdh shumë keq, nuk të njoftoj për kështu. A keve euforik si unë në disa raste, nuk e di, veç kjo fjalë e jotja, e nënkryetarit të Komunës nuk është e hijëshme për qytetarët e Komunës së Vitisë. Unë jam djalë i joti me moshë, por këtë fjali ishalla nuk ta dëgjoj më. Po të thotë Taulant Haxhiu, se njifna si rebel i këtij Kuvendi, ashtu më ke quajt disa here, unë mundem me thanë e ti jo. Kurse për UBT-në, ti e dinë që 2-3 here kam diskutu dhe fjalët e mia po duket që dulen.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Unë nuk thashë ai përjashtohet. Aty ku unë udheheqi, dytë nuk mujë. Në rastë se është ai unë dalë. Nuk është e tij, ajo është komunë, mundet me ardhë kur të doj. Taulant, unë kam mëndu që ti mendon ndryshe. Me pas ofendu dikush Taulant Haxhiun kisha marr masa tjera. Unë revoltën e kam në juve, nuk e kam në atë hiq, se ai e ka tregu figurën e vet. Se në rastë se është lendu ndesh kryetari, nënkryetari, kryesuesi, këshilltari i Kuvendit Komunal, ne nuk e mbrojmë personalitetin, Taulantin, duhet me mbrojtë pozitën e këshilltarit, pozitën e kryetarit, nënkryetarit apo kryesuesit në rastë se e dojmë institucionin. Unë konsideroj se është kjo. Faleminderit!

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam 2 pyetje dhe një diskutim të shkurtë. Pyetja është për rrugën "14 Qershori". Unë e kam një ingjizim prej një qytetari që ma ka dërgu dhe shikone vetë tu asfaltu rruga natën dhe këtu shihet që është lloqë. Qështu është gjendja e kësaj rruge të asfaltuar në Viti. Nuk e di a e dini a jo, por unë si informatë po ja u jap dhe në mbledhjen tjetër ka me kërku se, çka keni ndër marr këtu dhe inxhinierat nëse dinë me na thanë nuk e di kush është menaxher aty, por rruga është në këtë gjendje. Për Komunë e kam një pyetje, sa prej projekteve ose tendera janë pa zotim të mjeteve, që punët janë krye dhe pagesat nuk janë bërë. Se kemi informata që ka edhe të tilla dhe kjo që lenë borgje për masandej. Nënkryetar, këtu në shkurt apo mars të vitit të kaluar, këtu ka pas përleshje mes huliganeve që i ka pru komuna këtu. Ne e dimë kush i ka pru dhe kemi diskutu dhe është sulmu asamblisti dhe disa asambleistë, dhe nuk është ndër marr asgjë. Mandej ka pas presion, është mbyll edhe rasti në polici. Si shef i grupit të LVV-së, është sulmu Durim Sylejmani, për shkak të kritikes që e bënë ndaj qeverisjes komunale, nga njerëzit që e dimë se kush, djali i Jakup Haxhiut bashk me Jakup Haxhiun dhe nuk e keni pa të arsishme as me diskutu në Kuvend Komunal. Nuk po më vie mirë as për rastin tëndë që e ke nënkryetar, por që the nuk ke reagu, ju nuk keni reagu as për konfrontime fizike dhe cenim të integritetit dhe fushëveprimt të një pune të asamblistit, një të zgjedhuri të drejtpërdrejt të sovratnit të popullit,

dhe kjo i ndryshon gjerat kogjo shumë.

**z.Ramadan Deliu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë dashta me pyet inxhinierin Xhelalin. Para 2 muajve i kam thanë për ndriçim në Kabash. Ka thanë: kemi me dalë të hanën. Nuk ka dalë askush, as në Kabash as në Binç, as në skej të "Moravës". Ndriçimin krejt e ka prishë ajo kompani që ka punu, e ka prish nuk e ka ndreq. Në Kabash kanë qenë duke bërë kishe po ndërroj, i ka prish. Ku është problemi? A kanë me u ndreq për vitin e ri apo pas vitit të ri? Me naj dhanë një kohë kur.

**z.Illir Zuka:** Kisha pas dëshirë me marrë një përgjigje direkt prej zyrtarit të Zyrës së Prokurimit. Ku ka mbërri procedura për hapjen e kanllit për 3 fshatra, Sllatin e epërme, Sllatin e Poshtme, Pozheran?

**z.Majlinda Shabani:** Çështjen e parë e kam tek shqetësimi i fermerëve të cilën e ngrita unë. Po konsideroj se nënkryetari nuk mundet me pas informacion për sa i përket mekanizmit bujqësorë, por ajo çka është praktike dhe reale është pikërisht ajo që makinat që i kanë marrë, pasi që i kanë marrë i kanë parë që nuk kryen punë ato. Përpos kësaj që është dashtë me participu, e që i bie që kanë shpenzu dhe prej gjepit të tyre, prandaj mua çka po më intereson me ditë se, cilat jan hapat që komuna ka me i marrë në këtë rastë. A kanë me pas fermert që me i kthy ato mjete dhe me u bë një lloj kompenzimi, andaj nëse e shohim tu dashtë me i ndihmu i keni bë më shumë dëme fermerëve, dhe përderisa nuk siguroni se prej ka janë ardh mjetet ose ka janë prodhu, cila është cilësia e tyre, në këtë rastë po e shofë që kjo veç po bëhet sa për sy e faqe dhe me dalë në postime, fejsbuk që po i ndihmojmë fermerët që nuk është fare e vërtet. Dhe e dyta që konsideroj që është mjaft shqetësuse, nënkryetarin nuk e pasim këtu, që shpeshhere çështjet personale mes personave dhe mes pozitive që i kemi këtu po vendosen para institucionit dhe para sigurisë. Kryeatri i Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti, z.Husamedin Hoxha, e dimë që është njëri prej personave që vazhdimisht është frekuentu me situata të tilla, që ka punu vazhdimisht me sigurinë e qytetarëve dhe që kohëve të fundit e dimë që edhe jemi tu ballafaqu me një ekstremizëm të thellë, andaj që nënkryetari mundet me delegu dikënd tjetër me udhëheq këshillin, mirëpo jo me pamundësu pjesëmarrjen e tij, sepse nuk ka dhe nuk ekziston një strukturë e tillë që nënkryetari merr vendime në vete dhe në këtë rastë bëhet një far lloj gjyqtari, sepse me sa e di dhe kam informacione e ka dërgu dhe rastin në gjykatë dhe hala nuk është kthy vendimi i gjykatës, dhe ai i merrë ato vendime, përpos kësaj që u ceken më herët dhe mquenëse kemi inxhieret. Këtu unë i kam pas disa pyetje të përgatitura për sa i përket disa rrugëve disa punimeve që nuk kanë përfundu sot. Kisha dashtë me marrë përgjigjen për rrugën në fshatin Lubishtë, është rruga e cila lidhë mahallen e "Kodroviteve" dhe është konkretisht tek varrezat e fshatit Lubishtë. Kanë fillu punimet qysh në vitin 2021/2020 dhe ato punime nuk është që kanë përfudnu asnjëherë.

**z.Ali Bajrami:** Pyetje për inxhinierat, pasi u bashkangjiten në seancë. Është pyetje recidive që e kam bërë para 1 vjet e 2 muajve. Kurr përgjigje nuk kam marrë, është çështja për segmentin e rrugës "Hasan Prishtina", ajo rrugë sot është sikur shkretinë në uazë. Po më duket jam i kjart çka jam tu thanë. Po më intereson se, është projektu, buxhetu në vitin 2018/2019, gjatësia është 170 metra, asnjë veprim nuk është bërë sa jan bërë 5-6 vite në atë drejtim për atë rrugë. Kërkoj një përgjigje prej inxhinierëve, nëse jo në këtë seancë nuk kan mundësi, atëhere për seancën e radhës gjithsesi me ma sjellë me shkrim.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Faleminderit për kontributin që e dhatë. Te çështja e elementeve të bujqësisë, ne po e lamë që në seancën e ardhshme me na dhanë një informatë të plotë në lidhje me këto shqetësime që u bërën dhe nënkryetari tha që vie.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Përshendetje për të gjithë të pransihmit! Po shfrytëzoj rastin të ja uroj festat e fundvitit. U bë një shqetësim lidhur me Drejtorinë e Bujqësisë lidhur me mjetet të cilat kanë përfitu nga subvencionet në bujqësi. Fakt është që kanë pas vërejtje fermerët në disa mjete që kanë përfitu, por me rëndësi është që, projekti i cili ka qenë dhe është marrë prej operatorit i ka pru me paramasa të caktume. Domethanë, ato kanë qenë valide se ato paramasa, sigurisht jan shku në këtë metodën që të marrin më shumë, por jo më të shtrjeta dhe këtu tani e kemi problemin, aty është problemi që, këtu kanë marrë shumë problem, por po dojnë ato më të sofistikume që janë më moderne. Faktikisht ka maqinë 1 mijë euro, por ka edhe 7 mijë euro, dhe kështu që ka qenë tenderi për këto 1 mijë euro dhe atyre tash ndërkohë nuk ju ka pëlqy. Po në të ardhemen do të shpërndajmë me pak. Do të participojmë me shumë dhe ti marrin ata që kanë nevojë. U tha rruga në Debellde e pa kalushme. Momentin që

ka pas të reshura në atë moment ka mujt me qenë e pakalushme, përndryshe ne kemi interevnu, edhe vet kam qenë në Debelldeh atë natë. Pas të reshurave një pjesë nuk kemi mujt ta pastrojmë, se ka mbet automjeti i kompanisë, të nesërmit është dal dhe e ka pastru edhe atë pjesë. Për dy tri orë ka qenë e bllokume, se përndryshe ka qenë e hapur rruga. Ndriçimi publik. Për atë pjesë është inxhinieri këtu, po mu mu kanë arsyetu se, gjatë punimeve në rrugëve u dashtë me e shkyq. Po e sqaron inxhinieri tash. Për deponitë Remzi ke të drejtë, në atë kuptimin që tabela duhet me e vnu. Ne e kemi bisedu me drejtorin e inspeksionit, që të intervenon, sepse është në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, sinjalizimi e këto na kemi intervenu. Ndoshta jo mënyrën me të mirë të mundshme po e kemi sanu një pjesë të madhe të deponimeve komunale, po këto po përseriten. Unë kam apelu, e apeloj prap që, të gjith të mundohemi në këtë drejtim, sepse po naj shfrytëzojnë hapësirën publike për mbeturina.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Dola bisedova me zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë. Të gjithë mekanizmin të cilin e kanë marr, që janë përfiues fermerët dhe kanë defekte. Në rast se kanë, le të lajmërohen në Drejtorinë e Bujqësisë, gjegjësisht tek menagjeri i kontratës dhe po menjanojkan këto, sepse e paskan kontrate që menjajohen ato.

**z.Fadil Abazi, shefi i Zyrës së Prokurimit:** Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Lidhur me kanalet që pyeti Ilir Zuka, kontrata është lidhë, tash varet prej planit dinamik dhe planit të menaxhimit të kontratës, ku i jep urdhër komuna për me fillu punimet, ndërsa pyetja tjetër që e bëri Jakupi, nuk ka kontratë pa zotime.

**z.Xhelal Musa, inxhinier:** Përhëndetje të nderuar të pranishëm! U bënë disa pyetje rreth ndriçimit publik. Aty janë menaxheri i kësaj pjese, projekti që po fillon të zbatohet është projekt trevjeçar, mirëpo kompania ka qenë shumë e angazhume dhe dikun 80-90% të punëve i ka kry për shtatë, tetë muaj të këtij viti. Aty ka pas edhe shumë here prishje, intervenime të ndryshme, ka pas edhe ndriçim të vjetër. Unë kur do muj me jav servu një raport të kompanisë, dikun me 39 faqe sa kanë bë intervenime, shumë here ka pas edhe sabotazhe nga njerëz të pandërgjegjshëm. Nuk kam pas dëshirë me i paraqit këtu në Kuvend, po me qenë se u fol, shumë here kemi pas raste. P.sh.: në Pozharan tri katër here është intervenu me një vend që ka pas prishje të her pas hershme, po thuaja se të ngjajshme janë prish fotoqelitë e shumë të tjera janë këput kabllat. Ka raste ku janë orat elektrike të dëmtuara qëllimisht, nuk e kemi gjendjen hala të mirë, se unë vet dal baj foto, edhe natën e kemi hala, disa rrugë pa u kry në rrugën "28 Nëntori", aty nuk po mundet me e gjetë një defekt rreth varrezave ortodokse deri tek kisha ortodokse. Aty një pjesë prapë nuk po mundet me u gjet defekti, edhe pse është i qkyqt rrjeti. Në shumë rrugë është intervenu e në shumë fshatra ka intervenime. Ekipa është tu punu edhe sot është në teren. Në vazhdimsi janë tu e realizu projektin, po duhet me pas mirëkuptim se krey kanë mu kry.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Tek pjesa e trotuarit në Smirë, tek rruga "Hysni Salihu", ajo asnjëhere nuk është përfundu taman. I ka gati tri vite që është nis, mendoj që nuk e di kush është menaxher, nuk po kërkoj përgjigje tani, mirëpo është mirë me e përfundu atë.

**z.Xhelal Musa, inxhinier:** Në rrjete sociale i pash do foto të trotuarit te rruga Agim Ramadani, që është tu ndreq. Jam menaxher i kontratës, tek ajo pjesë është bë vizatim i zebrave. Meqense është tu bë sinjalizimi i rrugës, e ne e kemi bë para kohe, e aty tek zebrat ka mu bë një urë për këmbësorët.

**z.Musli Neziri:** Faleminderi Xhelal për përgjigjet. Unë nuk po du me dyshu që nuk ka raport të punës që ju e keni, po unë pyeta konkretish per rrugën "14 Qershori", sepse ka punu ndriçimi tri ditë prej kur i ka ndërru dritat e reja dhe është ndal. Po du me ditë sakt çka ka që nuk banë. Nënkryetar, ndriçimin në fshatin Ballancë nuk e përmende fare në përgjigjet e tua.

**z.Xhelal Musa, inxhinier:** Ato vijat kanë mu hek prej aty, kanë mu qitë në vendin ku ka mu ndërtu ura edhe nuk është naj far problemi i madh mu hek ato vija. Sa i përket ndriçimit te "14 Qershori", edhe çdo ndryshim që është bë është me kualitativ, është afati i qëndrueshmërisë 10 vjeçarë, ka garancion prej kompanisë 10 vite për këto drita që kanë me u ndërru, është intensiteti shumë i madhë, është më i mirë se që ka qenë, më i qëndrueshëm. Projekti është tu vazhdu. Tek "14 Qershori", "11 Marsi", "28 Nëntori" është tu punu sot ende. Mundem me tregu sa sms e sa emaila mundem dhe ato me ja u servu, me tregu që gjithë jemi në kontakt me njerëzit dhe pas orarit të punës në mbramje dalim dhe i shikojmë këto gjëra.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Musli, vetëm dije që kryetari ka dhanë urdhër që Ballanca me u përfshi



në ndriçim, por unë nuk u përgjigja, se duhet me ditë afatin, kohën kur. Në takim që kemi qenë të qeverisë, aty urdhëron që Ballanca mu përfshi në ndriçim. Tani a do të hy në vitin 2024, të shohim. Kur t'i kem informacionet më të plota tu përgjigja.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Unë mendoj që këto 2 javë ne nuk duhe të bëjmë presion tek ndriçimi publik shumë, për shkak që ngarkesat janë të mëdha. Rregullimi duhet me u bë definitivisht.

**z.Musli Neziri:** Komuna nuk e ka për detyrë me siguru tensionin, me stabilizu. Atë e ka KEK-u. Unë nuk dua të ju bahem avokat i askujt, por ne duhet me shfaq interesin e qytetarëve aty. KEK-u është me i siguru fazat, me i sjellë taman. Se kish lagje këtu në Viti që, me të vërtet sa qiri bënë dritë. Ajo është për keqardhje, por fajet i ka KEK-u. Ta adresojmë veç ku të mujmë, d.m.th KEDS në këtë rast.

**z.Jakup Demiri:** Unë nuk morra përgjigje prej njëres pyetje që bëra, por të paktën dua të di kush është menaxher këtu dhe e lam për muajin tjetër. Ndërsa për ndriçimin publik, Bekë, ti sot me siguri kryesues ke ardh sot dhe ndriçimi publik interesant dikund nuk bënë e dikund bënë edhe ditën. Në Smirë komplet rruga kryesore ne në mëngjes erdhëm me drita dhe vimë që 1 vitë e gjysë.

**z.Sejdi Emini:** Pasi që jemi ende te pika e parë e rendit të ditës, pyetje përgjigje, kam edhe një kërkesë prej qytetarit që ma ofroj deri sa jemi këtu, është në pyetje tregu i kafshëve. Me të vërtetë tregu i kafshëve nuk është në gjendje e duhur ashtu si duhet me u kanë. Tani është koha e shitblerjes së kafshëve, njerëzit që po shkojnë atje po ndahen të zhgënjym për shkak të kushteve që janë. Unë e pash dhe një model që ka bërë Komuna e Gjilanit. Me të vërtet nuk është marre me marrë atë model me plasu edhe në Viti, me ju kriju kushte, sepse me të vërtet kategoria që ndoshta më së shumti meriton respekt jan bujqit, sepse me mjaft djersë e perfitojnë paran e tyre. Kështu do të ishte mirë me pas parasysh atë pjesë atje, me ju kriju kushte dhe standarde taman si duhet me qenë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Faleminderit për kontributin që e dhatë. Para se të hymë në rend të ditës, keni nga një fletore dhe nga një laps nga Kuvendi. Materialin e keni marrë me kohë. Për këtë seancë kemi edhe një informatë për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Vitis. Është një material i shkurt, është si informatë, nuk ka nevojë të votohet. Kemi diskutu edhe në komitet atë ditë që, një pikë me na ardhë për sot është propozim për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores Liria në Gjilan, për një periudh 3 vjeçare. E dimë që strehimorja në Gjilan i strehon personat që kanë nevojë. Më herët kemi pas një vendim të kuvendit. Për 3 vite ka kalu ai vendim, tani për vitin 2024, 2025, 2026 për shkak të trajtimit të personave të ndryshëm që kanë probleme sociale, që trajtohen në strehimore. Është e obligushme Komuna e Vitisë, Gjilani, Kamenica me i participu strehimoret dhe 5 mijë euro është shuma vjetore. Duhet të kaloj përmes Kuvendit. Edhe një pikë erdh, raporti i ekipit të auditimit social në Viti, projekti i monitoruar, renovimi dhe zgjerimi i rrugës, projekti "Kongresi i Manastirit", faza e dytë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Në Kosovë çështja e auditimit social është si projekt pilot për herë të parë, të cilën ka pas rastë dhe Komuna e Vitisë, në veçanti është fjala për mjetet të cila jan të derdhura apo të fituara nga ana e grandit të performances Helvitas Kosova me Demosin, dhe Birni ka pas mundësi me bë monitorimin edhe me bë një raport të ekipit auditimit social për Vitinë. Ka qenë 2 herë, përveç takimeve që i ka pas të zgjeruara, por edhe takimet të cilat i ka pas individuale me qytetarë. Konsideroj javën e kaluar e kish qu një shkresë që thotë: të gjeturat e këtij raporti duhet të kalojnë në Kuvendin Komunal. Prandaj unë nuk e ndajta atë pjesë, po si tërësi në përgjithësi raportin, por në pamundësi me i fotokoopju për të gjithë kërkoj falje, për shkak të këtyre fotokopjeve. Tash e kemi një telashe, ja u dhashë shfave të grupeve të subjekteve politike, por edhe në e-mail e dergojmë. Ne nuk mujmë me ndryshu, kjo është e tillë, sepse gjetjet janë të tilla dhe në formë të informatës të hy si pikë e rendit të ditës në shqyrtim.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Para se të hy në rend të ditës, hapi diskutimin.

**z.Jakup Demiri:** Edhe unë pajtohem me Danin, që tha, me na pas dërgu me email para 2 dite, të paktën e kishim kqyrë se është raport i auditimit. Kishim pas edhe çka diskutojmë. Është raport, kësaj radhe po e pranojmë si të tillë, por kur ka mundësi një ditë përpara me ardhë. Unë gjysen e materialit e shfletova, se ka mjaft të gjetura për me diskutu, por po e pranojmë se ashtu dhe u dakordum, por si praktikë tjera here me na dërgu me e-mail.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Pasi që nuk ka për debat, unë e kam obligim për 3 pikat njëhere me

kërku me i shti në rend të ditës, me votu rendin e ditës, për propozim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për strehimoren liria. A jeni që kjo të hy në rend të ditës? Pra, nga të gjitha votat miratohet. Kush është që të hy në rend të ditës informata për zbatimin e planit të integritetit të Komunës së Vitisë? Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim hynë në rend të ditës. Dhe pika e fundit, raporti i auditimit social në Viti. Si informatë është diçka e re që na ka ardhë një punë që e ka bërë një organizatë. Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim dhe kjo pikë hynë në rend të ditës. Atëhere, kush është që të miratohet komplet rendi i ditës, me të gjitha pikat? Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e datës 08.12.2023.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për periudhën në shfrytëzim gjate vitit 2024.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të Vendimit me Nr.01-110/05-1311, të datës 30.10.2023 për dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a (KEDS) në Viti për vendosjen e trafove elektrike.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës së Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2024.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e punës së komisionit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave në fshatin Devajë të Komunës së Vitisë.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet procesverbali nga mbledhja e X e KK-së. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e datës 08.12.2023

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet procesverbali nga mbledhja e jashtëzakonshme? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për periudhën në shfrytëzim gjate vitit 2024

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Kemi listën, drejtoresha nuk qenka këtu. Në vitin tjetër drejtori nëse nuk është këtu e na sjellë pikën. Atë pikë që drejtori nuk është këtu mos me shqyrtu, vetëm në rastë të jashtëzakonshme.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Besoj që vërejtja e kryesuesit në këtë rastë është me vend, ndoshta kryesues për shkak të raporteve edhe shoqërore që kemi, do të kisha propozu diçka. Ndoshta shumë më mirë do të ishte ti me formu një komision dhe me hi plotësim ndryshim rregulltores, punës së Kuvendit dhe ne atë rregullore me parapa që nuk është drejtori dhe mos të idhnohemi me askënd, nuk është drejtori, nuk shqyrtohet se është e pakuptimt. Po besoj që kjo çështje është bë rutinë, sepse çdo vit duhet me miratu, sepse e kërkon ministria këtë. Matrialin e keni para juve, për pyetje shtesë jemi në dispozicionin e juaj.

**z.Bekim Azizi Kryesues i Kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Musli Neziri:** Edhe unë mendoj si kryesuesi dhe nënkryetari. Nëse nuk janë drejtorët prezent, mos ta diskutojmë as miratojmë propozim vendimin e drejtorisë.

**z.Remzi Salihu:** Në këtë listë të veçantë po shifem pronat që duhet t'i votojmë ne tash dhe po shof që e kemi Zonën Katastrale të Devajës me 771 mije e 703 m<sup>2</sup>. Nuk e di se mos i kemi hyp ne qaf fort Devajës, se dhe ashtu i kemi edhe disa të tjera që janë dhanë e kanë mu dhanë në Devajë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Pjesa e Devajës është kjo që është në procedurë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Remzi, kemi pak prona me i dhanë në shfrytëzim, ku titullar është Komuna e Vitise. Të tjerat janë krejt prona jo të komunës.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, a jeni që të votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës me ngritje dore. Me votat e të gjithëve prezent miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të Vendimit me Nr.01-110/05-1311, të datës 30.10.2023 për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës Kompanisë Kosovare për Distributum dhe furnizim me energji elektrike sh.a (KEDS) në Viti për vendosjen e trafove elektrike**

Para dy seancave e kemi miratu këtë vendim, mirëpo e kemi një ndryshim plotësim të vendimit bazë. Bëhet fjalë për tri parcela ku ka pasur gabim. A ka për me diskutu?

**z.Musli Neziri:** Pikërisht këtu tashti komuna me e kushtëzu kompaninë KEDS, me qense po i japim pronë për vendosjen e trafove, e bile me kerku edhe rritjen ose përkujdesjen ndaj konsumatorëve, sepse po kemi telashe kogjo shumë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** A jeni që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës? Me votat e të gjithëve prezent miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës së Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2024**

Komitetit për Komunitete e ka paraqitë planin e punës per vitin 2024. Matrialin e keni marr me kohë, hapi debat për diskutim nëse ka ndonjë pyetje. Pasi që nuk ka pyetje, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e punës së komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave në fshatin Devajë të Komunës së Vitisë**

**z. Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Matrialin e keni marr me kohe dhe është një matrial bukur vuliminoz e ku komisioni jo në përbërje të plote kane pas vërejtje rreth anëtarit që eshte nga LVV i cili nuk ka marr pjese në mbledhje të cilin e kan thirr ndërsa anetaret e tjer e kan sjell raportin e punës per miratim andaj kerkojn miratimn e këtij raporti.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Durim Sylejmani:** Nënkryetar, nuk e kam marr asnjë ftesë zyrtare në lidhje me këtë komision, asnjëhere.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Të kanë thirr në telefon disa here, nuk je përgjigj.

**z.Jakup Demiri:** Sa i përket pikës që po diskutojmë, unë i kam disa dyshime për të cilët du me i theksu. I gjithë procesi për me i dhanë këto 40 vite, diqysh na si opozitë nuk kemi qenë të njoftuar, pavarësisht që anëtari i jonë nuk ka marr pjesë kemi mujt me e diskutu edhe në kuvend dhe ja kish vlejti me e diskutu në kuvend pak me herët e kjo 40 vite është shumë dhe ne prap qëndrojmë se mbi 20 vite maksimumi 25 vite, se mandje janë disa ngatresa ligjore që njeriu që e shfrytëzon me kontratë mbi 25 vite. Tani i ka disa të drejta aty edhe po mendoj që është afat i gjatë dhe është sipërfaqja e madhe gati se e kap komplet at sipërfaqe dhe e bllokoi atë pjesë të tokave

atje te fushave, që disa fermer i shfrytëzojnë për bagëti edhe ajo pjesë mandje bllokohet. Për neve si LVV ka disa specifika që duhet të ndryshohen, po kjo kryesorja është kjo pengesa e shfrytëzimit të hapësirave të tjera që nuk mund të shfrytëzohen, mandje edhe 40 vite është shumë.

**z.Musli Neziri:** Ne këtë pjesën kur e kemi ndërru nga afatshkurt në afatgjatë, që e kemi bërë dhënien në shfrytëzim, e kemi votu një pjesë e këtij Kuvendi. Tani e pasmi propozim vendimi për 40 vite, megjithatë unë nuk isha ndal shumë tek vitet, meqëse jemi tu fol për një mega projekt. Së paku kështu u thanë në matrial ku hapësira totale 99 hektarr kur po e shofim si do të trajtohen, ku dikun 60 veta do të punësohen, së paku kështu thuhet në planin e biznesit. Unë krejt çka kërkoj: a ka komuna një ekip që me të vërtet mu realizu kjo çka është premtu? Mu mbikëqyrë kjo. Ne jemi për me ja dhanë atë pjesë, po po duhet me ditë se a po ju ndërrohet destinacioni. Çka nëse tu e ditë ose tu e pa trendin si po shkon, çka nëse ai nesër atje e bënë ndonjë restaurant a po hotel. Prandaj, unë krejt çka kërkoj, a do të ketë fuqinë komuna me e mbikëqyrë. A po realizohen këto 30 h arra, 30 lejtithi, a të punësuarit.

**z.Taulant Haxhiu:** Nënkyetar, unë jam pro investimeve që bëhen, sidomos në Komunën tonë. Po ai e di që, njëhere u kanë 99 vite, mandje kemi ardh te ky 40. Na e dimë se çka ka me bërë investitori, po është mirë secili këshilltar komunal me ju sqaru në mënyrë decitive, se çka po investon, çka po banë. Ne e kemi pa çka ka, po na kemi shumë raste në Kosovë që i kanë marr toka për 40 vjet e më shumë ato që e kanë deklaruar që kanë me e investu 60 % të tyre, se kanë investu. Unë po të isha në vendin e tij unë e kisha dhanë për 25 vite, që me pa ka po hec, mandje plus 15. Nuk di asnjë vend në Kosovë që ja ka dhanë 25 vite e më von i ka thanë nuk ki gjithëmonë shkon 25 + 15 në shumë vende të Evropës. Kështu veprojnë. Mu nuk ma merr mendja që mundet me e realizu ai atë që e ka deklaruar. Unë uroj që të jetë ashtu, ama nuk po besoj.

**z.Illir Zuka:** Kryesues, dashta mu dërlidh me fjalimin e Jakupit, se po diskutojmë në për vite është shumë e vërtet se kemi pas debat e dikush ka qenë për 15 vite. Dikush 20 e dikush 99. Ne kemi ardh në përfundim dhe e kemi kalu si vendim me 40 vite. Edhe këtu puna e komisionit dhe matrialin e kemi. Unë isha ndal tek fushat e investimeve që kanë me i bërë ky panelet solare, pemëtari, blegtari, shpenztari. E çka më pengon mu e kam cek edhe në KPF, e tjera më pengon. Mendoj që duhet me saktësu këtë, sepse kjo e tjera rrokë shumëçka, edhe sa i përket a lejohet panelat solare mu vendos në atë pjesë.

**z.Basri Sylejmani:** Unë po tham vetëm se a është investitori korrekt, se me ti punësu 60 punëtorë në atë kodër aty, ama vetëm a e merr ai me investua aty, se aty nuk kemi asgjë të ardhura nga ato kodra. Unë jam për që t'i jepem për 40 vite, po për dy tri vite me pas një komision me i këshyrë investimet e tij, a po investon apo jo.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Duhet në vendim të ceket që mbrenda viti duhet të fillojnë punimet e brenda pesë vite duhet të përfundojnë investimet. Nëse investimet nuk përfundojnë brenda pesë viteve, toka i kthehet komunës. Qeto duhet mu cekë në vendim, sepse nuk guxojmë me ja dhanë pa e cek kohën e investimeve.

**z.Jakup Demiri:** Për mua problemi më i madh është 40 vite, se pas 25 viteve nëse shfrytëzohet i ka disa telashe, mandej sun e kthen hiq, se së paku edhe unë e kam dhanë një të drejtë ndërkombëtare ekonomike mbi këtë. Sa i përket punësimeve, ne e dimë çka kemi bërë me një fabrikë me 500 punëtorë. 100 punëtor i kemi maltretu, mashtru e në fund as nuk i kemi pagu. Këtë e dimë ne, por kriteret që i keni përcaktu krejtë në rregull, por kjo, unë nuk kisha guxu me i dhanë dikujt 40 vite. Ne po vendosim për diçka, që pjesa më e madhe me gjasë as nuk kemi me qenë as gjallë kur të jetë kjo problematikë. Mandej për këtë po flas, nuk e shofë të arsyshme. Plus asaj, ne e dimë edhe si bëhen matematikat në këtë vendin tonë dhe ajo më pengon, se kjo nuk është garë ferë, kjo ju ka dhanë dikujt këtu, është nda talli dhe kjo më pengon, por për atë pjesë ne të jetë në ndërgjegje të tyre dhe punë e shtetit është, nuk është punë e imja, por puna ime për me votu këtë problemi më i madh është 40 vite, se po vendos për diçka që nuk është në rregull. Nëse ai ka interes edhe tek 25 vite, është i njëjti send me mundësi vazhdimi 24 vite, nuk po thamë as 25 se përime i lajmë probleme shtetit dhe shoqërisë si 24 si 40 me mundësi vazhdimi. Bëhet dokument tjetër në rregull, por dikujt po ja bajm 99, tani 40 vite. Pse 40 vite jo 24 krejt, ato kultura, këto çka i mbjellë 24 vite kur ti bëjnë edhe ashtu jan plak, duhet sërish, se e kryen edhe ata mundësinë se çka mujna me dhanë produkt e mos të flasim për gjëra të tjera.

**z.Taulant Haxhiu:** Kryesues, se pasi keve pjesë e kësaj teme, një afarist, një biznismen duhet me pas një plan

të biznesit serioz, që ai neve na jep një vullnet që ne me votu pro atij që po ja japim këtë token në shfrytëzim. Plani i biznesit duhet me qenë serioz. Unë nuk pash as te plani biznesit as te gjendja financiare diçka shumë serioze që ai ka potencial me zhvillu atë që ka deklaruar.

**z.Sejdi Emini:** Me të vërtetë është një temë e ndjeshme, që secili prej neve duhet me dhanë mendimin dhe me dhanë kontribut, sepse bahet fjalë për një pjesë që është diku 100 hektar. Pat zëra këtu që tha veq a pe merrë. Po, kush është ai që si merrë 100 hektar pronë shoqërore për 40 vite. Një jetë njeri i vynë dikujt me shku 20/30 vite në përdim për me i blej 2 hektar tokë, aty janë 100 hektar. E kush është ai që nuk i merrë 100 hektar të gatshme siç jemi tu ja dhanë ne. Ne dikujt jemi tu i dhanë mundësi, e që është mirë me i dhanë mundësi, po që ndoshta po mbysim shumë pamundësi në të ardhmen që kemi me pas ofertues me dhejtra qindra here, me oferta më të mira për komunën, për shoqërinë. Nuk është qysh jemi tu thanë veq a pe merrë, veq a nuk po e merrë, se është përgjegjësi edhe për neve, se gjeneratat jemi tu i eduku këtu. Kjo tokë nuk është bash me ba çka dush edhe në fillim kemi thanë me dhanë me mundësi. Unë nuk e kisha dhanë hiq 100 hektar, gjysen e gjysen e kisha lanë për një ofertues shumë më të mirë se ky që e ka ofru sot, sepse bota është tu zhvillu, nuk jemi tu nejt këtu si jemi pas 5 viteve ndoshta vjen tjetri me shumëfish interes të shoqërisë komunës që na e kompnezon më mirë, mirëpo kjo qysh ja kemi nis me të vërtetë sikur me ja falë është 40 vite. Një jetë mesatare 80 vite shkun gjeneratat, e çka me i bë atij nesër që vjen ndoshta me oferta më të mira pas 2,3,5 vite. Me pas bë një reklamë të mirë për 100 hektar tokë, unë jam shumë i sigurt që aty Komuna e Vitisë kish përfitu shumë më shumë se si është tashti.

**z.Remzi Salihu:** Jakupi tha 24 vite, po unë për vete as pas 24 viteve nuk jam ju të tjerët po. D.m.th është një kërkesë e ofertuesit e cila ju është drejtu Komunës së Vitisë neve në kuvend është hera e 3-të më duket kjo kërkesë dhe shumë kemi debatu rreth afatit kohor, pikërisht edhe unë kam qenë kundër një afati kaq të gjatë, por sidoqë të jetë shumica vendos ofertuesin. E kam shfeltu materialin krejt në mënyr telegrafike dhe disa gjëra i kam parë aty. Ofertuesi bënë ofertën prej 45 viteve deri në 99 vite po i bie kjo që unë kam pas thanë këtu që ne po lejojm që ofertuesi të naj diktojn vendimet tona jo netë marrim vendime me kokë të kfjellet por ofertuesi oferton kurse dikush tjetër e shef ndoshta edhe leveridn e tijë personale dhe vazhdon tutje na sjeln nëve në kuvend këtu që ta jek përgjegjësin prej vete, vërtet 40 vite është shumë nuk dua të hy aty në sa vite por jan disa ligje nderkombtare e ligje kombtare që i përcaktojn do gjera së pari ka qenë dashtë të përcaktohet vlera e tokës që ipet dhe të shihet se sa është vlera dhe sa jan investimet që behen në atë tokë nëse investimet janë më të mëdha se vlera e asaj toke atëherë me gjyqe nderkombtare ai ka të drejtë ta priatozot pas një kohe këtë tokë sepse investimi ja tejkalon vlerën e tokës që i ipet, kam parë edhe disa gjera të tjera që nuk jam pajtu me to indetifikimi i operatorit ekonomik përpos të dhënave si adresa dhe pozita si investitor dhe listat e asteve që ai përshkruan në kerkes nuk kam parë një veprimtari të tijë që e ka ofru ai se vërtet me na bind neve që mund ti kry këto punë dhe është një ofertues serioz prandaj si të tillë unë kam shumë dyshime, tek fushat e interesit epermendi edhe Iliri shumë kjart e tha panela solare pemëtari, blegori, shpeztari etj kjo etj neve na ka sjellë telashe këtu në kuvend shpesh here ngase edhe nga egzekutivi bihen do gjera që thojn hargjime etj por qka është kjo etj, nëse ai behet pronar me të drejtë ligjore dhe ne këtu e kemi në dokument etj ai mundë të hapë një veprimtari tjetër ku ta di unë se qfare ndonj hotel restaurant apo ndoshta edhe motele se jan bërë në modë tek ne, prandaj si e tillë unë ka vrejite edhe në afat kohorë por edhe në disa gjera të tjera, e pash tek procesverbali i komisionit që thamë të drejtën nuk më pëlqej fare procesverbali se nuk permendet aty veq kush është zgjedh kryetari kush është antar dhe është nënshkru është pranë dhe tjetra tek ofertuesi mos është shkel procedura e ankandit publik ngase nuk ka pas ofertues tjetër përpos ky i vetmi po e bëjë si pyetje nëse ka ndokush me mu përgjigj mirë nëse jo atëhere unë për vete timen si individ nuk mundë ta votoj në këtë form

**z.Ramadan Deliu:** Vetem dashta me pyet Jakupin kur tha për këtë fabrikën që u qelë: çka i ke nimu ti asaj fabrike, a mos i ke dhanë vend, a mos i ke dhanë parë? Ajo ka qenë krejt diçka tjetër, kjo është krejt diçka tjetër. Mos i përzhini senet, dhe kur tha Sejda me pas qitë diku 100 hektar palë, kush e merrë, kjo ka qenë në ankand publik, ka pas të drejtë gjermani, italiani me apliku, kush donë ka pas të drejtë me apliku. Ky ka apliku, ja ka caktu komisioni 40 vite, i ka kqyr senet, unë kisha thanë qite në votim.

**z.Jakup Demiri:** Dan, mos t'i bajm personale. Po me punën e fabrikën kemi mashtru, kemi rrejt njerëz. Unë

nuk i kam rrejt, mos ta bajm personale. I kemi rrejt njerëzit, i kemi maltretu, ja u kemi marrë nga 70 euro për dokumentacion, kemi rrejt opinionin për 500 vende të punës, ju kemi bërë kontrata njerëzve nga 13 muaj, aty pari janë sillë dhe ka 2 rroga ja u kanë dhanë ka 11 nuk ja u kanë dhanë hiq. Nëse të doket në rregull kjo punë Dan, më vjen keq.

**z.Sejdi Emini:** Pikërisht këtu e pata ku po donë me dalë Dani, që pas 10 viteve nuk e dimë a vjen ndonjë gjerman apo naj amerikan, francez që na e shumëfishon interesin e Komunës dhe të shoqërisë. Kjo është ajo për të cilën fola në fillim, por nëse nuk ka mujtë me kuptu faktikisht ma qeli udhën me thanë edhe niher që. Kjo është ajo që më ka mundu.

**z.Jakup Demiri:** Kemi edhe kundër investitor, por me të vërtet këto gjëra shihen prej ballani, që janë të gatume për dikan, dhe nuk është në rregull me shku pas dikujt me ja bërë dikujt. Ne duhet me bërë treg të sinqert të lirë për njerëzit e sinqert, që kanë interes me investu, por jo kështu, tu ja përgatit kulaqin. Kjo është ajo edhe 40 vite unë nuk e shof veten që banë me u votu të paktën flas për vete.

**z. Basri Sylejmani:** Unë veç kisha me thanë edhe niher me pyet nënkryetarin, se ky është jurist, a ka të drejtë atë investim ai që e banë apo naj investim tjetër.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Krejt shqetësimet që u ngritën e kanë atë arsyeshmërinë e vet. Po a guxojmë ne si ekzekutiv dhe ne si Kuvend me marr vendime të tilla dhe me thanë që, ne po presim mos po na vijne ditë më të mira, për shkak se për momentin ti e ki të afruar planin e biznesit i cili është ambicioz. Janë vlera dikun 1 milion e 500 mijë, janë 60 për të punësuar dhe tash a bim ne vendime për ta stopuar këtë. Unë konsideroj e kemi gabim dhe ai që unë kam prit që, shumë keni me qenë definimi në kontratë që e nënshkruan me komunën, duhet me qenë e qartë, e ngriti Iliri, thotë të tjera. Nuk ka të tjera, duhet me i definu cilat i inviston, afatshmërinë a e lam brenda një viti me fillu e brenda pese vite me e përfundu është çështje e juaja, po megjithatë duhet me pas atë tolerancën me i dhanë hapësirë se, 1 milion e 500 mijë nuk janë pak mjete dhe duhet të hecim më tutje. Tash ai 40 vjeçari, Sejda tha, kush nuk kish investu, o krejt me ma dhanë se e di fortë mirë as fal me me dhanë nuk e kam at kapacitet me marr. Po ku është ajo e mirë që ai me investu. Dyshoj shumë përshembull se, kur po thotë arra që e ka gurin afër, po ndoshta ky sistemi i ujitjes mundet me i bërë, ishalla i banë, se përndryshe e njoj bukur mirë atë pjesë, dhe ajo sipërfaqe ka shumë pak dhe është pjesa dërmuese me guri. Prapë mendoj që duhet të definohet me kontratë sakt. Ne duhet me e mbikëqyrë këtë pronë. Sa i përket 40 vite, mendoj që nuk duhet mu diskutu kjo.

**z.Sejdi Emini:** E para, kjo që ka njëherë po duket si po reflekton, që është dikush kundër investimeve, kjo nuk është as ka mendohet, as që është mendu naj here. Unë se di që dikush në Kuvend ka qenë kundër një investitorit, kush do qoftë ai dhe përshka do qoftë, ai, po secili këtu i ka pas arsytet e veta dhe mir e tha nënkryetari që, bota as nuk ka fillu as nuk përfundon me neve. Është mirë që me ja lan do vendimmarrje edhe atyre që vijne pas neve. A kemi pas drejtë apo jo, se nëse ja bëjmë për 40 vite, nuk po lamë hapësirë atyre me vendos. Tani a kemi pas të drejtë na apo nuk kemi pas na, qysh në fillim kemi kërku, unë personalisht kam thanë 15 vite me mundësi vazhdimi, pikërisht qe me i dhanë mundësia, se a po shkon në qato parametrat që i ka të shkrum, e pse jo me ja vazhdu edhe qaq. E kështu qysh jemi na, jemi tu e ngulfat hapësirën edhe për gjeneratat e ardhshme. Kjo që po thu, mundemi me ja marr. E çka nëse ai fillon i banë vetëm gjysmën e investimeve e jo krejt këto çka janë, se mu kanë që nuk fillon, në rregull, ja merr, po çka nëse ai fillon vetëm gjysmën e banë dhe tani thotë pritni edhe 5 - 10 vite. Mendoj që duhet me pas arsye ne.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Sejdi, ai ka me ardhe me e nënshkru kontratën, e aty kanë mu cek që, brenda viti me fillu investimet e brenda pesë vite me përfundu, dhe kjo e obligon atë.

**z.Taulant Haxhiu:** Nënkryetar, unë i pari jam këtu që kam qef me ju dhanë krejve bizneseve të botës që me ardh me investu në Komunën tonë. Unë kam mujt me shku me investu në Prishtinë, Gjilan e tjera komuna, ama unë investoj në Komunën tonë, se jam i këtij vendi. Na kur ta marrim një investitor, ne e keshyrimi referencën e tij, pasqyrën e tij, kush është ai, çka ka bërë ai gjatë jetës, se vet çfarë biznese ka ushtrru, e aty shifet fuqia e tij. Po një investitor kosovar së bashku me atë të jashtit, se po flitet që janë dy së bashku, atëherë ai të jep me shpresu, po investitorët e jashtëm ne 40 vite nuk hinë në investime. Ai pa e pa 40 vite kontratën nuk hin në investime. Unë

kam përvoja prej investitorëve të jashtëm. Si ta shef që kontrata është 25 vite investimi, ai frikohet me investu, se nuk e dinë a mundet me i kthy paret, por unë kisha pas një propozim që, investitori mi pas disa kritere kur ja fillon dhe në sa kohë e mbaron. Në atë kohë që ai deklaroi që ai mbaron në qoftë se nuk e mbaron investimin, në Kuvendi duhet të ja marrim prapë prapë.

**z.Jakup Demiri:** Së pari nuk është puna me repliku, po me drejtu diçka. Natyra e bizneseve e përcakton kohëzgjatjen. Ne kemi dhanë prona edhe për 99 vite. Si shtet kemi pas agjencionin, po na e dimë që ka qenë model i privatizimit i imponum. Na kanë thanë qashtu dhe e dimë çka i kemi bërë në vendit me atë farë pune edhe na me këtë farë kaçikin tonë si thotë populli, si Komuna e Vitisë që del në Ferizaj andej nuk e di se ku ekziston ajo punë 40 vite, po perime kjo për mua është e rëndë 40 vite. Ja japim në njërit një vend në Komunën e Vitisë, që faktikisht kur ta shifsh çka ka me investu ai nuk e ka të qart, i ka përmend nja 3-4 dhe të tjera, po kjo të tjera një far, qaq është e zbeht, por te investimet kur të bëhen është një ligj ndërkombëtar që unë e kam mësu në fakultet. Po e shpjegoj pak. Thotë, nëse investitori në atë pronë shoqërore ka një kontratë dhe ka investu për 25 vite dhe nëse ajo vlerë e investimeve tejkalon vlerën reale të tokës, atëherë ka të drejtë të parashtrijë kërkesë për privatizim dhe përvetësim të asaj pjese. Prej praktikave ndërkombëtare thotë aty, të gjitha këta janë bërë përfutës dhe pronarë të parcelave dhe ne e dimë që në gjykatë tona ndoshta edhe nuk vendoset, por kemi edhe shumë raste qytetarët tanë përmes edhe gjykatës së Strasburgut, Venecias i kanë fitu këto. Nuk dua të hy, andaj, se fundi i fundit unë nuk kam ndërmend me votu, por po dua si Kuvend Komunal, se nuk po e shof të arsyeshme, 40 vite janë në pyetje. E bajmë 20 vite me mundësi vazhdimi edhe na ka hije. Kur Kuvendi Komunal i jep 100 hektar tokë, ja jep dikujt për 40 vite perime është e randë. Nënkyetar, shumë sinqerisht unë jam duke u mundu me dhanë kontribut në këtë çështje dhe jam shumë i bindur në këtë çka jam tu e thanë, nuk jam tu bërë zhurmë palidhje. **(pjesa e diskutimit nuk dëgjohet sepse është folur pa aktivizimin e mikrofonit).**

**z.Taulant Haxhiu:** Jakupi po donë me thanë që, mos po dështojmë dhe te ky investor si te ai tjetri në këtë aspekt me sa e kuptoj.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Taulant, nuk e di a më përcjell, a thashë që është e garantume që ka me bërë, edhe unë kam atë skepticizmin sikur ju po uroj ishalla në rastë se bahet me t'i punsu 60 persona aty dhe me ta bërë atë mrekulli. Unë veç uroj dhe ja kisha dhanë edhe ma shumë.

**z.Illir Zuka:** Unë po besoj këtu në sallë të Kuvendit jemi tu diskutu për 2 propozim vendime me një propozim vendim që e kemi kalu, që e ka kthy ministria të ligjshëm. Tani d.m.th jemi me një pjesë tjetër. E cekta në fillim, edhe taulanti duhet me u ndërlihd me atë që vendimin kur e lëshojmë që me cekë, me ja caktu vitet 1,5 vite mu thirrë në ato, një propozim që e kemi kalu ka kalu në vendim, e ka kthy ministria të ligjshëm, nuk kemi nevojë ne mu kthy sa vite me ja dhanë, se është procedurë e kthyme. Tani ne jemi tu diskutu për temë tjetër, vetëm këtu që e kisha lutë edhe sekretarin edhe kryesuesin, kur e qitni mu votu me i cekë, me fillu brenda 1 vitit me përfundu brenda 5 viteve dhe me pas drejtë një komision që, në qoftë se nuk i bënë ato me ja kthy tokën Komunës.

**z.Bekim Azizi Kryesues i Kuvendit:** Ju faleminderoj për debatin, pasi që nuk ka për debat e qesë në votim me plotsiomin e një neni që, investimet t'i fillon brenda vitit dhe t'i përfundojnë brenda 5 viteve. Nëse nuk përfundojnë investimet brenda 5 viteve përfundon kontrata. A jeni për këtë propozim vendim. Kush është për, me ngritje të dorës. 15 pro, 2 kundër, 5 abstenim. Pra, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës kemi:

## **7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë**

**z.Visar Demiri, drejtori i urbanizmit:** Përshendetje të nderuar të pranishëm! Para juve kemi propozim vendimit për miratimin e Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë. Me këtë plan multisektorial përcaktohen saqet afatgjata të zhvillimit ekonomik social dhe hapësinorë, duke përfshi planin, zhvillimin e zonave urbane dhe rurale në tërë territorin e Komunës së Vitisë. Plani zhvillimor komunal përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës së Vitisë, mbi të cilën bazohet pastaj edhe hartimi i hartës zonale. Dokumentacionin e kemi marr me kohë. Për çdo pyetje që kemi

jemi këtu për t'ju dhënë përgjigje.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Kemi prezent edhe nga UBT-ja të cilët e kanë punuar këtë plan.

**z.Jakup Demiri:** Drejtor, besoj që ka qenë mirë me pas njëfar koncepti, sepse është dokument kogjo i madh e me naj dhanë disa sqarime. Po ja kish vlejti që në disa pika kyqe me e shpjegu, pasi që nuk i kemi hartat zonale e për të cilat unë nuk e di çka me thanë, sepse edhe kur e kemi votu e kemi votu në mënyrë urgjente, sepse nuk kemi pas njohuri për to. Dashta me e pyet, kufijë e ndërtimit të qytetit apo shtrirja e qytetit: kah është orientu? Se unë nuk e di, etazhitetit i ndërtimeve sa është parapa, koeficienti sa është, si ka me qenë formula e shfrytëzimit të qasaj parcele për ndërtim, rrugët brenda qytetit si kanë me funksionu. Janë disa pyetje që unë nuk e di.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Sa i përket aspektit ligjor, u tha edhe nga kryesuesi, i ka kalu filtrat ligjor, procedural. Ministria vetëm e ka dhanë pëlqimin, kurse tek kufijt në planin zhvillimor komunal ka qenë i publikuar në web të Komunës edhe në materialin që ju ka ardhë e di që është ardh në PDF, po pak a shumë keni mujt me pa ka janë vijat ndërtimore në qytet, po edhe në fshatra. Sa i përket etazhitetit, etazhiteti përcaktohet me hartën zonale. Plani zhvillimor është dokumet më i përgjithshëm, i përcakton vetëm vijat ndërtimore dhe ne kryesisht jemi mundu me e rujt tokën bujqësore, nuk kemi tentu me i zgjeru shumë vijën ndërtimore të qytetit, për shkak të tokës bujqësore, por krejt çka është shtu është një pjesë këtu brenda qytetit që ka qenë, e kemi shtu si tokë ndërtimore dhe ndoku ndonjë korrigjim, kryesisht jemi mundu me e rujt në vija që ka qenë edhe më herët. Etazhitetin e detajon harta zonale. Tek rrugët janë të parapamë. Kemi parapamë edhe rrugë të reja të cilat ndërkohë mendoj që është në interes të qytetarëve që ato rrugë të hapen dhe të lidhen në mes veti më rrugët tjera, për me pas një komunikim me të mirë në mese të rrugëve.

**z.Illir Zuka:** Ne i kemi pas disa pyetje në KPF. E pash, bisedova me drejtorin, që janë bërë disa përmirësime sa i përket listës së kontribuesve. Çka më ka penguar mu që, na e kemi lanë një zonë qorre në mes të Pozharanit dhe Vitisë që ka mujt mu kan një bashkim, që me leju që të lejohet ndërtimi, sepse nuk lejohet ndërtimi. Ka mbetë një zonë qorre. Na kemi mujt me bërë aty me këtë plan, mu leju deri në 100 metra pjesa mu shfrytëzu si tokë bujqësore. Momentin që nuk ka ndërtim nuk ka edhe bashkim. Gjithmonë ne kemi kërku me qenë lidhja e Pozharanit me Vitinë. E me këtë plan përsëri e kemi bërë një shkëputje. Unë mendoj që u bërë gabim. Ne e kemi pas edhe këtë kërkesë edhe kur e kemi pas diskutimin në Pozharan. E di që nuk ka hi e për mu është gabim.

**z. Musli Neziri:** Drejtor, sa nga kërkesat e qytetarëve janë marr parasysh? A janë shqyrtu të gjitha?

**z.Visar Demiri drejtor:** Sa i përket pjesës në mes të Pozharanit dhe Vitisë, është tokë bujqësore e kategorisë së dytë ose të tretë, dhe ministria mu për këtë ka vnu theksin gjithmonë që të ruhet toka bujqësore. Nuk ka pas interesim as prej ministrisë po as nga ne, që mu zgjeru, për shkak se dy komponent kryesor që merren tek vija ndërtimore është se, numri i popullësisë, i vendbanimit dhe kategoria e tokës bujqësore. Kështu që në të dy aspektet u kanë problem me e zgjeru një zonë të till prej 4-5 kilometra në mes të këtyre tokave bujqësore. Është e klasit, të mirë, po edhe nuk kemi një rritje të popullësisë, asisoi që kërkon zgjerim të madh të qytetit ose zonës së Pozharanit. Kurse sa i përket pyetjes së Muslisë, dikun rreth 75 kërkesa kanë qenë nga qytetarët. Prej tyre janë përfshi 41 në plan zhvillimor të cilat kanë pas arsye, i kemi shqyrtu të gjitha kërkesat, po i kemi përfshi ato që kanë të bëjnë me planin zhvillimor komunal, për shkak se qytetarët kanë bërë kërkesa që nuk kanë të bëjnë me planin zhvillimor edhe ato janë refuzu. Në raport i keni të detajuar se cilat janë marr parasysh, edhe komisioni ka vendos se cilat të përfshihen në plan zhvillimor.

**z.Illir Zuka:** Ne e dimë cilësinë e tomes Pozharan-Klllokot, edhe aty qysh e di unë është e rrgullume deri në 100 metra. Ki drejtë me e ndërtu, po unë mendoj që nuk ka pas vullnet komuna për me hec procedurat përpara. Këtë pjesën ku u cek nga Taulanti, rrua "Hasan Prishtina" deri te "Lisi" është ndërtu. Tash ka mri deri në Drobesh, ato toka krejt janë bërë ndërtim për shkak se nuk është leju mu zgjat Pozharani, ka fillu, u bërë lidhja deri në Drobesh. Po qelen rrugë për shkak mos lejimit unë kam mëndu që ka qenë shumë më e mirë që mu leju deri në 100 metra me pas ndërtime dhe ka njerëz që kanë shumë projekte të mira për me bërë ndërtime aty. Po ju e keni pa zgjidhjen në këtë mënyrë dhe keni vepru.

**znj.Majlinda Shabani:** Meqense i kemi edhe përfaqësuesit e UBT-së, të cilët janë marr me këtë çështje nga



fillimi. Unë paraprakisht kisha dashtë që të paktën a e kanë bërë një përgatitje të prezentimit të shkurt, për shkak se materiali është vulimonoz, e qytetarët e kanë të pamundur për me e kuptu, sidomos tek hartat zonala duhet me qenë njëfar lloj eksperti për me e kuptu edhe me i pa se ka janë shku ato. Kështu që, unë kërkoj fillimisht që nga përfaqësuesi në pika të shkurta me naj tregu objektivat që janë përfshi në këtë plan zhvillimor që ne me i pa, sepse në fund të fundit na interson me ditë se a janë përfshi të gjithë qytetarët e Komunës se Vitisë dhe po flasim për një plan që është bajagi i rëndësishëm.

**z.Taulan Haxhiu:** Drejtor, po lidhem me pjesë që u fol nga Iliri. Kjo rruga e Pozharanit që lidh Pozharan-Viti dhe tash edhe Sllatinë, kogjo është një hapësirë e madhe edhe aty pasi që është tokë bujqësore. Janë shumë shpija të ndertume në atë vend, tash po bëhet edhe kjo rruga lidhëse te "Lisi" që kalon deri te "Lindi" aty ka pas mundësi mu bërë një ndryshim për shkak se edhe për ndërtimin e objekteve apo diçka afariste është e mirë se lidhet edhe me autostradë. Është edhe rrugë, është hapësirë e madhe e cila nuk po shfrytëzohet në atë tokë bujqësore. Vetëm ka fillu ndërtimi, aty duhet mu zgjeru, unë kam pas ankesa të vazhdueshme për aty, ama ju prapë keni shku me planin e vjetër.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Unë e thash që ministria nuk lejon. Nuk është se mujmë me ba çka dojmë ne, po ministria me pranë me dhanë pëlqimin. Ne edhe e kemi zgjeru zonën, kemi shti rreth 60 hektar tokë ndërtimore, e kemi fut në qytet. Sa i përket ndërtimeve pa leje, njerëzit mujn me ndërtu, kanë ndërtu edhe me herët në zonën e Drobeshit, mirëpo janë ndërtime pa leje, ne nuk guxojmë me e planifiku pa ligj.

**z.Shqiprim Ahmeti, përfaqësues i UDT-së:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam qenë bartës i hartimit të këtij dokumenti. Sot nuk e kemi parapa një prezentim, sepse jemi me një moment krej formal që duhet mu aprovu ose jo dokumenti, ndërkohë që prezentimin e kemi bërë gjatë shqyrtimeve publike dhe debatet publike. Për informimin e juaj janë bërë disa shqyrtime dhe debate publike edhe në këtë qendër që kam qenë prezent edhe unë, po edhe në disa fshatra të Vitisë. Materialin e kemi me sjallda, mundemi me e prezentu. Sa i përket zonave që u diskutu, është obligim që kur të hartohet një dokument i ri me qenë në përputhje edhe me qenë në përshtatje me dokumentet paraprake të planifikimit. Sa i përket aspektit teknik, se ku munden e ku nuk mundet mu leju zonat e reja të ndërtimit, edhe aty ku ka ndërtim, që kryesisht bëhet ndërtim pa leje, tash e kemi ligjor për legalizim në bazë të cilit munden mu legalizu ndërtimet pa leje. Po ne si planifikues për zhvillimin e ardhshëm të territorit nuk mundemi me legalizu ose me formalizu ose me leju që ndërtimet të tjera në atë zonë, nese e ka ndertu dikush pa leje me e leju.

**z.Bekim Azizi Kryesues i Kuvendit:** Në këtë plan a është përfshi pjesa ndërtimore, a i ka rrokë të gjitha qeto pjesë deri ku kanë mbërri shtëpitë që janë ndërtu apo nuk ka mrri. E dimi që ligji për legalizim, nuk ka mundësi me legalizu dikush shtëpinë nëse është jashtë zonës ndërtimore. Tash a ju ka ba një argat me këtë plan atyre që kanë bërë ndërtime pa leje deri tani që, kjo zonë, këto hartat tona kanë mrri deri tek ato shpija që e kanë vnu një kufi deri ku kanë mrri zonat ndërtimore apo kanë mbetë jashtë një pjese të tyre.

**z.Shqiprim Ahmeti, përfaqësues i UDT-së:** Për përgjigje konkrete e ftoj kolegen mu përgjigji, sepse ka qenë përgjegjëse për këtë.

**Përfaqësuese i UDT-së:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sipas të dhënave që duhet mu je u referu në planet zhvillimore ose hartat zonale, është të dhënat që naj japin që janë ligjitime prej agjencionit kadastral. Në Agjensionin kadastral ortofoton e ka të 2018-së, po ne pavarësisht asaj nuk jemi ndal me këtë ortofot të vitit 2018, se ka kogjo do vite deferencë, sepse janë zhvillu shumë vendbanimet. Çka po du me cekë që, ne pavarësisht kësaj kanë shku kolegët edhe studentët me dal në teren me degjitalizu çdo objekt të ndërtimit. D.m.th sipas kësaj janë përcaktu edhe zonat ndërtimore sipas çdo objekti ndërtimi që është në teren. Kemi dalë në teren, kemi indetifiku secilin objekt sa është etazhiteti dhe sa metra katror i ka ndërtimi. Në bazë të kësaj kemi shku dhe kemi caktu kufirin ndërtimor. D.m.th sipërfaqet ndërtimore i kemi me gjendje reale, i kemi njoft sipas 2018-ës, që është mortofoto. E kemi si bazë ligjore të 2018-ës, por kemi dashtë me pas të dhënat aktuale sa janë sipërfaqet e ndërtimit. D.m.th në territor jo vetëm në Viti, por edhe në zonat rurale në secilin vendbanim ku janë të përfshimë. Për sa i përket zonës qendër të Vitisë, këtu e kemi kufinin, e kemi rritë për disa metra katror, d.m.th zonën urbane, pavarësisht asaj që i kemi pas në fillim të caktum kufit prej gjendjes ekzistuese kemi mundesu, sepse kemi parë që

zhvillimi në teren është ka anohet ka pjesa e ndërtimit dhe sipas kësaj e kemi sipas normave teknike te zonat rurale kemi shku, se si ligj dhe si normë e kemi që sa është numri, dendësia e banorëve aq duhet me caktu zonë dhe si është zona aktuale e ndërtimit. Tek Vitia me aq sa e kemi parë dhe parashikimin e popullsisë dhe jemi sipas rregullave dhe normave sa duhet me qenë sipërfaqja e ndërtimit në qendër të Vitisë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Ne e dimë që është tu shku çështja e zgjerimit, ndërtimit etj. A është parapa numri i banorëve, se ne kemi kërkesa. Më shumë se gjysma e banorëve të Komunës së Vitisë jan jashtë. D.m.th, a është parapa që ky zgjerim mundet me i përballu pjesës së banorëve? Se ata edhe pse janë 1-2 muaj këtu që jetojnë, ata zakonisht tentojnë me pas prona të veta dhe objekte të veta këtu.

**Përfaqësuese e UDT-së:** Me këtë me u lidhë te analiat kur të bëhen demografike, d.m.th referencë. E dimë që e kemi regjistrimin e popullsisë të 2011-ës, d.m.th legjitime e kemi atë. Ne duhet me planifku sipas asaj, po ne pavarësisht kësaj, e kemi marrë edhe vlerësimin që e qetë agjencia e statistikave çdo vit. Në bazë të saj me normat si shkojnë përlllogaritjet, prej 2011-ës sipas standardeve që janë për demografi, në bazë të saj i kemi bë atë lidhjen koordinimin deri për 10 vitet e ardhshme. D.m.th sa mundet me parashiku popullësinë në bazë të kësaj i kemi bë për me i dakordu me numër dhe sipërfaqe të ndërtimit dhe me numër të popullsisë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Plani tani është për 8 vite. Gjatë 8 viteve të ardhshme a ka mundësi nëse paraqitet një nevojë ose një kërkesë e vendit për një zhvillim, për një pjesë, për qasje, një investim të madh ndërkombëtar që nuk naj parashef plani zhvillimor. A parashef? D.m.th, ka mundësi Kuvendi diçka specifike që na delë me bë ndonjë revidim ose ndonjë plotësim gjatë kësaj periudhe brenda 8 viteve.

**Përfaqësuese e UDT-së:** ...  
**Përfaqësuese e UDT-së:** ...  
**Përfaqësuese e UDT-së:** ...

EZHK-në varet cilin dokument e ke në fuqi, e keni çdo 4 vite revidimin e planit me bë në bazë të kësaj tani si ka ndërru gjendja aktuale, në bazë të kërkesave, analiza që bëhet mundet me u bë revidimi i planit.

**z.Jakup Demiri:** Dua ta di deri ku kanë shku kufinjët e rrugës së Pozheranit apo "Hasan Prishtina" thirret, ruga "14 Qershori", a po amnistohet? Ato deri tash sa kanë qenë që kanë ndërtu jashtë kufinjëve të ndërtimit, a po e bëjmë me këtë farë planin zhvillimor njëfar amnistimi të tyre se tani na e qojmë deri aty, e ata vazhdojnë prapë dhe zihet toka bujqësore krejt. Dhe për një që më mirë mundet me tregu drejtori ndërtimet e larta ka janë orientu.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Ruga e Pozheranit është deri te lisi, kurse edhe ndërtimet nuk kanë dalë më andej lisi. Ndoshta ai lisi ka qenë barrier psikologjike për njerëzit. "14 Qershorin" nuk e di.

**z.Jakup Demiri:** I ardhshmi dihet që i ke deri në Pozheran, se ne vetëm i pasmi amnistu, tani ato ndërtuesit pa leje të planit zhvillimor të ardhshmit kur ta bënë kuvendi ka me shku deri në Pozheran. Krejt ata ndërtuesit që kanë ndërtu pa leje po amnestojkan dhe të tjerët vazhdojnë. Dhe kjo është që mua nuk po më pëlqen. Tek etazhiteti, unë nuk morra përgjigje. Nëse e dini sa kate kanë me u leju në Komunën e Vitisë.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Me hartat zonale përcaktohet etazhiteti.

**z.Jakup Demiri:** Pe di që me harta zonale, por hartat zonale ne nuk i kemi pas, dhe thash nëse keni informatë.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Ne e kemi planin urban e planet rregulluse që e lejojnë në Viti b+4 deri b+6 aktule që është në fuqi me hartat zonale. Pastaj sa e percaktojnë, a e bëjnë b+6 a b+10.

**z.Jakup Demiri:** A e percaktojmë ne apo e percakton tjetër kush?

**z.Visar Demiri, drejtor:** E percakton Kuvendi.

**z.Shqiprim Ahmeti, përfaqësues i UDT-së:** Te puna e njësimimit dhe etazhitetit, kjo me plan zhvillimor komunal kur të përcaktohen kufinjët ndërtimor të zonave urbane dhe zonave tjera. Nuk d.m.th që çdo kush që ka ndertu pa leje brenda asaj zone amnistohet, se është pastaj Ligji i Legalizimit, kufinjët ndërtimor përcaktohen për me vnu një kufi që, jashtë atyre kufinjëve nuk mundet me ndërtu dhe nuk mundet as me kërku leje, as me lëshu leje. Pastaj nuk mundet mu anashkalu as Ligji i Legalizimit e as tjera. Ata që kanë ndërtu pa leje, nese vazhdon procesi ajo është çështje edhe e Komunës edhe e inspektoriatit. Sa i përket etazhitetit, etazhiteti me norma teknike përcaktohet kështu: më së pari plani zhvillimor komunal nuk përcakton etazhitet, mirëpo janë normat teknike që percaktojnë etazhitet maksimal dhe aty shkon me numër të popullsisë. Sipas këtyre normave e ki një limit të popullsisë që, komunat që i kanë më pak se 50 mijë banorë i kanë etazhitë maksimal, dhe komunat që i kanë deri

100 mijë banorë i kanë etazhitet maksimal. Dhe kështu shkon me radhë në krejt komunat e Kosovës kur të behet harta zonale, këto me plan zhvillimor është bërë planifikim i popullsisë për 8 vitet e ardhshme. Kur të bëhet harta zonale popullsisë në atë zonë që është planifikime për ndërtim me kufinjndërtimor bëhet shpërndarja e dendësisë së popullsisë, pastaj etazhiteti kalkulohet në këtë mënyrë, por në çfardo rrethane, në çfardo mënyre nuk mundet me u kalu etazhiteti maksimal që është i percaktum me norma teknike të Ministrisë së Planifikimit Hapësinorë.

(Nuk dëgjohet)

**z.Basri Sylejmani:** Këta të UBT-së, këta masi e kanë bërë hartën zonale: a keni planifikim më së pari shkollë, rrugë, ambulancë? Këto të 3-ia janë kryesore që na vyen. Dhe mes Mediteranit dhe Vinexit a keni planifikim rrugë 10 metra, 15 metra sa shkon ajo, se ajo nuk marohet sot, se aty është industri e rëndë, ju edhe ato duhet me i planifikim.

**z.Illir Zuka:** Në Pozheran e kemi mbajtur një dëgjim rreth kësaj pike dhe ka pas shumë kërkesa të mira dhe legjitime. Për fat të keq e pash veç një kërkesë që është cek në procesverbal. D.m.th. prej Këshillit të Fshatit Novosellë. Gjë që këtu pak e fajsoj edhe drejtorin që, është dashtë me i marrë ato, se kemi pas kërkesa, e dinë shumë mirë për stadiumin, fushën ndihmese që kemi ndërtu, që është dashtë me u cekë në procesverbal dhe shumë pjesë tjera që kemi kërku që janë kanë kërkesa me vend të parashtruara, gjë që nuk janë cekë në procesverbal. Është një e cekt e Pozheranit që nuk ka marrë pjesë në mbledhje hiq, nuk e di ku e keni marrë. Nëse e keni marrë në kafe është diçka tjetër. E keni në procesverbal për kënd është fjala, d.m.th që nuk ka marrë pjesë në mbledhje hiq. Unë po besoj që ai dëgjim buxhetor që është mbajtur me 5 këshilla të fshatrave dhe që ka pas shumë qytetarë të interesum në atë dëgjim që kemi mbajtur dhe ka pas kërkesa shumë të arsyshme. Krejt atë dëgjimin e Pozheranit që është mbajtur, e pash veç një kërkesë që e keni shti në procesverbal, d.m.th e Këshillit të Fshatit Novosellë. Nuk kam kundër asaj asgjë, por ka pas shumë kërkesa tjera. Ka pas Pozheranit, Tërpezes, Zhiti etj. dhe prap vazhdoj me i qëndru asaj se, banorët e Pozheranit dhe pjesa e Vitisë me këtë plan zhvillimor komunal është e dëmtume për shkak të mos lejimit të ndërtimit të rrugës Pozheran-Viti.

**z.Jakup Demiri:** Te puna e kriterëve, tek përcaktimi i etazhiteteve. Ato i kemi diskutu qysh herët dhe e dimë që kriteri i parë thuhet vendimtar është edhe numri i banorëve. E këtu me nënkryetarin nuk pajtohem me të, se unë pjesën më të madhe të familjes 80% i kam jashtë, po krejt janë të regjistruar. Ky numër është sakt. Mendoj që Vitia nuk ka kumeditë sa banorë, se e dimë se çfar Komune është, po nënkryetar, se unë krejt familjarët i kam të regjistruar. Tash ne e dimë që është bërë edhe njëfar fushate për rritjen e etazhiteti, kateve të banesave, po ajo nëse është edhe ne të kërkohet ne të rritet, po ku janë premtu njerëzit që unë e bajë, po dashta me ditë sa është respektu i kalumi dhe a janë gjetë të gjeturat te plani zhvillimor komunal. Çka është ndërtu diçka që me marrë për bazë atë çka nuk ka funksionu, se krejt në kofshin respektu, plani zhvillimor komunal në Viti prej atë ditë që është bërë ka qenë në sirtar dhe kurr nuk është kqyrë. Ne qëtu jetojmë dhe këtë e kemi dilemën më të madhe, dhe tash çka po votojmë. I kemi rrugtë, kujna të ju mteket shtron ka të donë. Unë problemin më të madhë e kam këtu kur të diskutoj për projektet në fshatin tem, që nuk të respektohet vullneti i qytetarëve që kanë nevojë, por bëhet krejt diçka tjetër. Unë tash me krejt këtë material çka është e pamundur dhe nuk jam ekspert i asaj që unë tash me ditë, por ne pe dimë ku janë problemet, si banorë i dimë ku bëhen politikat komunale, se ne jemi këtu tu mbajtur mbledhje, e në katin e 11 janë tu punu punëtorët që është p+4 në katin e 11, pa siguri, pa asgjë hiq. Kam edhe një pyetje të shkruar për drejtorin e inspeksionit. Po e di që nuk ka autoritet, nuk ka fuqi, këta si kanë vazhdu ndërtimet pa leje në Komunën tonë, në qytetin tonë. Tash a po është njëfar amnistimi edhe për këta që është njëfar mafie e ndërtimit edhe këtu edhe në gjithë Kosovën, në gjithë vendin tonë, dhe na si të zgjedhurit e popullit, se kur ta kerkojm votën, pyetjen më të madhe e kemi këto farë senet që bëhen për bizneset e fuqishme. Qytetari i rendomtë edhe ai biznesmeni e kanë njëfar lufte që mos me thanë luftë të shpallur. Ne së paku një dokument të bazuar në ligj, në norma, e për qeta po pyes për kufijtë e ndërtimit. Prej njërit nga trajnimet që kemi qenë i kam bërë një pyetje një trajnerit, e kishim problemin e kanalizimit dhe ujësjellësit. Edhe ai tha: Kosova është shumë keq me dokumentacion edhe në praktikë, po problemi më i madh që kemi me pas, mos respektimi i kufijve të ndërtimit, që na vetëm sot ta kemi infrastrukturën e kanalizimit e shërbimet e shtetit për 3.5 milion banorë për mosrespektim të kufijve të ndërtimit. E paramendo tha, hala kur të rriten tha na e kemi mazhën tu ra të popullit

për shkak të ikjes.

**Përfaqësuese e UDT-së:** Për 8 vitet e ardhshme unë thash pa marr parasysh që kemi 2011-ën ligjitime regjistrimin e popullsisë, ne e kemi marr edhe vlerësimin vjet për vjet që e ban Agjensia e statistikav, edhe tu u lidh me ata e kemi bë popullsia rezidente dhe emigrantet e parashikuar për vitn 2030, e ku sipas saj për vitit 2023 popullsi rezidente janë 50 mijë e 236 banor, imigrim janë 14 mijë e 582. Total kur të merren krejt janë 64 mijë e 818. E kemi bë analizat edhe popullsisë rezidente edhe të emigranteve. Me u lidh me pyetjet se a janë plaifiku infrastruktura publike dhe sociale. Ne e kemi sipas normave, e dimë normat teknike të planifikimit sipas ligjit, se e dimë që ministria nuk po na lejon pa i plotësuar qato norma edhe ne me planifiku 10 ambulanta ose 10 shkolla fillore, ministria nuk na lejon nese e tejkalojmë normën teknike që është e përcaktume. E kemi marr ne numrin e popoullsisë, normat teknike, e kemi analzu dhe e kemi planifiku me pas çerdhe publike, shkollë të mesme profesionale, një QKF të planifikuar, ku secila është e planifikuar sipas normës që e kanë kerku.

**z.Visar Demiri drejtor:** Sa i përket pytjes se Ilirt, të gjitha kërkesat që janë kanë të ligjeshme të Pozharanit janë marr parasysh. As një kërkesë e jashtëligjshme nuk ka kalu në këtë plan të PZHK-së, prandaj nuk ke nevojë me fol me hamendje. Çdo kërkesë e infrastrukturës sportive, stadiumet janë përfshi në infrastrukturë sportive. Nuk e ke pa planin në detaje, kërkesat që janë ner lisin që po flasim jan refuzu, jan kategori e tokës se dytë dhe nuk le ministria. Vijat nderimore caktohe me ligje.

**z.Illir Zuka:** Visar, që nuk deshte me me kuptu është diçka tjetër thash në procesverbalin që e keni deklaru këtu pyetjet që janë parashtur, kërkesat për këshillave që kanë mbajt takim dikuj ju ka shkru që ju ka aprovu e dikujt ju ka refuzu. Po ekzistoj si kërkesa të bëra prej këshillave të fshatrave në procesverbal.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Edhe në fillim e thash, unë nese nuk me keni kuptu janë kanë 75 kerkesa të gjitha që kan pas të bejn me PZHK-ne janë perfshir qoft janë proanu ose jan refuzu i kemi edhe ne raport e ato të cilat nuk kan pas të bejn me PZHK-në nuk janë pefshi në raport kërkesat që janë bë në debatin publik ne Pozharan që nuk kan pas të bejn me PZHK nuk janë përfshi në raport.

**znj.Majlinda Shabani:** Pa dasht me e kometu pjesën e juaj që e keni bë profesionale, atë që sot çka po flasim na po flasim për gjendje reale që shofim në Komunën tonë e ku si çështje shqetësuese është edhe që po me intereson me ditë na. Ju sa i përket ndërtimeve të egera edhe sa i përket koeficientit të ndërtimit që kemi me mujt me i pa, po me intereson me ditë edhe në zonat në të cilat është parapa ndoshta edhe zhvillim i turizmit, sepse në Komunën e Vitisë kemi zona të cilat turizmi mundet me u zhvillu, e që realish shofim që pikërisht në ato zona kanë fillu me u bë ndërtimet. Me sa e di unë, nese një koeficien është më i ultë ajo është ndërtim i kufizuar që nuk lejohet me u bë shumë ndërtim të zgjeruar. E ne rast që është koeficienti me i lartë i bie që ndërtim mundet me u bë, po realish në Komunën tonë po thamë që kemi pas edhe ndërtime, vazhdojmë me pas ndërtime të papalanifikuara e që unë po kam dyshimet e mija që qeky plani zhvillimor a kish mujt me u praktiku në komunën e Vitisë, se me sa arrin, po thamë vetëm 50 % me u zbatu në komunën tonë, natyrisht që kish me pas një zhvillim shumë të mirë të Komunës, mirëpo ajo që bëjmë planin në dokument e ajo që nuk zbatohet në komune mandje edhe sfidat që i kemi janë krejt diçka tjetër që ne i shohim dhe përballemi me to.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Ne e dimi që në mungesë të planin zhvillimor komunal e kemi humb shtëpinë per persona me aftësi të kufizuar, që nuk e kemi pas pronën se ku me e ndertu këtë. Ne duhet me kerku se a e kemi të parapamë qeto gjëra në këtë plan, se nëse kur të marrim një vendim me ditë që a e kemi këtu në plan. Po du me ba edhe nje pyetje, se a kemi parapa ndonjë vend per impiant të ujrave të zeza, sepse na duhet patjetër gjatë tetë viteve të ardhshme, edhe ky proces i ujrave të zeza me përfundu. Ne mujmë me fitu një donacion ose një kredi qyshe e kanë bë disa komuna, mirëpo nese nuk e ki vendin e caktuar në planin zhvillimor per një impiant per ujra të zeza, na edhe me kalu naj kthen ministria jo të ligjshëm.

**z.Shqiprim Ahmeti, përfaqësues i UDT-së:** Faleminerit për pyetjen. Në secilin sektor e kemi trajnu në mënyrën me detajuar ajo që duhet me pas parasysh se, ne si UBT dhe si institut nuk e kemi bë planin prej zyrave po kemi pas me dhjetra takime dhe vorkshomi ka qenë ku jeni njoftu. Po ka edhe shumë takime që janë zhvillu në Komunë dhe në UDT. Ky plan është produkt i Komunës, kurse ne e kemi mbështet në aspektin profesional. Sa i përket pyetjes së impiantit të ujrave të zeza, tek objektivat zhvillimore. Qëllimi i dhjetë ka të bëjë me trajtimin

e ujrave të zeza dhe rrjetën e kanalizimit. Ky qëllim i ka pesë objektiva, ndërsa objektiva e pestë ka të bëjë direkt me impiantin e ujrave të zeza. Këtë e kemi përcaktu, kolegët profesionistë e kanë përcaktu që, duhet të bëhet lidhja e rrjetit të kanalizimit në impiantin regional për trajtimin e ujrave të zeza. Ne duhet me të infrastrukturën që me ndërlidh me impiantin regional për shkak se edhe impiantet e ujrave të zeza i kanë disa standarte. Shkon me numër të popullsisë dhe pastaj volumi, sasia e ujrave të zeza që derdhen në kanalizime, prandaj është parapa me e përshtatshme që mu lidh me impiantin regjiolan i cili do të zgjerohet. Janë parapa psh objekti 10.2 thotë: zgjerimi dhe përfundimi i rrjetit të kanalizimit për vendbanimet Binç, Buzovik, Debuldeh, Devajë etj. Sa i përket zhvillimit të turizmit, në këtë mënyrë dhe me këtë qasje është trajtu edhe zhvillimi i turizmit. E kemi qëllimin për zhvillimin ekonomik në përgjithësi dhe na kemi bashkë me Komunën e kemi parapa të nevojshme që zhvillimin ekonomik parimisht me e orientu nga bujqësia, industria e lehtë, industria bujqësore dhe përpunuese si dhe turizmin natyror, rural dhe kulturor. Sa i përket turizmit natyror, i kemi parapa vendbanimet dhe vendet ku ka potenciale, ku duhet mu zhvillu. Po si p.sh.: konkretisht kemi thanë shfrytëzimi i potencialeve për turizëm natyror dhe rural, sidomos në Debelldeh, Kabash, Letnicë, Sllatinë, Stubëll, Smirë dhe Terpezë, ndërsa sa i përket turizmit kulturor, kemi cek se, duhet të shfrytëzohet potenciali dhe të hartohen pastaj politikat konkrete, si në Letnicë, Binçë, Pozharan. Kemi edhe objektiva të sektorëve të tjerë. Patem edhe pyetje tek infrastruktura e shkollave, e ambulanteve. Ekzistojnë norma teknike të planifikimit hapësinorë, e cilat na determinon pastaj se sa shkolla duhet mu planifiku. Tash ta zëmë për shkollat fillore dhe të mesme duhet me qenë 2 metër katror për kokë të banorëve. Tash e patëm 65 mijë banorë deri vitin 2030. E rëndësishme është me e ditë se, në komplet Komunën e Vitisë duhet me pas 130 mijë metër katrorë hapësira shkollore, pastaj secili vendbanim analizohet popullsia dhe shifet se a ka infrastrukturë të mjaftuar. Tash ka vendbanime që ka më shumë nxënës se sa ka hapësirë e ku tejkalohet standarti minimal. Ndërkohë që ka hapësira e vendbanime ku mungon hapësira adekuate. Ne kemi thanë që, në Komunën e Vitisë duhet mu shtu edhe 8 mijë metra katror të hapësirës shkollore. Pastaj të plani i veprimit e kemi parapa se, në cilin vendbanim sa metër katror duhet të shtohet, ku ka nevojë të ndërtohet shkolla e re ose të ndërtohet nje aneks me qasjen e njëjtë. Kemi shku edhe tek shërbimet shëndetësore, shtëpitë e kulturës. E rëndësishme është me ditë që normat teknike, së paku minimale janë. Respekt!

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë e shpresoj që ky plan të gjenë zbatim në teren. Ju falenderoj për kontributin e dhanë UBT-së. Nuk mbet tjetër vetëm që me qit në votim për miratim edhe një duhet me ditë që nga mometin i miratimit të këtij plani deri në votimin e hartave zonale, bllokohet dhënia e lejeve të ndërtimit për pjesën tjetër, që mendoj me ndërtu. Leje të ndërtimit mundet të marrin vetëm ata çka janë në proces, që kanë fillu. Qes në votim për miratim Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë. Kërkoj me ngritje dore kush është pro. Me 16 vota pro, me 0 kunder, 4 abstenime miratohet Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031 i Komunës së Vitisë. Urime për qytetarët e Komunës së Vitisë.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

#### **8. Propozim vendim për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores "Liria" në Gjilan për një periudhë trevjeçare 2024-2025-2026**

Ështa fjala për mbështetje financiare të strehimores "Liria" për tri vite nga 5000 euro. Kemi pas edhe më herët marrëveshje të këtyllë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim qes në votim për miratim. Me votat e të gjithëve u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

#### **9. Informatë për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Vitisë**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Informatën që e keni para juve pasqyron përmbledhjen e aktiviteteve të realizuara që kanë qenë të përcaktuara me planin për integritet në fushën e menaxhimit financiar të aseteve të burimeve njerëzore etj. Matrialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**z.Bekim Azizi Kryesues i Kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për me diskutu, kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.

Si pikë e dhjetë e rendit të ditës kemi:

**10. Raporti i ekipit të auditimit social në Viti përmes programit të DEMOS-it**

Ky raport ka ardh sot. Ju dërgojmë edhe në email. Hapi debat për diskutim. Pasi që nuk ka për diskutim, ju falenderoj për kontributin e dhënë. Shihem në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

**Procesmbajtësi:**

**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**

**Bekim Azizi**

---



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES SË JASHTEZAKONSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftuan këshilltarët e Kuvendit Komunal të Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 13.01.2024 (e shtune) në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 14. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari i komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, z.Sokol Hyseni, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Ekrem Ymeri, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Anisë Zejnullahu, z.Reshat Azizi, ndërsa mungoi z.Sokol Shaqiri, z.Veton Ramadani, z.Basri Sylejmani, z.Illir Zuka, z.Arbnora Hajredini, znj.Marigona Avdiu z.Durim Sylejmani znj.Zyrafete Rama. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita! Përshëndetje të nderuar të pranishme dhe mirë se keni ardhur në seancën e jashtëzakonshme të thirrur me kërkesën e kryetarit të komunës pasi e kemi pranuar kërkesën dhe kemi të pranishëm z.William Walker, ish ambasadorin e SHBA-vë në misionin e OSBE-së në Kosovë. Me kërkesën e kryetarit të Komunës për këtë seancë të jashtëzakonshme dhe me dakordimin e shefave të grupeve parlamentare që ta shpallim qytetar nderi ish ambasadorin, z.William Walker, unë e kam ftuar këtë seancë të jashtëzakonshme me kërkesën e kryetarit të Komunës me një pikë të rendit të ditës të propozuar si:

### R e n d i t e

1. Propozim për miratimin e propozim vendimit për Shpalljen "qytetarë nderi" i Komunës së Vitisë, ish ambasadorin e SHBA-së në misionin e OSBE-së në Kosovë, z. William G. Walker

**Kryesuesi, z. Bekim Azizi:** Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit me ngritje të dorës të miratohet rendi i ditës. Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës. Të nderuar të gjithë ju të pranishmit, jam i nderuar që para jush të paraqes propozimin e kryetarit për shpalljen qytetar nderi të Komunës së Vitisë, z.William Walker, duke pas parasysh që ambasadori është njeriu më meritor, më i dashur, i cili në misionin e tij, veçanarisht në vitin 1998/1999 kur në Kosovë po bëhet gjenocid, spastrim etnik, po vriten qytetarët, po bëheshin masakrat, po bëhej lufta e UÇK-së me forcat policore ushtarake serbe, atëherë shpresa e vetme më e madhe e misionit të OSBE-së ishte për shqiptarët, ku ambasadori William Walker ishte pjesë në tërë territorin e Kosovës, fizikisht ishte ku kishte vrasje, spastrim etnik, aty ku ndodhshin gjërat e asaj kohe të rëndë. Ajo që mbahet mend e ajo që ndryshoj historinë ishte prezenca fizike e z.William Walker në Masakrën e Reçakut, ku 42 qytetarë u masakruan, dhe një deklaratë e ish ambasadorit thotë: nga ajo që pash nuk ngurroj ta përshkruaj masakrën. Ky është krim kundër njerzimit. Kjo deklartë dhe pamjet e vështria të asaj kohe përshpejtuan proceset në botën, shtetet

demokratike në misionet e ndryshme të kombeve të ndryshme dhe përshpejtuan konferencën e Rambujes konferencë e cila u organizua për të arritur një marrëveshje politike, mirëpo pasi marrëveshja politike nuk u arritë erdhë intervenimi i NATO-s dhe me atë intervenim me 12 qershor Kosova u lirua dhe Kosova prej atëhere është e lirë. z. William Walker vazhdoj punën duke ndihmuar deri në Pavarësinë e Kosovës, z. William Walker erdh në Kosovë si ambasador i SHBA-së në misionin e OSBE-së dhe mbet ambasador i përjetshëm i Kosovës gjithkund në botë. E falenderojmë shumë, i urojmë shëndet, jetë të gjatë.

**z. Ali Bajrami:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Një përshendetje e veçantë shkon për ish ambasadorin e SHBA-së, ish shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, z. William Walker. Të thuhet fjalët jan pak për punën dhe veprën që ka bërë si shef i misionit. Nomenklatura udhëheqëse e Komunës së Vitisë, në krye me kryetarin, Sokol Haliti, kryesuesin, Bekim Azizin dhe përberja e këtij Kuvendi, është nder dhe privilegj i përjetshëm, dhe jemi mirënjohës përjetësisht për të gjitha ato që i ka bërë për Kosovën. Edhe një here, z. Ambasador, të gjitha të mirat ju dhe familja juaj, shëndet, përjetësisht mirënjohës si qytetarë të Komunës së Vitisë dhe si shtet i Kosovës. Mbështetja e grupit parlamentar të LDK-së është pro këtij propozim vendimi.

**z. Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Para nesh kemi ish ambasadorin i cili për popullin tonë dhe për të gjithë ne këtu qe jemi dhe e mbajmë mend qe atë kohë ishte kohë pa kohë, për shkak të rrethanave që ishin, një falenderim i veçantë shkon për ambasadorin në emër tim dhe të grupit, po besoj edhe të popullut tim, që në një moment doli një personalitet siç është, z. William Wolker, që me një kohë të vështirë shpales gjendjen reale dhe të vërtetë të asaj që ndodhi në një fshat të Kosovës, që ishte në pjesën më të madhe të territorit të Kosovës, po që u bë shkëndija e zgjidhjes së problemit tonë si qytetar që ishim dhe do ishim në këtë vend. Falenderim i veçantë për gjithë kontributin e dhënë, e paqit shëndetin ju dhe familja e juaj z. Ambasador.

**z. Taulan Haxhiu:** Përshendetje të nderuar të pranishëm! I nderuari ambasador, të falenderojmë nga zemra per kontributin që e ke dhënë per Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës, të cilin po e gëzojmë ne sot. Unë për herë të parë të kam pa përmes televizorit, pikërisht me 15 janar të vitit 1999 në Masakrën e Reçakut. Ti me punën dhe përkushtimin tënd të pandalshëm i tregove botës që në Kosovë masakrohën fëmijë, pleq, gra. Ti i tregove Bashkësisë Ndërkombëtare dhe SHBA-së që të intervenojnë sa më shpejtë për ta mbrojtur një popull të pafajshëm. Fal teje, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, heronjëve të luftës, veteranëve, sot ne e gëzojmë me të shtrenjtën liri dhe Pavarësinë e Kosovës. Unë si shef i Partisë Demokratike të Kosovës, parti e dal nga lufta çlirimtare, nga themeluesit e saj të cilët padrejtësisht po mbahen sot ne Gjykatën e Hagës, Hashim Thaqi dhe Kadri Veseli, e mbështesim me shumë krenari dhe vullnet propozimin e kuvendit komunal, që të shpallim qytetarë nderi të Komunës së Vitisë. Zoti të ruajt i nderuar ambasador, faleminderit për të gjitha që i ki bë për Kosovën.

**Kryesuesi, z. Bekim Azizi:** Unë tani e qes në votim për miratim propozim vendimin për shpalljen "qytetarë nderi" i Komunës së Vitisë, ish ambasadorin e SHBA-së në misionin e OSBE-së në Kosovë, z. William G. Walker. Kërkoj me ngritje dore të votojmë për këtë propozim vendim. Kush është për? Të gjithë janë pro. Ju faleminderit! Kundër a ka, nuk ka, abstenim nuk ka. Si kryesues i Kuvendit konstatoj se me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë, z. William Wolker, ish ambasadorin e SHBA-së në misionin e OSBE-së në Kosovë shpallet qytetar nderi i Komunës së Vitisë. Urime z. Ambasador! Ftoj kryetarin e Komunës që, para juve të mbaj fjalën kryesore, të cilin e falenderojmë per propozimin që i ka bë Kuvendit.

**z. Sokol Haliti, kryetar i Komunës së Vitisë:** I nderuar ambasador Walker, shumë i respektuar, z. Ranall Hill, shef i sektorit politiko ekonomik pran Ambasadës Amerikane në Prishtinë, të nderuar të pranishëm, të gjithë qytetarët e Vitisë pa dallime që jeni këtu prezent. Arsyeja qe sot jemi së bashku këtu, është prania e një njeriu të madh e me vyrtyte të larta. Pesha e fjalës së tij karshi realitetit, ka bërë që historia e shqiptarëve të rishkruhet dhe ta informoj botën me atë që po ndodhte në Kosovë në kohë më të vështira. Është ky ambasadori, Wiliam Walker,



prandaj nuk bëhet e tepërt për shkak se edhe unë kam shkru, dhe do të doja një duartrokitje të madhe për ambasadorin Walker, për kontributin e tij që ka dhënë. Ambasadori William Walker është një figurë e shquar që ka lënë ndikim thelbësor në zhvillimet dhe transformimet në Kosovë gjatë periudhës së tij të shërbimit. Me një karrierë të pasur diplomatike dhe një përkushtim të veçantë ndaj çështjeve të Ballkanit dhe të drejtave të njeriut. Ambasadori Walker ka qenë një udhëheqës i shquar dhe një ndihmës i palodhur në rugën drejtë paqes dhe stabilitetit në këte rajon të nderlikuar. Ambasadori Walker mori detyrën e tij në krye të misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, në vitet më të rënda 1990, në një periudhë kritike për rajonin. Roli i tij ka qenë shumë i ndjeshëm, pasi Kosova ishte në mes të konfliktit dhe sfidave të mëdha politike dhe etnike, për çka shquhej edhe për aftësinë e tij të menagjoj dhe ndihmoj në dialogun mes palëve të përfshira në konflikt. Ka qenë kontribut i rëndësishëm i ambasadorit edhe monitorimi i ngjarjeve dhe situatës në terren. Ai luajti një rol kyç në raportimin e objektivave për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe ngjarjet e ndryshme që ndodhën gjatë kohës së konfliktit. Kjo ndihmoi në rritjen e ndërgjegjësimit ndërkombëtar dhe mbështetjen për veprime konkrete për të adresuar krizën humanitare në Kosovë atëhere. Duke ndihmuar në negociata dhe duke nxitur dialogun mes palëve, ai ka luajtur një rol kyç në përcaktimin e të ardhmën e pavarur të Kosovës. Të nderuar të pranishëm, të hënë më 15 janar shënohet 25 vjetori i një prej ngjarjeve më të përgjakshme në fshatin Reçak të Shtimes, masakres, kur forcat serbe vranë 45 civilë shqiptar, qytetarë të Kosovës. Ishte shefi i misionit vëzhgues të OSBE-së, ambasadori William Walker, këte ngjarje me të parë, në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar e pati cilësuar pa mëdyshje si një krim kundër njerëzimit. Historia e Reçakut nuk do të ishte e njohur dhe e dokumentuar në të njëjtën mënyrë pa ndihmën dhe përkushtimin e këtij njeriu të madh. Masakra e Reçakut ishte një moment dramatik dhe tragjik për popullatën civile, por aty ishte njeriu që nuk u tremb. Ai, së bashku me ekipin e tij monitorues mori një qëndrim të prerë dhe të paanshëm ndaj të vërtetës. Vëzhgoi personalisht vendngjarjen në Reçak, raportoi dhe e cilësoi se, masakra ishte rezultat i një operacioni ushtarak serb kundër civilëve të pafajshëm. Ky raport i sinqertë dhe i drejtë ndikoi shumë në ndërgjegjësimin ndërkombëtar dhe në formimin e një opinioni të fortë për nevojën e nderhyrjes për mbrojtjen e popullsisë civile në Kosovë. Kontributi i tij në dokumentimin dhe raportimin e masakres së Reçakut, rezultoi pastaj me pasoja të mëdha për regjimin e Millosheviqit që synim kishte spastrimin e Kosovës nga popullata shqiptare. Ky moment dramatik, sherbeu si një pikë kthese në vëmendjen nderkombetare për të ndaluar dhunën dhe për të përmirësuar situatën humanitare në rajon. Tani 25 vjet me vonë, që kur ka ndodhur kjo ngjarje makaber, duam të nderojmë dhe të falënderojmë Ambasadorin William Walker për kujdesin dhe guximin e tij në ballafaqimin me të vërtetën dhe për kontributin e tij në zbulimin e shkeljeve të drejtave të njeriut në Kosovë. Fjala dhe veprat e tij mbeten një testament i jashtëzakonshëm për forcën e një njeriu të vendosur dhe të përkushtuar për drejtësi dhe paqe. Me pasionin dhe vendosmërinë e tij, Ambasadori William Walker ka lënë një trashëgimi të vlefshme në historinë e Kosovës. Kontributi i tij është vlersuar si një pjesë e rëndësishme e procesit të ndërtimit të një shoqërie demokratike dhe multietnike në Kosovë. Edhe tani, ambasadori Walker, vazhdon të jetë një mbështetës i pazëvendësueshëm për zhvillimet në rajon dhe një kritik i ndjeshëm i cdo shkeljeje të drejtave themelore të njeriut. Të nderuar të pranishëm, zonja e zotërinj të nderuar edhe përfaqësues të tjerë nga mërgata i nderuar drejtor egzekutiv i asosacionit të komuneave të Kosovës dhe të gjithë që jenë të pranishëm e që nuk i kam përmendur në pjesën formale, për kontributin e jashtëzakonshëm në afirmimin e qështjes së Kosovës në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar në vërtetimin e gjenocidit serb ndaj shqiptarëve dhe sensibilizimin për masakrën e Reçakut gjithashtu në shenjë kontributit madhor të tij për lirin dhe të drejtat e njeriut në Kosovë dhe për informimin e botës mbi pasojat e tmerrshme të luftës në vendin tonë, për përkushtimin dhe shërbimin e tij të palëkundur në fuqizimin dhe promovimin e stabilitetit në Kosovë në cilësinë e kryetarit të Komunes së Vitisë dhe në emër të qytetarëve të saj, me propozimin tim dhe me aprovimin e vendimit edhe nga

ana e Kuvendit Komunal, për kontributin e tijë madhor shpallim qytetarë nderi ambasadorin Wiliam Walker, të cilin e ftojme dhe ta pranoj qelsin e qytetit të Vitisë.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Tani ja japim fjalën z.Wiliam Walker para qytetareve të Komunës së Vitisë.

**z.William G. Walker, ish ambasadorin e SHBA-së në misionin e OSBE-së në Kosovë:** Kam ardh sot në Viti për 2-3 arsye të ndryshme. E para është të pranoj urdhërin, me që kryetari tani tregoj, dhe e dyta të shof mjaft qytetarë të kësaj pjese të Kosovës, dhe e treta është se, më pëlqen me ardhë në Kosovë. Po filloj me të tretën, e cila është e barabart me ato dy të parat. Para 25-30 viteve më parë një djalosh i ri nga Vitia e lëshoj këtë vend, më është bërë fqinji im për disa vite në Washington D.C për 17-18-19 vite. Shumë shpesh e shofë këtë djalosh. Tani është një përsori i moshës mesatare, ai është në rajonin e Washingtonit, familja e tijë është aty si shumë të tjerë me mijra që kanë kalu në diaspor, edhe ky zotria është vendos, aty mirë ka punë, i ka të gjitha aty, por diçka që nuk duhet të krenohemi me këtë person është se, prej që ka shku nuk është kthi më. Gjithmonë e kam pyet kur do të kthehesh në Viti dhe pastaj ka thënë: kur e ke ti ndërmend, kur të shkojsh ti ka me shku edhe unë me ty. Unë prej 2000-ës, çdo vit që mundem. Kam qenë në vitin e kaluar me 15 janar, sahere që mundem vij këtu. Gjithmonë në ceremoni i vizitoj varrezat e Jasharve dhe gjithmonë të kem ato memorialët e tyre që duhet ti vizitoj. Sa here që kthehem shofë ndryshime të reja dhe mendoj që, Kosova me të vërtet do të jetë një dritë e bardhë e ndritur në Kosovë. Arsyja pse nuk kam ardhë 2-3 vitet e fundit është se, jam martu me një vajzë të re dhe se besoj që dikush është këtu 88 vjeçar, dhe ka me u martu për 2 javë. Këtu për vete e kam një grua të re, tani ja kjo është arsyeja pse erdha tani përseri. Ky perosni i Vitisë që e ka lanë para 25/30 viteve, për tërë këto vite që ka qenë jashtë Kosovës, jam shumë kureshtar ta shof, pasi që të kthehem, pas gjithë këtyre viteve që nuk ka qenë, i shef ai ato ndryshime çfarë ai ka parë ndryshe, a dinë me hecë nëpër qytet, a është i vetëdijshëm për ndryshimet që kanë ndodh në Kosovë e posa qerisht në Viti. Pe kuptoni arsyen pse kam ardhë. Pas disa ditëve dhe shkoj edhe pe dini arsyen pse kam ardhë me marrë atë grua. Thashë me dashurinë që e kam për Kosovën, kam edhe një dashuri tjetër prej El Salvadorit. Bashkëqytetri i juaj dhe disa të tjerë për fund kanë folur qysh prej kur më ka vdek gruaja, se duhet të marthem me një grua shqiptare, por kanë refuzu. Kështu që më është dashtë të shkoj në El Salvador. Faleminderit të gjithëve!

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Të nderuar të pranishëm, të nderuar anëtarë të Kuvendit, qytetarë të Komunës së Vitisë, me kaq po e mbyllim këtë seancë për sot, duke ju ftuar që në hollë të bëhet dhe zbulimi i bustit për ambasadorin Wiliam Walker, që e ftojme për zbulim përfaqësuesin e ambasadës amerikane, z.Hill, përfaqësuesin e OSBE-së, kryetarin e Komunës dhe ne do të jemi së bashku me ta. Faleminderit për pjesëmarrjen!

Mbledhja përfundoj në ora 16:30

**Procesmbajtësi**  
**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi I Kuvendit Komunal**  
**Bekim Azizi**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosova



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Vitina



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prisur - Prillogje Më Dure 23-01-2024 vitin

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Sht./çës Prilog	Vlera Vendimet
02	-052	/02-	95

***Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës për  
periudhën janar – dhjetor 2023***

***Viti, Janar 2024***

# PËRMBAJTJA

## KAPITULLI I

### Përmbledhje ekzekutive

- Hyrje ..... 3

## KAPITULLI II

### Raportet e zyrave të kryetarit

- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ..... 4
- Zyra për Barazi Gjinore ..... 6
- Zyra e Prokurimit ..... 7
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun ..... 8
- Zyra për Integritet ..... 10
- Zyra për Projekte ..... 10

## KAPITULLI III

### Raportet e Drejtorive

- Drejtoria për Administratë ..... 11
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim ..... 15
- Drejtoria për Inspeksion ..... 18
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë ..... 20
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ..... 25
- Drejtoria për Arsim ..... 38
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ..... 47
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ..... 49
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ..... 55
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ..... 56

# KAPITULLI I

## Hyrje

Komuna si njësi themelore e pushtetit lokal funksionon në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/08), Statutit të Komunës si akti më i lartë i Komunës si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fushëveprimi i saj.

Qeverisja e mirë në komunën tonë ka qenë dhe do të jetë ndër objektivat tona kryesore dhe në përputhje me planin tonë strategjik, me të cilin plan synojmë të kontribuojmë në përmirësimin e shërbimeve komunale. Modalitetet e qeverisjes sonë gjatë kësaj kohe për të cilën raportojmë janë karakterizuar me ngritjen e performances në të gjithë sektorët, cilësinë e shërbimeve si dhe transparencën komunale.

Politikat publike të Komunës dhe harta e investimeve komunale janë treguesit më të mirë se, Komuna e Vitisë ka shënuar rritje të besimit politik te qytetarët, te grupet e organizuara me interes, siç janë: bizneset, OJQ-të dhe shoqëria civile në përgjithësi. Janë rritur parametrat e vlerësimit të punës, është rritur cilësia e punimeve në infrastrukturë, si: rrugë, kanalizim, ujësjellës, mbrojtje të mjedisit, e të tjera.

Sa i përket funksionimit të shërbimit civil të Administratës Komunale të Vitisë, shërbimi civil është i paanshëm dhe i përgjegjshëm, ku këtë e dëshmon më së miri klima antidiskriminuese që është krijuar në administratë, në të cilën çdo shërbyesi civil i është krijuar hapësirë e nevojshme veprimi për t'i shprehur mendimet e veta profesionale, gjë që ka rezultuar edhe me ngritjen e efikasitetit të punës në Administratën Komunale.

Raporti pasqyron punën e të gjitha organeve komunale, duke përfshirë zyret e kryetarit dhe drejtoritë komunale me sektorët e tyre për periudhën janar – dhjetor 2023, me prioritetet si në vijim:

- Rritja e efikasitetit në Administratë;
- Zhvillimi i bujqësisë;
- Shëndetësia, arsimi, kultura dhe sporti;
- Infrastruktura locale;
- Shërbimet publike;
- Zhvillimi ekonomik;
- Përkujdesja për shtresat e varfëra dhe grupet e marginalizuara;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët;
- Mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës.

## KAPITULLI II

### Raportet e Zyrove të Kryetarit

#### Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ)

Qëllimi i këtij raporti është pasqyrimi i punës njëvjeçare të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë.

Mbështetur në objektivat, qëllimet dhe kompetencën ligjore që ka NJMBNJ-ja me përshkrim, në pika të shkurta paraqesum këtë raport të punës për periudhën janar - dhjetor 2023. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2023 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Zyrarët Publik, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin e Punës, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetërore, Ligjin e Punës si dhe aktet tjera nënligjore: Statuti i Komunës dhe Vendimi mbi Organizimin e Organeve Komunale dhe aktet tjera nënligjore të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Për vitin 2023, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me kryetarin e Komunës ka hartuar planin e personelit në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria e Administratës Publike - Departamenti i Shërbimit Civil si dhe drejtoritë përkatëse, në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Mbështetur në këtë kemi klasifikuar këto aktivitetet:

#### **Konkurset dhe zhvillimi i procedurave të konkursit**

Mbështetur në planin e punës së NJMBNJ-së si dhe duke u mbështetur në kompetencat ligjore, NJMBNJ në pajtim me ligjin dhe aktet normative ka zhvilluar procedurat e konkurseve të brendshme, ngritje në detyrë apo lëvizje paralele. Të gjitha procedurat e konkurseve janë zhvilluar falë bashkëpunimit me drejtoritë përkatëse të Komunës së Vitisë, përkatësisht zyrtarëve të drejtorive përkatëse si dhe falë bashkëpunimit të komisioneve rekrutuese, të cilët kanë qenë të pavarur në punë dhe ju kemi ofruar ndihmë profesionale teknike.

Mbështetur në këtë paraqesum aktivitetet e rekrutimit apo pranimit në punë të punëtorëve na pajtim me planin e punës, duke i radhitur aktivitetet sipas drejtorive komunale:

#### **Drejtoria për Administratë - këto pozita:**

Për pozitën asistent administrativ kanë konkuruar 16 kandidatë, ndërsa është pranuar një kandidatë; për pozitën zyrtar ligjor kanë konkuruar 14 kandidatë, është pranuar (1) një kandidat; për pozitën udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve të Përbashkëta dhe Teknologji Informatike kanë konkuruar 8 kandidatë dhe është pranuar (1) një kandidat; nga lista pritëse në shërbimin e gjendjes civile është plotësuar me një (1) kandidatë. Për të gjitha këto pozita procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrar Publik dhe Rregullorës për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil.

#### **Drejtoria për Inspeksion, këto pozita:**

Për pozitën udhëheqës i Sektorit për Inspeksion kanë konkuruar 6 kandidatë, ndërsa është pranuar një kandidat; për pozitën inspektor i ndertimit ka konkuruar (1) një kandidatë dhe është pranuar (1) një candidate; për pozitën inspektor i tregut kanë konkuruar (3) tre kandidatë dhe është pranuar (1) një kandidat. Për të gjitha këto pozita procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrar Publik dhe Rregullorës për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil.

#### **Drejtoria për Arsim, këto pozita:**

Duke u mbështetur në Ligjin për Zyrar Publik si dhe duke u mbështetur në kërkesat e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Viti, NJMBNJ-ja ka shpallur konkurs dhe ka rekrutuar personelin arsimor. Brenda periudhës janar

- dhjetor 2023, NJMBNJ-ja ka realizuar 11 konkurse dhe një konkurs në proces për pozitën mësimdhënës i Matematikës dhe Gjuhës Angleze, dhe një konkurs për pozitën punëtor teknik.

Nga të dhënat që posedojmë, në këto konkurse kanë konkuruar 195 kandidatë, duke përfshirë personel udhëheqës (drejtorë shkollash), personel mësimdhënës (professor/eshë lëndor, mësimdhës lëndor 6-9, mësimdhënës klasor 1-5, edukator/e), staf mbështetës (punëtor teknik). Pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitat e kërkuara në konkurs, janë pranuar në punë 66 persona.

- Mësimdhënës janë pranuar 63;
- Drejtor i shkollës është pranuar (1) drejtor në IAAP "Jonuz Zejnullahu" në Viti; dhe
- Punëtor teknik janë pranuar 2 punëtor teknik.

### **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, këto pozita:**

Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – QKMF, në konkursin për mjek të përgjithshëm kanë aplikuar 10 kandidatë, ndërsa janë pranuar 5 kandidatë; për pozitën laborantë pranë QKMF-së kanë aplikuar 5 kandidatë, është pranuar (1) një kandidatë; për pozitën farmacist pranë QKMF-së kanë aplikuar 2 kandidatë, është pranuar (1) një candidate; për pozitën punëtor teknik pranë QKMF-së kanë aplikuar 5 kandidatë, është pranuar (1) një kandidat. Kurse në administratën e DSHMS-së - Qendra për Punë Sociale, nga lista pritëse janë pranuar dy (2) zyrtarë për mirëqenie sociale, për të cilat pozita është shpallur konkursi public, pranim i jashtëm, dhe procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik.

### **Drejtoria për Financa, këto pozita:**

Në Drejtorinë për Financa, në konkursin për zyrtar për regjistrimin e bizneseve kanë aplikuar 9 kandidatë, ndërsa është pranuar 1 kandidat; në Sektorin e Tatimit në Pronë për pozitën zyrtar i tatimit në pronë kanë aplikuar 29 kandidatë, është pranuar (1) një kandidat, për të cilat pozita është shpallur konkursi public, pranim i jashtëm dhe procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik.

### **Drejtoria për Bujqësi ka këto pozita:**

Për pozitën udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë, levizje paralele, është përfunduar, por pa kandidat të interesuar; zyrtar të bujqësisë, është zhvilluar procedura e brendshme, nuk ka pasur kandidatë, andaj janë emëruar dy zyrtar nga lista pritëse.

### **Zyra e Kryetarit të Komunës**

Për pozitën udhëheqës i Sektorit të Auditimit kanë konkuruar 7 (shtatë) kandidatë, ndërsa është pranuar një (1) kandidat; për pozitën specialist i auditimit kanë konkuruar 7 (shtatë) kandidatë, ndërsa është pranuar 1 (një) candidate; për pozitën përfaqësues ligjor i Komunës kanë konkuruar (3) tre kandidatë dhe është pranuar (1) një kandidat; për pozitën zyrtar i prokurimit, konkurs i brendshëm, ka konkuruar (1) një kandidat dhe është pranuar (1) një kandidat; për pozitën specialist i përkthimit kanë konkuruar 7 (shtatë) kandidatë, ndërsa është pranuar 1 (një) candidate. Për të gjitha këto pozita procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik dhe Rregullorës për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil.

### **Mjetet juridike dhe shqyrtimi i tyre**

Duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, e drejta për shfrytëzim të mjeteve juridike në procedurë administrative është parim primar, prandaj mbështetur në këtë, gjatë fazës së rekrutimit si dhe punës së përditshme të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, palët në procedurë administrative kanë shfrytëzuar mjetet juridike. Mbështetur në kompetencë, këtyre mjeteve u janë përgjigjur komisionet e ankesave në afat ligjor:

- Komsioni për nëpunësit e shërbimit publik (Arsim dhe Shëndetësi) ka shqyrtuar 15 ankesa dhe të cilat janë refuzuara si të pabazuara;

- Vendime të shkuarjes në pension dhe lirim nga shërbimi civil të 14 (katërmbdhjetë) zyrtarve të shërbimit civil, përpiluar nga NJMBNJ-ja;
- Vendim për pushime pa pagesë për 1 vit, një shërbyes civil.

Pavarsisht që Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të gjithë kandidatëve ju ka dhënë të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike në procedurë të rekrutimit, ka persona të cilët kanë etiketuar përmes (Kuvendit Komunal), njëra nga këshilltaret komunale ka akuzuar NJMBNJ-në, kinse për shkelje të proceurave të rekrutimit dhe mohimit të punësimit, edhe pse nga NJMBNJ-ja, udhëheqësi i saj ka dhënë përgjegje se, procedurat janë zhvilluar sipas ligjit në fuqi. Kjo u vertetua edhe me hedhjen poshtë të dy kallëzimeve penale si të pabazuara nga ana e Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda, të cilat i kishte ushtruar pranë prokurorisë assembleistja A.H. Pas marrjes së njoftimit nga ana e prokurorisë, u konfirmua se, NJMBNJ-ja, udhëheqësi i saj ka zbatuar në përpikëri Ligjin për Zyrtar Publik.

Gjithashtu janë kryer edhe vendime, shkresa të ndryshme rutinë që janë natyrë e punës administrative dhe zyrtare.

### **Vlerësimi i performancës (rezultate në punë) së zyrtarëve publik**

Në kordinim me drejtoritë përkatëse, për të gjithë zyrtarët publik është bërë vlerësimi i rezultateve të punës konform rregullave që janë në fuqi. Ky proces është bërë duke rrespektuar rregullat, ku mbikëqyerësit të drejtpërdrejt kanë vlerësuar rezultatet në punë të zyrtarëve të tyre, në kuadër të departamentit përkatës. Kurse NJMBNJ-ja ka monitoruar dhe ka sistemuar vlerësimet në dosjet e tyre personale.

Gjatë vitit 2023 vëmendje ju është kushtuar **nevojave për trajnimin** e nëpunësve civil ekzistues dhe nëpunësve të rinj. Në bashkëpunim me IKAP-in janë mundësuar trajnime për profilet përkatëse tek nëpunësit ekzistues dhe trajnimi hyrës për nëpunës të rinj.

**Dosjet Individuale** elektronike për nëpunës të shërbimit publik dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës janë përpunuar gjatë vitit 2023, duke u ngarkuar dokumente relevante të secilit nëpunës, ndërsa dosjet individuale elektronike për shërbimin civil janë përpunuar dhe plotësuar edhe gjatë vitit 2023.

Njësia për Menaxhimin të Burimeve Njerëzore ka përpiluar planin e personelit për vitin 2024 përmes SIMBNJ/HRMIS. I njëjti është dërguar për aprovim tek udhëheqësi më i lartë administrativ për aprovim. Pas aprovimit i njëjti është dërguar në DMZP në Prishtinë.

Ku raport është punuar në përputhje me nenin 16, paragrafi 4 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr.08/L197.

## **Zyra për Barazi Gjinore**

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë periudhës janar – dhjetor 2023, ku prej tyre veçojmë:

- Monitorimi i ligjeve të aplikueshme në funksion të të barazisë gjinore nga institucionet komunale dhe harmonizimi i akteve normative;
- Organizimi i dy trajnimeve për obligimet që dalin për komunat nga Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, procedurat standarde të veprimit, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje si dhe Konventa e Stambollit, trajnim ky i organizuar për anëtarët e mekanizmit komunal kundër dhunës në familje;
- Organizimi i fushatës “Java e edukimit për barazi gjinore”, e cila u zhvillua përgjatë muajit mars;
- Organizimi i trajnimit për Protokollin Shtetror kundër sulmeve seksuale, organizuar për anëtarët e MKKDFH;
- Formimi i Ekipës për të Drejtat e Fëmijës dhe hartimi i Planit për të drejtat e fëmijës (në proces të hartimit), konform UA për themelimin e EDF në komuna;



- Caktimi i indikatorve raportues për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi;
- Caktimi i indikatorëve raportues për të drejtat e njeriut;
- Organizimi i fushatave për parandalimin e dukurive negative me këto tema: parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore, parandalimi i keqpërdorimit të rrjeteve sociale nga të rinjtë, pasojat nga përdorimi i narkotikëve, parandalimi i shunës në familje;
- Në shtator u shënuar Java për kompensimin e viktimave të krimit;
- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit në referimin dhe shqyrtimin e ankesave të qytetarve për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet komunale;
- Ofrimi i rekomandimeve për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe barazinë gjinore në veçanti për drejtoritë komunale;
- Përfshirja e perspektivës gjinore në KAB-in 2024-2026 dhe caktimi i prioriteteve që eliminojnë pabarazitë gjinore në ndarjen e buxhetit komunal;
- Planifikimi i buxhetit komunal nga perspektiva gjinore;
- Analizë gjinore në Kulturë, Rini dhe Sport;
- Analizë Gjinore në sektorin e bujqësisë;
- Përcaktimi i masave afirmative për avancimin e barazisë gjinore në Komunë;
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera: zhvillim ekonomik, punësim/mirëqenie sociale, shëndetësi dhe procesin e vendimmarrjes;
- Organizimi i trajnimit kundër ngacmimeve seksuale në vendin e punës, mbështetur nga ABGJ dhe IKAP ( të trajnuar 18 zyrtarë);
- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunësim) përmes ndarjes së granteve për zhvillimin e bizneseve (biznese për përpunimin e ushqimit), në partneritet me IADK, IKC, Caritas Zvicerran;
- Hatimi i Strategjisë kundër Dhunës në familje dhe planit të veprimit 2024-2026 (në proces);
- Aktivitete tjera të vazhdueshme.

## Zyra e Prokurimit

Përmes këtij raporti do të paraqesim të dhëna e aktivitetet e prokurimit të përmbledhur, që janë zhvilluar për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve, gjegjësisht investimeve kapitale dhe furnizimeve me gjëra të ndryshme, bazuar në kërkesat dhe nevojat e AK-së që janë domosdoshmëri për plotësimin e aktiviteteve të Komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore si dhe për plotësimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të Komunës si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara sipas buxhetit të këtij viti e që është në interes të komunitetit dhe rritjen mirëqenies qytetare në përgjithësi, punët dhe aktivitetet që Zyra e Prokurimit i zhvillon për një vit buxhetor, gjegjësisht kalendarik.

Në periudhën e vitit janar - dhjetor 2023, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese dhe nevojave të tyre, zyra ka inicuar 74 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna: 20 aktivitete me lëndë prokurimi, Shërbime; 24 aktivitete me lëndë prokurimi, Punë; dhe 30 me lëndë prokurimi, Furnizime. Nga këto aktivitete, 70 janë përmblyll si aktivitete, 4 të tjerat janë anuluar, ndërsa lloji i procedurave të udhëhequra janë si vijon: 58 raste është përdorë procedura e hapur; 10 raste procedura e kuotimit të çmimit dhe 1 aktivitet procedurë me vlera minimale; 3 aktivitete procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, dy miniprocedurë. Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 69 aktivitete të prokurimit janë përmblyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave, ndërsa 4 aktivitete të prokurimit janë anuluar dhe një (1) aktivitet është në procedurë të ankimimit.

Zyra e Prokurimit përveç këtyre aktiviteteve ka realizuar edhe pagesa për operatorët ekonomik që kanë kryera punë, furnizime apo shërbime, sipas kontratave që kanë me komunën tonë. Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është 13,064.494.96 €.

Ndër aktivitetet që zhvillon Zyra e Prokurimit është edhe nxjerrja e urdhërblereve dhe procedimi i pagesave. Gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar **1201 urdhërblere** për pagesën e OE-së të kontraktuar, duke udhëhequr lëndët për kompletim dhe janë dërguar në thesar për pagesë, gjegjësisht ekzekutim. Zyra e Prokurimit ka kryer edhe 128 rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlerësim dhe komisioneve tjera. Në fund duhet potencuar se, Zyra e Prokurimit gjatë viti fiskal 2023 ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarvajtjes së punëve në Komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi, por edhe ka pranuar dhe proceduar të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga këto njësi.

## **Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun**

Gjatë vitit 2023, respektivisht periudhës janar-dhjetor, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e Komunës së Vitisë ka qenë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale. Fatkeqësisht edhe ky vit është karakterizuar kryesisht me mos funksionimin e rregullt të webfaqeve standarde të komunave [kk.rks-gov.net](http://kk.rks-gov.net), që është në përgjegjësi të nivelit qendror. Megjithatë kjo zyre ka vazhduar punën duke përcjellë të gjitha aktivitetet e rregullta, por edhe të veçanta si dhe ka njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në Komunën e Vitisë, kryesisht në llogarinë e saj në facebook (për shkak të mos funksionimit të webfaqës). Po ashtu nga ZIMP janë përdorur edhe kanalet e tjera informative, si: platforma e konsultimeve publike. Më poshtë keni disa përmbledhje të publikimeve të bëra në wefaqen zyrtare të komunës:

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun gjatë kësaj periudhe ka publikuar dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimin në punë;
- Nga procedura e prokurimit janë publikuar 83 kontrata të nënshkruara, 24 njoftime për kontratë, 23 njoftime për dhënie të kontratës dhe 1 plani i prokurimit publik për vitin 2023;
- Janë publikuar gjithashtu edhe 133 njoftime publike, 58 vendime të Kuvendit Komunal, 60 vendime të kryetarit të Komunës, shumica e draft dokumenteve të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal;
- Po ashtu janë publikuar edhe disa plane e raporte si dhe dokumentet të cilat ndërlidhën me shpenzimin e paras publike;
- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga Komuna e Vitisë edhe përmes fotografive;
- Zyra për Informim Publik ka përcjell aktivitetet e kryetarit të Komunës apo edhe të zyrtarëve të tjerë komunal në terren;
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaja në Komunën tonë;
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: shpallje, konkurse, tenderë, njoftime etj;
- Në kuadër të punës së Zyrës për Informim Publik janë pranuar dhe shqyrtuar 24 kërkesa për qasje në dokumentet publike. Nga to 20 sosh janë aprovuar plotësisht, 1 është refuzuar dhe 3 kanë mbetur pa përgjigje (sipas raportit final të dërguar në AIP);

- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtoritë dhe mbledhjet e ndryshme që lidhën me punën e kësaj zyre;
- Janë mbajtur edhe dy debatet e rregullta të kryetarit të Komunës me qytetarë;
- Gjithashtu me qëllim të planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2024-2026, në organizimin e Kuvendit Komunal dhe në bashkëpunim me DEFZH-në janë mbajtur diskutime publike me qytetarë dhe grupet e interesit;

Më poshtë keni një tabelë të takimeve publike të mbajtur me qytetarë gjatë vitit 2023

Nr	Takimi	Data	Vendi	Meshkuj	Femra	Gjithësi
1	Konsultim publik lidhur me propozim rregullorën për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Vitisë	18.04.2023	Viti	20	4	24
2	Dëgjim buxhetor 2024-2026 në Viti	19.09.2023	Viti	11	15	26
3	Diskutim publik për projektet e ujesjellësit në fshatrat: Ramjan, Fshati i Ri, Radivojë dhe Devajë	18.07.2023	Viti	18	0	18
4	Diskutim publik lidhur me Rehabilitimin e rrugës nacionale N 25.3 Segmenti Klokot-Gjilan L+11.00KM	16.06.2023	Viti	11	4	15
5	Diskutim publik për Kornioën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 nga Komiteti për Politikë dhe Financa	26.06.2023	Viti	13	6	19
6	Konsultim publik lidhur me propozim rregullorën për Taksa, Ngarkesa dhe Gjebra 2024	04.09.2023	Viti	0	0	0
7	Diskutim publik për planifikimin e buxhetit komunal 2024-2026 në Skifteraj (Gjylekar)	18.08.2023	Gjylekar	9	4	13
8	Diskutim publik për planifikimin e buxhetit komunal 2024-2026 në Pozheran dhe lokalitet për rreth	18.08.2023	Pozheran	13	4	17
9	Diskutim publik për planifikimin e buxhetit komunal 2024-2026 me grupet e interesit	16.08.2023	Viti	6	32	38
10	Diskutim publik për planifikimin e buxhetit komunal 2024-2026 në Viti	15.08.2023	Viti	9	5	14
11	Debat i parë i rregullt i kryetarit të komunës janar-qershor 2023	30.06.2023	Viti	35	19	54
12	Debat i dytë i rregullt i kryetarit të komunës janar-dhjetor 2023	27.12.2023	Viti	38	34	72
13	Konsultim publik lidhur me propozim Planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2024	04.09.2023	Viti	4	3	7
				187	130	317
				Përqindja	59%	41%

Në këtë vit në takimet e ndryshme publike kanë marrë pjesë 317 qytetarë. Nga këto takime kanë marrë pjesë 130 femra e 187 meshkuj.

## Lektorit

Gjatë periudhës kohore janar - dhjetor 2023, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimin të detyrave të vendit të punës. Kam lektuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2023 kam lektuar këto dokumente:

- Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtorit komunale 2022; Informatë e Kryetarit për periudhën janar-qershor 2023; Kërkesë, memorandum (Zyra e Kryetarit), Debat publik (shkresa), Kërkesë, Vendim; Informatë për Kuvend, konkursi i bursave (Drejtoria për Arsim); Propozim vendim dhe shkresa e inspektorit (Drejtoria për Inspeksion); Vendimet përgjigje në ankesë (Drejtoria për Kulturë, komisioni); Vendime (3) për Shërbimet publike (tri shkresa), ankesë, autorizim, Marrëveshje (4) (Zyra Ligjore); Komiteti për Komunitete (procesverbali).
- Procesverbalet e Kuvendit Komunal (mbledhja e X e 2022 dhe I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X); procesverbal nga seancat e jashtzakonshme; Vendimet 26.01.2023, Vendimet 22.2.2023, Vendimet 27.03.2023, Vendimet 25.04.2023, Vendimet 25.05.2023, Vendimet 21.06.2023, Vendimet (24.07.2023), (20.09.2023), (23.10.2023), (13.12.2023).
- Procesverbalet e KPF-së ( mbledhja e X e 2022 dhe mbledhjet I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X).
- Procesverbalet e KKS-së (mbledhja e VI 2022 dhe mbledhja e I, II, III, IV, V, VI 2023).

- Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë (Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal).

## **Zyra për Integrim Evropiane**

Zyra Komonale për Integrim Evropiane, zyrtari për integrim evropiane gjatë periudhës Janar – dhjetor 2023, ka kryer këto aktivitete:

- Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integrim Evropiane 2023 dhe iu ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektivave që dalin nga Planin Kombëtar për Integrim Evropiane 2023;
- Kemi mbajtur takim njoftues me Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit;
- Kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiumit të ZKI-ve, me AKK dhe MAPL-në;
- Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së;
- Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës;
- Kemi marrë pjesë në komisionin për riintegrim, në bordin e drejtorve;
- Kemi raportu ne ministri për realizimin e obligimeve që dalin nga plani për integrim përcjell komunave.

## **Zyra për Projekte**

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e zyrës së projekteve gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2023 kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimin të tyre dhe mbikqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveq hartimit të projekteve të lartpërmendura kemi kryer edhe këto punë, si:

- Hartimin e detyrave projektuese;
- Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme;
- Pranime teknike të projekteve të përfunduara;
- Komisione të ndryshme për vlerësim;
- Menaxhimi i zbatimit të projekteve; dhe
- Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menagjmentit.

## KAPITULLI III

### Raportet e Drejtorive

#### Drejtoria për Administratë

Drejtoria për Administratë kryen shërbime të përgjithshme administrative për organet e administratës dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Vitisë. Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie përfshijnë: Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punën e Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit të Komunës dhe Këshillit të Drejtorëve; Përgatitja e akteve të cilat i nxjerr kryetari i Komunës, Këshilli i Drejtorëve; Harton propozim rregullore, propozim vendime në fushën e administratës; Kujdeset për përkthimin e materialeve të Kuvendit, trupave të kuvendi dhe Këshillit të Drejtorëve, duke respektuar gjuhët zyrtare.

Drejtoria për Administratë ka realizuar objektivat të cilat dalin nga Plani i Punës së Drejtorisë për Vitin 2023. Drejtoria për Administratë ka hartua planin e veprimit për muajt janar - dhjetor 2023 për arsye të kryerjes së shërbimeve administrative për bashkatdhetarët që vijë nga bota e jashtme për pushime verore.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie:

#### I. Sektori për Punë Administrative

Sektori për Punë Administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë. Ky sektorë ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 11 seanca të rregullta, të jashtëzakonshme 1, solemne 5, urgjente 0. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta. Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Kuvendi i Komunës ka miratuar 2 rregullore dhe 1 plotësim-ndryshim të rregullores, 85 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatit për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrim të Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative ditore, javore dhe mbledhje të rregullta, ku janë shqyrtuar materialet të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatit materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje. Për nevojat e kryetarit të Komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar dokumente të ndryshme, si: vendime, marrëveshje të ndryshme, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Dokumentet e hartuara janë të natyrave të ndryshme, si: propozim vendime për ndarjen së ndihmave financiare, vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve, etj.

Zyrtari për përkthim ka përkthyer në mënyrë simulante në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthyer edhe të gjitha materialet të cilat kanë dal nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKSB, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

## II. Sektori i gjendjes civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën janar - dhjetor 2023:

Nr	Përshkrimi i Lëndeve	totali
1	Ekstrakt nga regjistri qendrori gjendjes civile	17059
2	Certifikata Lindjes	10752
3	Certifikata e martesës	5179
4	Certifikata e Vdekjes	1817
5	Certifikata Vendbanimi	994
6	Deklaratë për bashkësinë familjare	5521
7	Certifikata e gjendjes martesore	1258
8	Certifikata e Shtetësisë	285
9	Vërtetim nga Arkivi	629
10	Vendimet	140
11	Aktvdekjet	208
12	Vërtetimi Mjeteve	51
13	Vizita	86
14	Regjistrimet në LAL të jashtme	213
15	Regjistrimet në LAL të brendshme	24
16	Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)	71
17	Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)	148
18	Regjistrimet në LAM të jashtme	93
19	Kurorëzime të reja	476
20	Shkurorëzime	58
21	Humbje Shtetësie	26
22	Fitim Shtetësie	23
23	Clajmrim i vendbanimit	9
	<b>Totali i dokumenteve të lëshuara</b>	<b>45120</b>

Numri i përgjithshëm i dokumenteve të lëshuara për periudhën janar - dhjetor 2023 është 45120 dokumente.

## III. Sektori i zyrës pritëse dhe arkivit

Zyra Pritëse në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese janar – dhjetor 2023 janë, si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtrësive, shërbimet postare për organet e administratës komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në Zyrën Pritëse është paraqit në formë tabelore:

. Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë	48
. Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë	92
. Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve -L.A.L nga jashtë	255
Kërkesa për regjistrim në LAV brenda vendit	118
Deklarata për vendqëndrim	0
Deklarata për trashëgimi	206
Deklarata për përkujdesje financiare	66

Deklaratë për regjistrimin të më vonshëm në LAL	5
Deklarata për regjistrim në LAV	52
Gjithsejtë:	842

### LËNDËT E ARKIVUARA

Drejtoritë	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	321
Drejtoria për Administratë	35528
Drejtoria për Arsim	1504
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	159
Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim	5825
Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport	295
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	227
Drejtoria e Inspeksionit	64
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	923
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	5888
Kuvendi i Komunës	13
Zyra e Kryetarit	767
Zyra për Komunitete	2
Totali	51516

#### IV. Sektori i administrimit

Ky sektor përfshin shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë: kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën janar - dhjetor 2023.

- Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë 35.872.00euro, si: Administrata 13.060.00€; Shëndetësia 13.271.00€; dhe Njësia e Zjarrfikësve 9.541,00€.
- Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, gjenerator, nxehje qendrore dhe autorizime për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 61698 lit.
- Shpenzimet për derivate të naftës për automjete për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 46210 litra, si: Administrata 17210 litra (Zyra e kryetarit, DKA dhe autorizimet); Shëndetësia 18619 litra; dhe Njësia e Zjarrfikësve 10381 litra.
- Shpenzimet për derivate të naftës për nxehje qendrore për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 12521 litra naftë, si: Administrata 10030 litra; Drejtoria e Kulturës 0 litra; Shëndetësia 2491 litra; Njësia e Zjarrfikësve 0 litra;
- Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësitë shpenzuese janë 2967 litra, si: Administrata 620 litra; Shëndetësia 1044 litra; Njësia e Zjarrfikësve 288 litra; DKA-ja (shkollat) 1015 litra.
- Shpenzimet e sigurimeve te automjeteve 8.983.0 euro.

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative, me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësor, në veçanti:

- Ka zbatua hardëare, Softuerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet;
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçje sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

#### **PËR PERIUDHËN janar-dhjetor 2023**

Nr.	Emërtimi	Nr.Intervenimeve	Vërejtje
1	Risetimi i passëord të Domenit	150	
2	Hapja e Userve të Domenit	45	
3	Hapja e Userave të Intranetit	13	
4	Intervenimet në Usera	100	
5	Intervenimet në rrjetin qeveritar	150	
6	Intervenimet në programe	150	
7	Konfigurimi i sëiqit	0	
8	Intervenimet në Gjendjen Civile	150	
9	Intervenimet në Tatimin Pronë	65	
10	Futja e kompjuterëve në Domen	90	
11	Instalimi i softëare	00	
12	Instalimi i computerhardëaredevices	00	
13	Rregullimi kablllove të internetit	70	
14	Intervenimet në E-mail	150	
15	Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komunal	35	
16	Intervenimet në Intranet	150	
17	Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës	0	
18	Drejtoria Arsimit	30	
19	Qendra për punë sociale	60	
20	Telefonave VOIP	35	
21	Asistimi ne rregullimin e fotoko.,printe etj	250	
22	Përkrahja ne takime virtuale	32	
	<b>Gj i t h s e j</b>	<b>1855</b>	

1. Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë
2. Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë
3. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë
4. Mirëmbajtja e-pasurisë çdo ditë
5. Sistemi për menaxhimin dhe arkivimin elektronik të dokumenteve çdo ditë
6. Menaxhimi i disa kontratave
7. Trajnime të ndryshme virtuale dhe fizike

Zyrtari për pranimin e mallit gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 ka punuar në harmoni me përshkrimin e vendit të punës, ku ka realizuar objektivat që parashihen me planin e punës gjatë kësaj periudhe.

Pranuesi i mallrave ka kryer këto detyra të punës: Pranimin dhe regjistrimin e mallrave në sistemin e menaxhimit të pasurive (E-Pasuria), ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet komunale, ku vlera e këtyre materialeve është 49104.95 € apo mbi 87 lëndë; Janë bërë mbi 120 kërkesa për furnizime me material



për zyre dhe inventar; Janë bërë furnizime me material shpenzues si dhe inventar për të gjithë njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë, duke përfshirë Zyrën e Kryetarit dhe të gjitha drejtoritë tjera dhe komunitetet; Kemi asistuar në disa paramasa për furnizim me material shpenzues si dhe ka kryer detyra tjera që ju janë besuar nga menagjmenti i Komunës.

## Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

Në kuadër të kësaj drejtorie janë zhvilluar këto aktivitete:

### I. Sektori i buxhetit dhe thesari

Nr.	Kategoritë ekonomike	2023
1	Paga e mëditje	<b>9,096,106.44</b>
2	Mallra e shërbime	<b>2,569,042.55</b>
3	Shpenzime komunale	<b>317,042.90</b>
4	Subven. e transfere	<b>769,961.58</b>
5	Shpenzime kapitale	<b>4,307,122.35</b>
	Totali	<b>17,059,275.82</b>

### II Sektori i Financave

Sektori i Financave gjatë periudhes janar – dhjetor 2023 ka kryer këto punë:

- Është bërë mbyllja e vitit buxhetor 2022;
- Është mbyllë libri i protokolit për vitin 2022 me numer rendor 2320;
- Janë regjistru obligimet e papaguara gjatë vitit 2022, të cilat janë bartur në vitin 2023;
- Janë regjistru 2618 kupona të shpenzimeve në vler prej 7.332.804.37€;
- Janë aprovu dhe çertifiku 2142 kupona të shpenzimeve në vlerë prej 73332804.37€;
- Janë evidentu 2618 pagesa të shpenzimeve përmes transferit në vlerë prej 7.332.804.37€ në analitik sipas kodeve ekonomike, programeve, perfituesve dhe dokumentacioni origjinal është arhivu;
- Janë bërë 2618 zotime me procedurë të prokurimit dhe aprovimit;
- Janë protokolu 2113 fatura, kontrata, vendime të vitit 2023 dhe janë dorëzu 2113 obligime për zotim me procedë të prokurimit dhe aprovimit;
- Ëhtë bërë regjistrimi në sistem i 168 furnitorve të ri në MFT;
- Janë terjekë 3 avanse për para të gatshme në vlerë prej 1.500.00€ dhe 9 avanse për udhëtime zyrtare jashtë vendit në vlerë prej 9.22.80€;
- Janë mbyll 12 avansa për udhëtime zyrtare jashtë vendi dhe avanse për para të gatshme;
- Janë bërë 538 raporte të pranimit në arkë dhe janë bërë 139 deponime në bankë në vlerë prej 90.280.00€;
- Është mbajtur evidencë analitike e pagave në vlerë prej 8.768.141.96€ për arsim, shëndetësi administrat komunale dhe këshilltarët komunal;
- Janë bërë 1579 ndryshime në regjistrin e pagave për 1165 të punsuar në administrat, arsim, shëndetësi dhe 27 këshilltaret komunal;
- Janë faturu 4325 fatura të inkasimit e të hyrave vetanake mbi 10.00€.
-

### III. Sektori i Tatimit në Pronë

- Ofrimi i shërbimit të qytetarëve për kryerjen e detyrimeve tatimore nga tatimi mbi prone;
- Ofrimi i shërbimit për pagesën e taksës komunale për automjete dhe mbajtja shënimeve tjera;
- Ofrimi i shërbimit për biznese dhe punë tjera sipas kërkesave të palëve;
- Dhënia e këshillimeve palëve për kushtet e pagimit të tatimit;
- Gjatë periudhës **janar - dhjetor 2024** janë shërbyer mbi **3415** qytetarë me vërtetime për shërbime të ZKK-së dhe nevoja personale, vërtetime sociale janë shërbyer **607** qytetarë, humbje të shtetësisë janë shërbyer **92** qytetarë me vërtetime, korrigjim te emrit dhe mbiemrit janë shërbyer **49** qytetarë me vërtetime;
- Janë inkasuar **766,363.55 €** nga tatimi në pronë dhe **116,452.00 €** nga taksa e automjeteve. Realizimi i planit vjetor për tatimin në pronë shprehur në përqindje është **117.86 %**, kurse tek taksa e automjeteve kemi realizuar planin për **137 %**;
- Këtë inkasim e kemi arritur me rastin e përpilimit të listës për të përmbauesi privat prej: **415** obliguesve mbi **300.00 €**, ku **98** prej këtyre tatimpaguesve kanë bërë marrëveshje për pagesën me këste ndërsa kanë kryer obligimet në tërësi **164** tatimpagues dhe janë dërguar **677** letërkujtesa dhe njoftime përfundimtare për obliguesit mbi **300 euro**;

Ne krahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar kemi **267,992.59 €** më shumë të inkasim nga tatimi në prone, kurse nga taksat për automjete janë inkasuar **17,262.00€** më shumë në periudhën e njejtë të vitit të kaluar.

**Rianketim dhe Anketim:** Janë rianketuar 2815 prona, janë regjistruar 607 objekte të reja dhe kemi bërë rishikimin e lëndëve dhe shënimeve për tatimpaguesit gjatë viteve të tjera dhe punë të tjera administrative, duke përmirësuar shumë gabime në evidencat e bëra nga vitet e kaluara, duke verifikuar gjendjen në teren dhe marrjen e fotove. Raportimi për të hyrat e realizuara nga tatimet dhe taksat në periudha të caktuara kohore javore, si dhe mbajtja e shënimeve dhe evidencave. Bashkangjitur kemi edhe raportin financiar të të hyrave janar – dhjetor 2024. Ky raport është bërë më 11.01.2024. Ne presim që të ketë ndryshime në inkasimin e tatimit në pronë deri në fund vit 2024.

### IV. Sektori për Ekonomi dhe Zhvillim

Gjatë kësaj periudhe kohore prej 01. 01. 2023 – 31. 12. 2023 në kuadër të Sektorit për Ekonomi dhe Zhvillim kemi kryer një sërë punimesh. Ndër to do t'i veqoja: Shqyrtuam një lëndë (kërkesa) të qytetarëve për shfrytëzim të pasurisë publike, mirëpo në bazë të Planit Zhvillimor Komunal 2010 - 2020, Komuna nuk ka planifikim afatshkurter për investim në këto parcela; Mbajtëm takim me zyrtarët komunal për hartimin e planit zhvillimor ekonomik local; Komuna e Vitisë me mbështetje nga MMPHI dhe në bashkëpunim me kompaninë konsulente UBT-në, është në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) si një dokument strategjik multisektorial që përcakton zhvillimin e Komunës për 8 vitet e ardhshme; Punuam në Strategjinë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Vitisë 2022 – 2026; Mbajtëm takimin me zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e UBT-së të cilët bënë prezentimin e profilit Planit Zhvillimor Komunal 2021 – 2029; Komuna e Vitisë me mbështetje nga MMPHI dhe në bashkëpunim me kompaninë konsulente UBT-në është në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) si një dokument strategjik multisektorial që përcakton zhvillimin e Komunës për 8 vitet e ardhshme.

### V. Zyra për regjistrimin e bizneseve

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2023 kemi: Të regjistruara biznese të reja 185; Ndryshime në biznes 106; janë shuar 42 biznese; Certifikata të...

## VI. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2023 të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë, buxheti i nivelit qendror dhe donacionet

<b>Emërtimi i projekteve</b>
Asfaltimi i rrugëve Viti, Beguncë, Lubishtë, Kabash, Buzovik, Drobesh, Ramnishtë, Smirë, Podgorc, Gërmovë
Asfaltimi i rrugëve rurale në Pozheran, Terpezë, Ballancë, Zhiti, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtëme, Trestenik
Asfaltimi i rrugëve rurale në Sodovinë të Jerlive, Sodovinë e Çerkezëve, Gjylekar, Budrikë, Radivojc
Ndërtimi i kanalizimeve në Viti, Kabash, Binçë, Gërmovë, Drobesh, Beguncë, Gjylekarë, Budrikë
Ndërtimi i kanalizimeve në Trestenik, Radivojc, Pozheran, Sllatinë e Poshtëme, Vërban
Ndërtimi i rrugëve me zhavor në Sodovinë e Jerlive, Sodovinë e çerkezëve, Vërban, Fshati i Ri, Goshicë, Stubëll e Epërme
Ndërtimi i rrugëve me zhavor në Beguncë, Lubishtë, Buzovik, Remnik, Pozheran, Radivojc, Smirë, Podgorc
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik në Pozheran, Fshati i Ri, Trestenik, Devajë, Ballancë, Ramjan, Ramnishtë, Sodovinë e Çerkezëve dhe Jerlive
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit public në Viti, Smirë, Kabash, Goshicë, Beguncë, Gërmovë, Lubishtë, Gjylekarë, Vërban
Ndërtimi i hapësirave gjelbruese publike në Viti, Smirë, Vërban, Gërmovë, Remnikë, Budrikë, Goshicë, Drobesh, Kabash
Ndërtimi i hapësirave gjelbruese publike në Pozheran, Sllatinë e Epërme, Sodovinë e Çerkezëv, Sodovinë e Jerlive, Radivojc
Ndërtimi i fushave sportive në Zhiti, Terpezë, Trestenik, Vërban, Smirë, Beguncë, Gërmovë, Gjylekarë, Ramnishtë
Ndërtimi i fushave sportive në Stubëll të Epërme, Budrikë, Sodovinë e Çerkezëve, Remnik, Radivojc, Goshicë, Debëlldeh
Ndërtimi i kanaleve dhe prockave në Viti, Pozheran, Kabash, Remnik, Vërban
Asfaltimi i rrugës Ballancë - Kravaricë
Asfaltimi i rrugëve Terpezë – Novosellë - Lagja "Alidema"
Asfaltimi i rrugës Goshicë - Sodovinë e Jerlive
Asfaltimi i rrugës Sllatinë e Epërme - Pozheran lagja "Korant"
Asfaltimi i rrugës lagja "Lulleci" - Ramjan lagja "Rexhepi"
Asfaltimi i rrugës Gjylekar-Toplant-Remnik
Asfaltimi i rrugës Kolishtë-Buzovik-Beguncë
Ndërtimi i rrugës me zhavor Ramjan - Sllakove
Ndërtimi i rrugës me zhavor Remniku i Ri (Pumpa) - Sod e Qerkezëve, Sllatinë e Poshtme
Rregullimi i rrethojave të shkollave "Bafti Haxhiu", "Halil Alidema", "Kuvendi i Lezhës"
Asfaltimi i rrugës Viti - Sllatinë e Ultë
Blerja e agregatave për shkollat "Kuvendi i Lezhës" dhe "Jonuz Zejnullahu" në Viti
Ndërtimi i parkut te Kroi i Shtuzhit - Stubëll
Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devajë, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiti, Goshicë, Vërban, Ramnishtë
Renovimi i ambulantës në Viti
Blerja e pajisjeve mjekësore rentgen i dhëmbëve, monitor dhe EKG për QKMF-në Viti

### Projekte e e nivelit qendror

Rregullimi i rrugës "Anton Qeta" – "Sejdiu" Stubëll e Epërme
Ndërtimi i shkolles fillore ne Pozheran në proces të realizimit
Projektet e realizuara me grantin e performances

## Drejtoria për Inspeksion

Në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së inspektimeve dhe shërbimeve me ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të drejtorisë.

### Inspektorët e tregut

- Procesverbale në aspektin e zbatimit të Ligjit për Nr:03/L-186, Ligjit 04/L005 dhe Ligjit 06/L-034, kryesisht detyrim i legalizimit të veprimtarisë, ndërrimet e lokaleve si dhe pajisjet me aktvendim të pranimeve teknike.....77;
- Inspektime në zbatim të masave - matje të peshës, sasinë e produkteve në furrat e bukës, ku kryesisht janë verifikuar sasi të dhe është kërkuar që ti shpallin deklaracionet mbi peshën, çmimet dhe përmbajtjen e produkteve.....15;
- Kontrole mbi etiketen, deklaracionin dhe flamurin e origjinës së produkteve .....35;
- Kontrollime mbi shpalljen e njoftimit dhe ndalim shitjen e duhanit dhe alkoholit për moshat nën 18 vite.22;
- Inspektime në fushën e kontrollit, identifikimit të rritjes së çmimeve të artikujve bazik, siç janë vaji dhe produktet tjera bazike dhe në bashkërendim me institucionet e inspektoratit të tregut në kuadër të MTI-së dhe udhëzimeve të pranuar .....5;
- Inspektime mbi çmimet dhe sasinë e dhe llojin e furnizimit të plehut artificial në barnatoret bujësore, ku janë evidentuar furnizuesit e shitësve me pakicë, çmimet, llojet dhe sasia në dispozicion për fermeret..12;
- Kontrole për ndalim të artikujve - lodra për fëmijë, imitim i rrezikshëm i produkteve ushqimore, kryesisht inspektimet, janë fokusuar në veprimtaritë gjithëçka 1 €, por edhe në supermarketet që posedojnë artikuj të tillë.....5;
- Kërkesa për pranime teknike të lokaleve.....64;
- Kërkesë mbi pranimin teknik të lokalit në shumë prej .....3689.00 Euro;
- Aktvendime për pranime teknike të lokaleve .....61;
- Proqesverbale të komisionit për pranim teknik.....64;
- Kërkesat nuk janë realizuar për shkakun se bizneset nuk kanë përmbush kriteret me dokumentacion. Njëri ka bërë mbylljen e biznesit pas ushtrimit të kërkesës, e tjetri ka paguar kërkesë, por nuk ka dërguar kërkesen për arkivim.....3;
- Kërkesa për punë shtesë nga kryeinspektorja e Inspektoratit të Tregut dhe Departamenti i Mbrojtjes nga Konsumatorët dhe zgjidhje e ketyre kërkesave.....7;
- Gjatë kësaj periudhe si bizneset që kanë startuar kryesisht veprimtaritë, si: butike, kafiteritë apo restorantet, ndërsa trendi i kërkesave ka qenë kryesisht nga lëmia e pompave të derivateve të naftës dhe produkteve të saj;
- Vizita tjera në biznese në aspektin e zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr:03/L-186 dhe dispozitave tjera mbi peshën dhe njesitë matëse, çmimet e artikujve, shpallja e emërimit të biznesit, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë e sidomos pajisje me pranim teknik të lokalit..... 125.

## **Inspektori i komunikacionit**

Kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarë të ndryshëm si dhe subjekte, si: operatorët e transportit. Po njashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjithë përfaqësuesit e auto shkolave dhe subjektet tjera që ishin të lidhur apo të interesuar për gjendjen në komunikacion, si shoqëri civile, media etj; Është bërë rregullimi i gjashtë pjerrinave në qytetin e Vitisë, për kalim sa me të lirë të personave me aftësi të veçanta; Kemi hartuar 14 procesverbale sipas detyrës zyrtare; Kemi lëshuar dy pelqime për kyqjen në rrugë; Kemi hartuar 48 procesverbale mbi shikimin e automjetit për transport publik –taxi; Kemi bërë 48 fletëpagesa për taksa komunale dhe atë mbi shikimin e automjetit 48 x 10 € = 480.00 Euro; Kemi bërë 2 fletëpagesa per kyqje në rrugë nga 20 euro, gjithsejt 40 euro; Kemi bërë pranimin teknik të lokaleve afariste së bashku me inspektorin e tregut.

## **Udhëheqësi i sektorit për inspektime dhe uzurpime**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë kryer punët dhe detyrat nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon: Mbështetja dhe këshilla sipas kërkesës për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe drejtorinë e institucionit për fushën e përgjegjësisë së sektorit që udhëheqë; Mbikëqyrja e të gjitha aktiviteteve të sektorit dhe ndihma profesionale për drejtorinë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave; Lirim të pronës publike dhe lirim të hapësirave publike me qëllim të relizimeve të investimeve në infrastrukturë publike nga ana e institucioneve kumunale; Inspektimet e punimeve dhe pajisjes me leje përkatëse nga Ministria dhe sipas kërkesave për raste konkrete, si dhe ndalimi i punimeve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme; Inspektimi së bashku me inspektorin e ambientit (në mungesë të inspektorit të shërbimeve publike) rreth ndotësve të ambientit, inspektimi i tregjeve, rrugëve, trotuareve, lumenjëve, prrockave e sidomos inspektimi si rezultat e hedhjes së mbeturinave dhe parandalimin e dukurive negative te cilat bien në kompetencë të sektorit e sidomos të inspektorit të shërbimeve publike; Inspektimi së bashku me inspektorin e ambientit sa i përket shfrytëzimit të hapësirës publike nga lokalet në Viti dhe Pozharan, dhe obligimi i tyre për tu pajisur me leje përkatëse nga Drejtoria e Shërbimeve Publike; Inspektimi së bashku me inspektorin e ambientit dhe inspektorin e komunikacionit sa i përket mbikqyrjen inspektuese të rendit të udhtimit të operatorëve ekonomik, kushtet e transportit të udhëtarëve, evitimi i rreziqeve në rrugë, transportit të mallrave, kontrolli i transportit të mallrave të rrezikshme dhe autotaksive etj.

Mbete sfidë për këtë periudhë për sektorin mungesa e stafit dhe përkrahja në ekzekutimin e inspektimeve apo angazhimi i kompanisë përkatëse në lirimin e hapësirave publike dhe pronës komunale, të cilat shfrytëzohen pa bazë ligjore. Gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2023 në kuadër të Sektorit për Inspektime janë realizuar këto punë, aktivitete, objektiva apo propozime të ndryshme në aspektin ligjor nga udhëheqësi i sektorit e të cilat janë të veçanta nga inspektimet e përbashkëta e të cilat janë realizuar si pjesë e komisionve të ndryshme mbrenda institucionit siç është Komuna e Vitisë.

Të dhënat në mënyrës statistikore: Inspektime në teren (32); Procesverbale (14); Vendime për lirim të pronës publike (01); Kërkesa për lirim të hapsirës publike (Kioskat) (03); Kërkesa dhe përgjegje të ndryshme (17).

## **Inspektori i mbrojtjes së mjedisit**

Proqesverbale të shkruara në teren (47); Shpërndarje të njoftimeve për mbrojtjen e mjedisit (3); Inspektime në teren në gjithë territorin e Komunes të Vitisë (345); Trajtimi i qeneve endacak me kastrim, vaksinim dhe hospitalizim (113); Trajtim me eutazi (27); Dalje në teren lidhur me mbeturinat në hapsira publike (124); Dalje në teren pas perfundimit të orarit të punës (4); Gjoha mandatare të shqiptuara sipas rregullores komunale për gjoha dhe ngarkesa (7); Konsultime me palë në zyrë lidhur me kërkesat e tyre (223); Kryerja e inspektimeve të përbashkëta me inspektorin e pronës, shërbimeve publike dhe inspektorin e ndërtimit (10); Me shkresën e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës kemi bërë inspektimin e (7) monumenteve të mbrojtura të natyres në Komunën e Vitisë.

## Inspektori i ndërtimit

Mbikqyrje Inspektuese në fazat e ndërtimit, ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti (10); Vizita në teren (162); Procesverbale (91); Vendime për ndërprejen e punës (20); Kllzime penale (16); Vendim për rrënimin (16); Shqiptimi i gjobave manadatore (5); Kemi asistuar inspektorët e tjerë në aktivitetet e tyre (10).

## Zyrtar për rrjet dhe matje, gjeometër në Drejtorinë për Inspektion

Nxjerrja e dokumentave në Drejtorinë e Kadastrit dhe Informimi i Inspektorëve për paluajtshmëritë e ndryshme (65); Matje dhe Evidentime në teren (15); Kopje planit (22); Asistime gjatë inspektimeve me inspektorin e ndërtimitarisë (10); Asistime gjatë inspektimeve me udhëheqësin e inspektimeve dhe inspektorin e ambientit (19).

## Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2023, në këtë drejtori ka pasur shumë angazhim për kryerjen e detyrave, obligimeve dhe përgjegjësi të tjera sipas planit të punës, të cilat janë kryer me sukses. DSHPE-ja ka punuar me kapacitete të plota në ofrimin e shërbimeve komunale për qytetarët për ambient më të pastërt, infrastrukturë më funksionale dhe ndërhyrje sa më efikase në paraqitjen e emergjencave. DSHPE-ja në bazë të organogramit është e përbërë nga dy sektorë. Sektori i Shërbimeve Publike dhe Sektori i Emergjencës. Sektori i Shërbimeve Publike ka katër zyrtarë, ndërsa Sektori i Emergjencës tre zyrtarë. Në kuadër të drejtorisë është edhe shërbimi i Njësitit të Zjarrfikësve, që ka 25 punëtorë profesional si dhe inspektorin e preventives ndaj zjarrit.

### Sektori i shërbimeve publike

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 ky sektor ka pranuar gjithsejtë 315 kërkesa të protokoluara të natyrave të ndryshme, 264 kërkesa të miratuara, 41 kërkesa të refuzuara, 9 kërkesa janë proces dhe 1 kërkesë të ceduar, të cilat janë kryer në afatin ligjor. Kemi lëshuar vendime të ndryshme, leje për parkim, shfrytëzimin e hapësirave publike, dëftesa për pagesa për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave, vazhdimi i lejeve për auto-taxi rreth 55, etj. Gjatë kësaj periudhe kemi përcjellur punët e operatorëve të kontraktuar nga Komuna, të cilët kanë kryer shërbime për Komunën.

DSHPE-ja për vitin 2023 ka pasur buxhetin e aprovuar dhe atë në shumë prej 1.267.987.59, ndërsa është shpenzuar 1.259.562.35. € në përqindje 99.34%.

Për shpenzime komunale kemi të aprovuara 182.000.00 Euro. Shuma e përgjithshme e shpenzuar për komunal është 177.694.00 Euro, shpenzimi për komunal në përqindje është 97.63 %, duke mos i përfshirë obligimet e muajit dhjetor të vitit 2023 për PTK, ECO-Higjiena, Hidromorava, KES/CO, të cilat barten për vitin 2024.

Për mallëra dhe shërbime kemi pasur buxhet të aprovuar prej 796.107.75 Eurove, të alokuara 796.107.75€, të shpenzuara 791.988.45 €, duke mos përfshirë edhe obligimet për muajin dhjetor të vitit 2023. Pra, drejtoria gjithsej për mallra dhe shërbime nga mjetet e alokuara ka shpenzuar 99.42% për vitin 2023, duke mos i përfshirë edhe disa fatura të vitit 2023 të cilat barten në vitin 2024.

### Të hyrat vetanake

Tabela e të hyrave vetanake të planifikuara dhe të realizuara 2023

Nr	Përshkrimi i të hyrave	Realizimi vjetor për 2023	
1	Qiraja	13210.40 Euro	
2	Shfrytëzim të hapësirës publike	12609.90Euro	
3	Reklammat	1923.00 Euro	

4	Taksa për licenca tjera për afarizëm. (leje per autotaksi) dhe shërbime të tjera profesionale.	20.00 Euro	
5	Parkimi publik	1275.00 Euro	
	Gjithsej	29038.30€	

Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2023 kanë qenë gjithsej 34410.00 Euro, janë të realizuar 29038.30 Euro, në përqindje janë realizuar 84.39 % të të hyrave vetanake.

Gjat periudhës janar-dhjetor janë përcjellur punët e kompanisë për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve si: Pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, mbushja e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, pastrimi i bankinave të rrugëve lokale nga barnishtat dhe shkurret, vendosjen e mbrojtëseve në disa ura etj.

Organizimi i transportit publik në Komunën e Vitisë është i rregulluar sipas rregullores për organizimin e transportit brenda territorit të Komunës, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë me dt. 27.05.2014 dhe Ligjin për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179. Transporti publik i udhëtarëve në Komunën e Vitisë është i organizuar në transport urban dhe urban periferik, i cili realizohet përmes kompanive private të transportit, pasi që komuna nuk ka kompani publike të transportit të udhëtarëve. Transporti urban është i organizuar me autotaksi brenda qytetit, pasi që transport urban nuk kemi. Transporti publik për periudhën janar-dhjetor 2023 është bërë organizimi i rrethit të operatorëve për transportit publik urban dhe Urban – periferik, njëherit është përcjellur mbikqyrja e transportit publik. Në Komunën e Vitisë Transporti publik ka këto vendbanime: Pozharan, Sllatinë e Poshtme, Sllatinë e Epërme, Tresenik, Sodovinë e Qerkezve, Sodovinë e Jerlive, Drobesh, Smirë, Verban, Gushicë, Gërmovë, Gjylekarë, Terpezë, Lubishtë, Ramnishtë, Remink, Radivojc, Letnicë Stubëll, Budrikë.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, hapësirave gjelbëruese, trotuarëve, mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parkut të qytetit të Vitisë. Gjatë periudhës janar-dhjetor janë mirëmbajtur gjithsej 11,0496.00 m<sup>2</sup> hapësira publike. Lloji i hapësirave publike: sheshe janë 172,68.00 m<sup>2</sup>; parqe janë 44,952.00 m<sup>2</sup>; HHP pranë lapidarëve janë 7,764.00m<sup>2</sup>; varrezat e dëshmorëve në Viti; varrezat e martirëve në Skifteraj 10,941.00 m<sup>2</sup>; varrezat e qytetit 18,553.00 m<sup>2</sup>; shëtitoret Viti-Binçë 3.521.00 m<sup>2</sup>; shtrati i lumit "Morava" nga stacioni i autobusit janë 7,437 m<sup>2</sup>; 20 hapësira publike janë me ndriçim public; rrugë dhe trotuar janë 122,934 m<sup>2</sup>; dhe vetem trotuar janë 68,200 m<sup>2</sup>.

Me hapësira të hapura publike (HHP) të përfshira në këtë projekt nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rendësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytet të Komunës e Vitisë siç janë: parqet, sheshet, shëtitoret Viti-Binçë, shtrati i lumit "Morava", sipërfaqe gjelbëruese, hapësirat për parkim automjetesh, rrugët në qytet, trotuarët në qytet dhe lokalitetet e komunës, tregjet, lapidarë, pllakat përkujtimore, varrezat e dëshmorëve dhe varrezat e qytetit të Vitisë. Është bërë edhe krasitja e drunjëve dekorativ në qytet, mbjellja e drunjëve dekorativ, mbjellja e luleve në qytet etj.

Gjatë kësaj periudhe janar-dhjetor janë mirëmbajtur dhe pastruar objektet e administratës komunale, shëndetësore dhe arsimore. Në këtë projekt janë paraparë hapësira të brendshme dhe të jashtme të mirembahen si dhe pastrohen. Janë mirëmbajtur gjithsej 71489 m<sup>2</sup>, ku hapësira të brendshme janë 15873 m<sup>2</sup> dhe hapësira të jashtme (oborret e objekteve) janë 55616 m<sup>2</sup>. Në këtë projekt janë të punësuar 30 punëtorë nga Komuna e Vitisë.

Në Komunën tonë kemi gjithsej 10.882 copë llampa elektrike, të cilat janë të vendosura në shtylla elektrike druri, betoni dhe shtylla metalike të zinguar. Kemi tre llojë të llampave elektrike: llampa me natrium-(zhivë)-100 copë, poça ekonomik 65W- 4233 copë dhe të llojit LED 100W, 50V, 11Ë, 16W, gjithsej 6549 copë. Në këtë

raport nuk janë përfshirë dhe llogaritur trupat ndriqes që Komuna këtë vit i ka bërë në ndriçimin publik, që do të thotë se kemi diku mbi 11.000 trupa ndriqes në territorin e Komunës sonë të cilët mirëmbahen. Gjatë këtij viti janë ndërru 3344 poqa elektrik në qytetin e Vitisë dhe në vendbanimet e Komunsë së Vitisë, ndërsa për ndriçimin dekorativ të qytetit për fundëvit janë shpenzuar 18,700.00 euro.

Në Komunën e Vitisë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përgjegjëse është kompania regjionale “Hidromorava”, njësi në Viti. Komuna dhe kompania “Hidromorava” kanë një bashkëpunim të ndërsjell. Kompania në fjalë bënë edhe furnizimin me ujë të pijshëm dhe mirëmbanë kanalizimin në qytetin e Vitisë, fshatërave Drobesh, Ramnishtë, Pozharan, Qifllak dhe Letnicë, ndërsa në lokalitetet tjera rrjetet e ujësjellësve dhe kanalizimeve mirëmbahen nga operatori ekonomik, i cili është kontraktuar nga Komuna e Vitisë. Gjatë periudhës janar-dhjetor janë percjellur punët e kompanisë për mirëmbajtjen e ujësjellësve dhe kanalizimeve nga ana e drejtorisë dhe gjatë kësaj periudhe raportuese janë bërë 106 intervenime në rregullime të kanalizimit dhe ujësjellësit, zhbllkime të kanalizimit, ndërrim të gypave, vendosje të pusëve, vendosje të kapakëve nga betoni, vendosja e kapakëve nga metali etj.

“Ekohigjiena” si kompani publiko-private njësi në Viti bënë mbledhjen, transportimin e mbeturinave në deponinë regjionale në Velekincë të Gjilanit dhe atë nga këto vendbanime të Komunës: Qyteti i Vitisë, Drobesh, Smirë, Terpezë, Pozheran, Sllatinë e Eperme, Slatine e Ulët, Radivojc, Fshati i Ri, Budrikë, Remnik, Ramjan, Beguncë, Kabash, Germovë, Sodovinë e Jerlive, Sadovinë e Qerkezeve, Verban, Ramnishtë, Goshicë, Skifteraj, Terstenik, Podgorc, Stubëll e Epërme, Lubishtë, Binqë, Devajë dhe Qifllak.

**Fushëveprimi:** Të gjitha pikat në Komunën e Vitisë janë identifikuar sipas raportit të vitit 2023 dhe janë shfrytëzuar si të dhëna përfundimtare për identifikimin e deponive aktuale.

**Përkufizime:** “Deponi ilegale” - përkufizohet çdo pikë jashtë deponive të përcaktuara në nenin 33 të Ligjit Nr. 04/60 për Mbeturina. Deri më tani, termi “deponi ilegale” nuk është dalluar ligjërisht nga “hedhja e mbeturinave pa vend”. Për qëllime të krijimit të një standardi të njëjtë të qasjes gjatë implementimit të metodologjisë, deponia do të përkufizohet si çdo sasi e mbeturinave që e tejkalon vëllimin prej 200 litrave l (d.m.th. e krahasueshme me një karrocë standarde), e cila do të gjendet në një vend të pacaktuar.

**Koordinatat gjeografike:** Secila deponi e evidentuar është përcaktuar sipas koordinatave gjeografike përkatëse, duke e treguar gjerësinë dhe gjatësinë.

Tabelat e kordinatave gjeografike të seciles depoli aktuale, janë pastruar deponit ilegale te evidentuara sipas pikave te kordinatave gjeografike.

Nr	Madhësia	Vendi ku ndodhet	Gjerësinë	Gjatësi	Komuna	LLoji	Vërejtje
1.	E madhe	Pozheran	42.352099	219132	Viti	A.N	E kryer
2.	E mesme	Devajë	42.393815	21.395977	Viti	N	E kryer
3.	E mesme	Beguncë	42.35619	21.354725	Viti në hartë	N	E kryer
4.	E mesme	Sllatinë e Ulët	42.297151	21.390048	Viti	A	E kryer

## Sektori i emergjencave

Punët që janë kryer në Sektorin e Emergjencave i gjeni si në vazhdim:

- Azhurnimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike (kapacitetet ixhinjerike) për mbështetje në fushën e menaxhimit, në rast fatkeqësish;
- Punët e përditshme administrative;
- Koordinimi rreth zjarreve malore me NJPZSH dhe Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari;



- Implementimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës në Komisione Komunale, (raportimi për performancë dhe komisione tjera komunale);
- Dalja në vlerësimin e rrezeqeve për 2 raste (dorëzimi i kërkesave për eliminimin e rrezikut);
- Angazhimi në mbarëvajtjen e “Zojës së Madhe” në Letnicë, gusht 2023;
- Dy ushtrime në fushën e kërkim-shpëtimit dhe evakuimit në shkollat e mesme në Viti, me datë 06.10.2023 në shkollën e mesme teknike “Jonuz Zejnullahu”, dhe me datë 21.12.2023 në shkollën e mesme “Kongresi i Manastirit” në Pozheran. Të përfshirë gjithë reaguesit institucional (policia, shëndetësia, NJPZSH, Kryqi i Kuq).
- Koordinimi gjatë intervenimeve me NJPZSH, Kompanitë Publike dhe drejtoritë komunale gjatë intervenimeve në vërshime dhe situata tjera emergjente dhe gjatë ushtrimeve;
- Puna në dokumentin e vlerësimit të rrezikut për Komunën e Vitisë;
- Puna në Planin e Reagimit Emergjent Komunal;
- Daljet e NJPZSH, gjithsej: 720 (zjarre 612, teknike 23, shërbime 51, aksidente rrugore 12 (me fatalitet 1 vajzë në Gërmovë), vërshime 17, të rrejshme 5).

## 2.1 Njësia Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim (NJPZSH) - VITI

NJPZSH ne Viti gjatë kësaj periudhe raportuese i ka kryer me përgjegjësi profesionale të gjitha punët dhe detyrat të cilat me ligje është e obliguar t'i kryej. Gjatë kësaj periudhe njësiti ka punuar me kapacitete te plota dhe me personel shtesë të kontraktuar me kontratë mbi vepër (7).

Dalje të përgjithshme në intervenime 720

- Zjarre: 612
- Intervenime teknike: 23
- Shërbime: 51
- Aksidente rrugore: 12
- Dalje në vërshime: 17
- Lajmërim i rrejshëm: 5

Prej tyre janë:

- Zjarre në Objekte ndërtimore 23,
- Zjarre në objekte ekonomike 2,
- Zjarre në pajisje elektrike 7

Zjarre në sipërfaqe të hapura:

- Zjarre në male 36,
- Zjarre në bari i thatë 495,
- Zjarre në automjete 9,
- Të tjera 30,
- Të lënduar 17 qytetarë,
- Me fatalitet në aksidente rrugore 1 qytetar.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera ne vitin 2023 për NJPZSH ne Komunen e Vitisë

Realizimi i numrit te përgjithshëm te daljeve, struktura e zjarreve dhe int. tjera ne periudhen Janar-Dhjetor-2023														
2023	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Te rejsb	Të lënduar			Të vdekur			Githsej
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	14	9	0	4	0	1	0	0	0	0	0	0	0	14
Shkurt	29	25	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	29
Mars	17	14	2	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	17
Prill	8	3	2	1	1	0	1	0	3	3	0	0	0	8
Maj	15	7	0	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	15
Qershor	21	6	1	6	0	8	0	0	0	0	0	0	0	21
Korrik	89	63	4	16	3	1	2	0	6	6	0	0	0	89
Gusht	124	114	5	4	1	0	0	0	0	0	0	0	0	124
Shtator	168	163	2	2	0	0	1	0	0	0	0	0	0	168
Tetor	192	186	0	5	1	0	0	0	0	0	0	0	0	192
Nëntor	14	8	2	1	2	1	0	0	3	3	0	0	0	14
Dhjetor	29	14	5	0	4	5	1	0	5	5	0	0	0	29
Gjithsejtë	720	612	23	51	12	17	5	0	17	17	0	0	0	720

**Pasqyra e numrit të përgjithshëm vetëm i zjarreve për periudhën janar -dhjetor-2023**

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera.													
Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr.i In.Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rrej.	Të lënduar			Të vdekur			Githsejt
							zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	Tot	
720	612	23	51	12	17	5	0	17	17	0	0	0	720

**PASQYRA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZJARREVE**

Zjarrë në Objekte ndërtimore						Zjarrë në Objekte ekonomike				Zjarrë në Pajisje elektrike				Zjarrë në Sipërfaqe të hapura				Zjarr. Auto.	Gjit
Banesa / shiëpi	Objekte ndimise	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjera	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike	Pajisjet shpërndarse	Gjeneratora	Të tjera	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqesore	Të tjera	Automjete motorrike	
10	1	3	0	7	2	0	2	0	0	7	10	0	0	36	495	0	30	9	6

2.2 Donacione në Vitin 2023, kemi marrë nga KFOR-i Amerikan, si:

- 20 palë çizme të gjata në rast vërshimesh;
- Përmes grantit të performancës nga GIZ-i gjerman dhe MAPL-ja kemi përfituar autofshesë, ku vlera e saj arrin mbi 73.516.30 euro.

- 50 fidane të drunjëve janë dhuruar nga Finca -Institucioni mikro-financiar të cilat janë mbjellur përgjatë rrugës Viti-Drobesh.
- **Furnizim me uniforma nga AME-ja**, verore dhe dimërore për 27 zjarrfikës, që janë pranuar përmes të cilët i kemi furnizuar me uniforma nga AME-ja (Agjencioni i Menaxhimit të Emergjencave-Prishtinë).
- Aparatë të frymëmarrjes “Drager” 4 copë, të kompletuara me bombola të oksigjenit, maska dhe korniza.
- Bashkëpunimi me Policinë, Shëndetësinë, Kryqin e Kuq, dhe NJPZSH-të e tjera të Gjilanit, Ferizajit, Kamenicës dhe Kaçanikut ka qenë shumë i mire, poashtu kemi pasur edhe takime.

### 2.3. Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjenca ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe ka kontratën për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit dhe furnizim me aparate të reja për nevojat e NJPZSH-së si dhe Administratës Komunale me numër VI657-21-029-236, dhe janë servisuar të gjithë aparatet. Servisimi i tyre bëhet çdo 6 muaj. Atesti i Aparateve për fikjen e zjarreve: Objektet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Zjarrfikësve dhe Shtëpisë së Kulturës dhe objekteve tjera komunale.

### 2.4 Inspektori i preventivës ndaj zjarrit kryen

• Inspektive të përgjithshme (të rregullta dhe verifikuse).....	57
• Inspektive në sektorin privat.....	53
• Inspektive në sektorin shoqrorë.....	4
• Nr.Vërejtjeve .....	156
• Nr.Propozim të masave.....	156
• Shiqime në vendngjarje të zjarreve.....	22
• Raporte zjarri për njësitin hetues në polici (prokurori).....	10
• Kërkesa nga palët.....	6
• Vërtetime zjarri për palët e dëmtuara.....	6

### 2.5 Investime Kapitale

Duke patur parasysh projektin e nisur prej Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili nuk kishte përfunduar në vitin paraprak, Komuna mori iniciativë dhe bëri marrëveshje me AME-në për bashkëfinancim në mënyrë që të përfundoj ky projekt. Komuna është në pjesëmarrje me 51%, përderisa AME-ja me 49 %. Objekti është në përfundim e sipër dhe mbetet vetëm pranimi teknik i tij, në mënyrë që Njësitit i Zjarrfikësve të zhvendoset në objektin e ri në fillim të vitit 2024.

### 2.6 Sfidat e paraqitura

- Ndër sfidat më të mëdha ka qenë numri i vogël i zjarrfikësve dhe mosha e tyre e shtyer;
- Mungesa e automjeteve përkatëse dhe ato ekzistuese janë në gjendje jo të mire.

## Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

### Ofrimi i shërbimeve shëndetësore

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas këtyre kategorive mjekësore:

1. Shërbimet primare:
  - a. Mjekësia familjare,
  - b. Emergjenca,

- c. Stomatologjia,
- d. Imunizimi dhe vaksinimi,
- e. Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik),
- d. Barnatorja.

## 2. Shërbimet specialistike

- a. Pediatria,
- b. Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (internisti),
- c. Gjinekologjia.

- Në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24 orë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, radiologjike dhe laboratorike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës;
- Qendra e urgjencës primare punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës, ndërsa mjekësia familjare punon në orarin 08.00 - 15.00 çdo ditë të javës.

## Gjatë vitit 2023 në QKMF janë ofruar 505560 shërbime shëndetësore

### Mjekësia Familjare

- Ka ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë dhe të një numër të konsiderueshëm të Komunës së Kllokotit, të të gjitha moshave pa dallim. Gjatë vitit 2023 janë ofruar **31944** vizita mjekësore;
- Gjithashtu është kryer kontrolla sistematike e nxënësve të klaseve të I, V dhe të IX të të gjitha shkollave të Komunës së Vitisë. Jane kontrolluar 1418 nxënës, ku janë vlerësuar 29 parametra shëndetësore dhe 13 parametra të shëndetit oral.

### Shërbimi i urgjencës primare

- Shërbimi i Urgjencës ofron shërbime shëndetësore **24 orë** ditë gjatë tërë javës;
- Në shërbimin e urgjencës kryhen të gjitha shërbimet e ndihmës së parë, kontrolla mjekësore, këshilla, vizita në teren gjatë traumave dhe aksidenteve të ndryshme, kirurgji e vogël, ndërrim kateteri, lidhje dhe pastrim i plagëve, ordinimi dhe trajtimi me terapi parenterale, oksigjenoterapia etj;
- Në këtë shërbim janë të organizuara edhe kujdestaritë gjatë natës, vikendeve dhe festave në bazë të orarit të planifikuar më parë;
- Autoambulancat janë monitoruar në vazhdimësi nga ekipet kujdestare dhe vozitësit në drejtim të funksionimit sa më të rregullt të saj. Në dispozicion kemi 6 autoambulanca në funksionalitet të plotë;
- Gjatë vitit 2023 janë ofruar **66898** vizita mjekësore në shërbimin e urgjencës, ndërsa në tërësi janë ofruar **144806** shërbime.

### Stomatologjia

Shërbimi i stomatologjisë ka ofruar shërbime stomatologjike në orarin 8:00-15:00. Këto shërbime ofrohen në QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran. Gjatë kësaj periudhe kemi shtuar resurset humane si dhe kemi furnizuar shërbimin e stomatologjisë me Rëntgen digjital.

#### *Shërbimet të cilat ofrohen janë:*

- Preventivë,
- Shërim i dhëmbit,
- Drenim,
- Incizion i dhëmbit të infektuar,
- Mbushje e dhëmbit,
- Shërbimet e pedodoncise,

- Pastrim te gëreve në dhëmbë,
- Nxjerrje e dhembit etj.

Gjatë këtij viti janë ofruar **5162** shërbime stomatologjike.

#### Shërbimi i Vaksinimit

- Shërbimi i vaksinimit në mënyrë te vazhdueshme ka punuar në ngritjen e cilësisë profesionale të stafit shëndetësor. Po ashtu edhe në edukimin e qytetarëve në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e promovimit dhe parandalimit të sëmundshmërisë së fëmijeve dhe rëndësinë e vaksinimit në fëmijeri;
- Ka bërë planin vjetor dhe ka realizuar planin në perpikmeri në vaksinimin e fëmijeve parashkollordhe shkollor në tërë teritorin e Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kllokotit;
- Është bërë vaksinimi i popullatës me vaksinën e gripit sezonal, ku janë vaksinuar 2005 qytetarë;
- Gjatë tërë vitit janë planifikuar të vaksinohen **2556** fëmijë, ndërsa janë vaksinuar 2466 dhe shkalla e vaksinimit per femijë në këtë vit është në përqindje 96.4 %, kurse me vaksinën anticovid janë vaksinuar 12 qytetarë;
- Gjithsej në shërbimin e vaksinimit janë ofruar **15062** shërbime;
- Në këtë periudhë kemi përfituar një veturë nga Ministria e Shëndetësisë, ku përpos shërbimeve për vizita për nëna dhe fëmijë do të shërbej për shërbimin e vaksinimit.

#### Laboratori dhe shërbimi radiologjik

- Shërbimi i laboratorit ofron shërbime në orarin 8:00 - 15:00. Këto shërbime ofrohen në QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran. QMF ne Pozheran është furnizuar me aparat biokimik dhe hematologjik;
- Është bërë furnizimi me material të nevojshëm për funksionimin normal të laboratorit;
- Janë ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë pacientët të cilët kanë kërkuar shërbime laboratorike në institucionin tone;
- Gjatë vitit 2023 janë ofruar **195930 shërbime laboratorike**;
- Janë bërë 256 teste rapide në këtë periudhë;
- Rentgeni punon ne orarin e rregullt 8:00-13:00;
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë **1042** incizime radiologjike. Prej muajit tetor, shërbimi i rëntgenit është në renovim.

#### Barnatorja

- Është bërë planifikimi me kohë për furnizim me barna dhe material hargjues për vitin 2023;
- Janë kryer në mënyrë të rregullt porositë mujore për furnizim me barna dhe material hargjues nga Ministria e Shëndetësisë, kryesisht përmes sistemit SMFK;
- Është bërë distribuimi i barnave dhe materialit hargjues në QKMF dhe QMF-Pozheran si dhe te gjitha QMF-të dhe AMF-të;
- Është bërë furnizimi i pacientëve me barna esenciale dhe insulin;
- Furnizimi me barna përmes listes esenciale ka qenë në përqindje 23.18%, ndersa me material hargjues 57.56%;
- Për faktin që furnizimi ka qenë jo i kënaqshëm nga MSH-ja përmes listës esenciale. Jemi obliguar të blejmë terapi dhe material shpenzues përmes kodit, Shërbime dhe mallra.
- Gjatë kësaj periudhe kemi blerë me mjete vetanake, përmes kontratës me operatorin ekonomik në kuadër të shërbimeve dhe mallrave terapi dhe material hargjues në raste specifike në vlerë prej **56229.50** euro.

## 2. Shërbimet specialiste

### Pediatria

Shërbimi i pediatrikë ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00 çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore. Gjatë këtij viti janë ofruar **3811** vizita mjekësore dhe **486** këshilla mjekësore. Në total janë ofruar 4386 shërbime pediatrike.

### Mjekësia interne

Shërbimi i mjekësisë interne ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore kryesisht për të sëmurët kronik. Sëmundjet më të shpeshta kronike të evidentuara në shërbimin e mjekësisë interne janë sëmundjet kardiovaskulare, reumatologjike dhe të diabetit. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar **805** vizita mjekësore, si dhe janë realizuar **512** EKG. Në total janë ofruar 1317 shërbime. Gjithashtu, shërbimi i internës është furnizuar me një aparaturë të re të EKG-së.

### Gjinekologjia

Shërbimi i gjinekologjisë ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore për gratë shtatzëna. Gjatë këtij viti janë ofruar **2519** vizita mjekësore dhe **2090** ultrazë, **533** kontrolla gjinekologjike dhe **682** këshilla. Në teresi janë ofruar **4249** shërbime shëndetësore në gjinekologji. Gjithashtu, në këtë shërbim funksionojnë edhe dy programe të reja nga muaji mars, "Klasat për nëna" ku gjatë kësaj periudhe janë ofruar 406 shërbime dhe "Kujdesi në 1000 ditët e para" ka përfunduar grupin e parë me 4 cikle të vizitave.

### Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë

Kujdesi për nëna dhe fëmijë ka vazhduar me vizita në shtëpi, ku gjatë kësaj periudhe janë kryer **1601** vizita. Përpos këshillave mjekësore, në raste të veçanta përmes donatoreve familjet janë ndihmuar edhe me pako ushqimore dhe higjienike. Përpos infermiereve për vizita shtëpiake, kemi angazhuar edhe logopede dhe psikologe për të ofruar ndihmë për fëmijët që kemi hasur në probleme në të folur gjatë këtyre vizitave dhe probleme tjera eventuale. Gjatë këtij viti janë trajtuar 5 fëmijë. Në këtë periudhë kemi përfituar një veturë nga UNICEF dhe një veturë nga Ministria e Shëndetësisë, ku përpos shërbimeve për vizita për nëna dhe fëmijë do të shërbej për shërbimin e vaksinimit.

### Sistemi Informativ Shëndetësor

Janë raportuar me kohë të gjitha raportet në të gjitha institucionet përgjegjëse si IRSHP - Gjilan, IKPSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Është përcjellur gjendja e sëmundshmërisë përmes formularëve të caktuar dhe është raportuar me kohë në institucionet përgjegjëse.

# Tabela e raportit të SISH për periudhën Janar – Dhjetor 2023

GENERA KRYESORE E MARRËDHEJË FAMILJARE "NDE TUNDË" SH.P

Statistikë Mjekësive Janar - Dhjetor 2023

Janar-Dhjetor 2023  
GENERA KRYESORE E MARRËDHEJË FAMILJARE "NDE TUNDË" SH.P  
RAPORTI MËDHEJËT MIJTOR

JANAR - DHJETOR 2023

Raportet	VITET	Viteja shprehëse	Viteja Covid	Therapie	Infektive	Transfuzione	Tumorë dhe	Lëvizje	Infektive	Avullshë	SH	SH-Admisione	Mirësimi i Tërës	Treatment Covid	Udhëzime	Kontraste gjinekologjike	Shërbime të tjera	Mjekësive	Programe	V. Përg			
Emergjencë	6694	2986	47184	23482	2614		2071				1505								12	15434	51477		
Mjekësia Familjare 1	15979		5001				2493													12	15434	14301	
Mjekësia Familjare 2	7816						1279														12	15434	8222
Mjekësia Familjare 3	8143						1279														12	15434	8222
Stomatologji	4303						1279														12	15434	6626
Shë	1843																				12	15434	6626
Tendimet Covid																					12	15434	6626
Covid 19																					12	15434	6626
Shërbime të infuzionit																					12	15434	6626
Labordi	19439						2870														12	15434	6626
Pediatri	3811																				12	15434	6626
Infektive	804						80	24													12	15434	6626
Ekipa e shërbimeve të kujdesit																					12	15434	6626
Ekipa e shërbimeve të kujdesit																					12	15434	6626
Ekipa e shërbimeve të kujdesit																					12	15434	6626
Material	2918	1342																			12	15434	6626
Vizita për nënshkrimin dhe shërbime																					12	15434	6626
Shërbime të kujdesit	4471	1881																			12	15434	6626
Vizitat për COVID																					12	15434	6626
Infektive të QKMF Viti	12																				12	15434	6626
Lidhje																					12	15434	6626
TOTALI	127437	6662	22	64232	27470	10853	29	3043	207	1188	2071	124741	883	298	2060	533	22	837	41987	122734			
NUMRI I VISITAVE NE AMBULANCAT E QENORIS KRYESORE TE MARRËDHEJË FAMILJARE																							
Amb. Shërbime	47																						
Amb. Shërbime	27																						
Amb. Shërbime	148																						
QKMF Peshkopi Covid																							
QKMF Peshkopi	45726																						
Laboratori Peshkopi	3293																						
Stomatologjia Peshkopi	743																						
Amb. Shërbime	564																						
Amb. Shërbime	198																						
Amb. Shërbime	80																						
Amb. Shërbime	2																						
Amb. Shërbime	12																						
Amb. Shërbime	899																						
Amb. Shërbime	148																						
TOTALI	50903	298	21	17323	10288	4780	29	3043	207	1188	2071	124741	883	298	2060	533	22	837	41987	122734			
DIFERENCIALE																							
QKMF Viti	181340	6979	43	81356	37355	15833	29	8283	552	2822	2269	176950	883	298	2060	533	22	837	41987	122734			

## Kujdesi paliativ

Shërbimi i kujdesit paliativ ka kryer me profesionalizëm shërbimet shëndetësore ndaj pacientëve me sëmundje kronike dhe atyre të pa lëvizshëm, jo vetëm në Komunën e Vitisë, por edhe në Komunën e Kllokotit. Në QKMF Viti funksionojnë dy ekiye në teren në orarin 8:00-15:00, ndërsa prej orës 15:00 vizitat në teren i kryen shërbimi i urgjencës. Gjithashtu është edhe mjeku në permanentë, i cili aktivizohet në punë varësisht nga rastet ditore, kur ka nevojë për shërbim të mjekut. Gjatë vitit 2023 janë ofruar 12427 shërbime shtëpiake, kurse vetëm shërbimi i urgjencës ka ofruar 2066 vizita në teren.

## Situata me Covid19 në Komunën e Vitisë

QKMF në Viti në vazhdimësi ka qenë e fokusuar në menaxhimin e situatës me COVID19. Ka ndarë hapësirën për trajtimin e pacientëve me COVID dhe autoambulancën, e cila ka shërbyer për transportin e pacientëve me COVID19.

Në tabelë mund të shohim numrin e personave të prekur nga Covid-19 që nga 13.03.2020- 29.12.2023.

Rastet e testuara për COVID-19 në Komunën e Vitisë prej 13.03.2020	
Komuna e Vitisë	Nr.
Testime në Komunën e Vitisë	19820
Raste Pozitive	5017
Raste negative	14803

Raste pozitive vetëm gjatë periudhes Janar-qershor 2023	32
Të vdekur	106

### Cilësia e shërbimeve shëndetësore:

- Janë mbajtur takime të rregullta të Këshillit Drejtues të QKMF-së në Viti;
- Është bërë me kohë plani i punës;
- Janë mbajtur takime me përgjegjësit e njësive, në mënyrë të evitimit të parregullsive dhe avancimit të shërbimeve sa më cilësore;
- Janë diskutuar në takime të rregullta planet, kërkesat dhe sfidat e çdo shërbimi;
- Jane mbajtur takime edhe sipas kërkesave të stafit.

### Shërbimi i administratës

Buxheti i Shëndetësisë përbëhet nga granti specifik i shëndetësisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të hyrat vetanake. Për vitin 2023 ky buxhet ndahet si vijon:

- Paga dhe Meditje, 1.130.277,64,
- Mallra dhe shërbime, 576.165,81,
- Shpenzimet Komunali, 45.000,00,
- Shpenzimet kapitale, 110.260,55.

**Totali: 1.861.704,00**

Shërbimi i administratës ka funksionuar me kapacitet të plotë, ku gjatë viti 2023 janë kryer këto punë:

- Kemi bërë shkresë zyrës së Prokurimit për shpalljen e tenderëve të ndryshme dhe kemi përgaditur të gjitha paramasat dhe parallogarit për shpalljen e tenderëve;
- Kemi bërë pagesen e kujdestarive për 11 muaj muaj të vitit 2023;
- Ka vazhduar participimi i pagesave në të gjitha repartet e QKMF-së, ku në këtë vit deri me date 27.12.2023 janë inkasuar (grumbulluar) 73020.06€ për shërbimet e kryera;
- Kemi dhënë informacione të shumta për insitucioni të ndryshme.

### Edukimi i vazhdueshëm profesional

Ka vazhduar edukimi i vazhdueshëm profesional nga ana e mjekëve dhe infermierëve sipas planifikimit të temave profesionale që janë dërguar më parë për akreditim në Odën e Mjekëve dhe Infermierëve (OMK dhe OIK).

- Nga mjekët janë mbajtur 12 ligjërata;
- Nga Infermierët janë mbajtur 12 ligjërata;
- Janë mbajtur trajnime për urgjencat shëndetësore me ekipen e paramedikëve me KFOR-in, 2 trajnime me nga 25 pjesmarrës;
- Janë mbajtur trajnime për shëndetin reproduktiv në bashkëpunim me MSH dhe UNFPA, 3 trajnime;
- Janë mbajtur trajnime për Komunikimin Interpersonal në bashkëpunim me MSh, Unicef dhe Amc, 75 punetore të trajnuar;
- Trajnime për EKG në bashkëpunim me Asociacionin e Mjekëve Familjare 9 grupe;
- Trajnime për EKG me KFOR, 50 të trajnuar;
- Trajnime për vaksinimin, 3 grupe;
- Trajnime për vaksinat e reja, 8 grupe;
- Trajnime për Burnout Syndromen, 80 punëtorë të trajnuar;



- Trajnimi për dhunën në familje, MSH, UNFPA < AMC, 9 punëtorë të trajnuar;
- Trajnimi për raportimin e sëmundjeve kronike (masovike) jongjitëse, 13 punëtorë të trajnuar;
- Trajnimi për vizita shtëpiake, 7 punëtorë të trajnuar;
- Trajnimi për klasat për nëna dhe kujdesi në grup, 8 punëtorë të trajnuara.

Promovimi dhe edukimi shëndetësor gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë realizuar këto aktivitete:

- Më 20 Mars QKMF -Viti ka shënuar Ditën Botërore të Shëndetit Oral;
- Më 24 Mars është shënuar Dita Botërore e Tuberkulozit;
- Më 7 Prill, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti ka shënuar Ditën Botërore të Shëndetit- Me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit, sot në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Viti, në koordinim me institucionet komunale dhe në bashkëpunim me Gjimnazin "Kuvendi i Lezhës"- Viti është shënuar Ditën Botërore të Shëndetësisë. Fillimisht në kuadër të kësaj dite Dr. Dhurata Halabaku, specialiste e mjekësisë familjare, ka mbajtur një ligjëratë me stafin shëndetësorë me temë "Mbipesha dhe Obeziteti, shkaktarë e sëmundjeve kronike". Pastaj, nxënësit e gjimnazit së bashku me profesorët, kryetarin e komunës dhe drejtoreshat kanë vizituar të gjitha shërbimet në QKMF, duke filluar nga urgjenca, ku Dr. Vjollca Kadolli-Halili, ka folur para nxënësve për shërbimet që ofron ky institucion shëndetësor. Ndërsa, Dr. Gentianë Ferati, ka mbajtur një ligjëratë para nxënësve për kujdesin ndaj shëndetit;
- Me 27 prill është shënuar Java e Imunizimit në Viti-Gjatë aktivitetit të programit të ZHVP, në javën e imunizimit është mbajtur një aktivitet në QKMF-Viti, ku është ligjëruar tema: "Aplikimi i vaksinave dhe kujdesi për zinxhirin e flohtë"-Ligjëruese inf.Feime Qerimi, përgjegjëse e shërbimit të vaksinimit në QKMF-Viti;
- Më 11 Maj Shënohet Dita Ndërkombëtare e Infermierit në Viti-Organizuar nga kolegji "Universum" në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Viti, është shënuar Dita Ndërkombëtare e Infermierit. Me këtë rast ata kanë theksuar edhe rëndësinë e punës profesionale të infermierëve, duke ju uruar atyre edhe këtë ditë. Në kuadër të kësaj dite në qendër të qytetit, infermierët e QKMF-së dhe studentët e këtij kolegji janë duke bërë matjen e tensionit, sheqerit në gjak, si dhe nivelit të saturimit, për qytetarët të cilët kanë shprehur interesim që të jenë pjesë e këtij aktiviteti;
- Me 17 maj është shënuar Dita Botërore e Hipertensionit-Organizuar nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Viti (QKMF), në bashkëpunim me Institutin Regjional të Shëndetit Publik nga Gjilani, sot në qytetin e Vitisë, është duke u shënuar Dita Botërore e Hipertensionit. Me këtë rast në qendër të qytetit u bë matja e tensionit për kalimtarët e rastit si dhe janë shpërndarë fletushka me këshilla për parandalimin e hipertensionit;
- Me 24 Maj është shënuar Java e ndërgjegjësimit për Shëndetin Mendor-Nën organizimin e DSHMS-së në Viti, në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit të Shëndetit Mendor, është mbajtur ligjeratë me temën "Ndërgjegjësimi për Shëndetin Mendor", me stafin shëndetësorë të QKMF- së në Viti. Tema është ligjëruar nga infermiere Mimoza Zejnullahu, e cila njëherit është edhe psikologe;
- Me 31.Maj është shënuar Dita Botërore kundër Duhanit-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti (QKMF) në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, ka shënuar sot Ditën Botërore kundër Duhanit me disa aktivitete. Dr. Gentianë Ferati, nga QKMF në koordinim me menaxhmentin e shkollës fillore "Bafti Haxhiu" në Viti, ka mbajtur ligjëratën kundër duhanit me nxënësit e klasave të IX-ta. Pastaj, në qendër të qytetit punëtorët shëndetësorë kanë shpërndarë broshura për qytetarët e rastit dhe janë dhënë këshilla kundër pirjes së duhanit;
- Me 08 qershor është shënuar Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut me moton "Çdo dhurues gjaku është një HERO". Me moton "ÇDO DHURUES GJAKU ËSHTË NJË HERO", sot në sheshin e qytetit në Viti është

organizuar dhurimi vullnetar i gjakut nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Viti në kordinim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë. Gjatë këtij aktiviteti ka pasur një numër të konsiderueshëm të qytetarëve për dhurim të gjakut, por gjak dhuruan 21 qytetarë ( pasiqë disa për shkak të problemeve të ndryshme shëndetësore, nuk patën mundësi të dhurojnë);

- Me 28.07.2023 nga PRAK mbahet trajnimi për stafin shëndetësor “Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve në vendin e punës”;
- Me datë 29.09.2023 shënohet Dita Botërore e Zembrës;
- Prej 02-06.10.2023 është shënuar “Java e Gjithënjohjes”;
- Me 11.10.2023 shënohet Dita Ndërkombëtare e Shëndetit Mendor;
- Me 27.10.2023 mbahet Marshi sensibilizues kundër kancerit të gjirit, në kuadër të muajit Rozë, ku gjatë këtij muaji janë mbajtur 8 ligjërata me gratë, 22 gra kanë bërë ultrazërin falas si dhe mbi 100 gra kanë bërë mamografinë falas;
- Me 27.10.2023 është shënuar Dita Botërore kundër Kancerit të Gjirit me një ligjëratë nga dr. Arben Bislimi-onkolog QKUK- Prishtinë;
- Shënohet me 01.12.2023 shënohet Dita Botërore kundër HIV/ AIDS;
- Me 4.12.2023 mbahet trajnimi për stafin shëndetësor nga KFOR në Bonstill;
- Janë mbajtur trajnime për stafin nga KFOR-i, MSH, IKSHP dhe aktivitete tjera;
- Është lidhur memorandum bashkëpunimi në mes të Komunës së Vitisë dhe AMC (aksioni për nëna dhe fëmijë” për fillimin e dy programeve të reja në QKMF-Viti: “Klasat për Nëna “ dhe “Kujdesi në grup në 1000 Ditët e Para”;
- Është hapur këshillimorja “Klasat për Nëna”;
- Është hapur këshillimorja “Kujdesi në grup në 1000 Ditët e Para”;
- Përcjellja e aktiviteteve sportive në nivel komunal.

### **Investimet komunale**

- Renovimi në QKMF- Viti;
- Suvatimi dhe ngjyrosja e QMF-Pozheran;
- Blerja e aparaturave për laboratorin në QMF Pozheran, aparat biokimik dhe hematologjik;
- Blerja e rentgenit të dhëmbëve, EKG dhe monitor për shërbimin e urgjencës;
- Inventarizimi i AMF në Gushicë;
- Renovimi komplet i shërbimit të radiologjisë (në përfundim);
- Vendosija e rrethojës në QMF Pozheran;
- Rregullimi i oborrit mbrapa QKMF-së në Viti;
- Riparimi i nxemjeve dhe sistemit të rrymës në QKMF-Viti;
- Rregullimi i garazhës në QMF- Pozheran; dhe
- Blerja e inventarit të ri në të gjitha njësitë ku ka pasë nevojë.

### **Donacionet**


- QKMF në Viti furnizohet me 40 libra nga AQH, 20 copa “ Kujdesi ndaj pacientëve të moshuar “ dhe 20 copa “Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve në KPSH”;
- Donacion nga MSH në kordinim me Unicefin dhe AMC ku QKMF-Viti përfiton 1 Laptop dhe 17 tablet në kuadër të programit të Vizitave në shtëpi për Nëna dhe fëmijë nga 0-3 vjet;
- Përurohet Ambulanta e Mjekësisë familjare në fshatin Gushicë , donacion nga Kuçajt Society for Relief;
- Donacion nga UNICEF - Veturë Shkoda për vizita në shtëpi për Nëna dhe Fëmijë nga 0-3 vjet;

- Fillimi i punëve për ndërtimin e ashensorit në QKMF –Viti;
- Fillimi i punëve për ndërtimin e ashensorit në QKMF –Viti;
- Me 01.08.2023 donacion nga shoqata “ Jetimat e Ballkanit” karroca invalide dhe shëtitore per pacientet me aftësi të kufizuara ;
- Me 14.08.2023 QKMF ne Viti fiton donacion nga AQH- aparature laboratorike, 2 çanta mjekësore per sherbimin e urgjencës me pajisje;
- Me 6.11.2023 QKMF ka përfituar 4 telefon mobil nga KFOR për shërbime të ndryshme në QKMF si urgjencë, vaksinim dhe vizita shtëpiake;
- Me 8.11.2023 QKMF fiton donacion nga Ministria e Shëndetësisë një kombi për vizita ne teren dhe vaksinim;
- Me 11.12.2023 QKMF përfiton donacion nga mergimtari Daniel Dema 34 shtreter.

### Krahasimi janar - dhjetor 2022 dhe janar – dhjetor 2023

Shërbimet	janar – dhjetor 2022	janar – dhjetor 2023
Urgjenca	61410	66898
Mjekësia Familjare	42659	31944
Vizita Shtëpiake nga sherbimi i urgjencës	1309	2006
Stomatologjia	2819	4305
Pediatra	3814	3811
Shërbimi internistik	795	805
Gjinekologjia	1814	2519
Vaksinimi I femijeve	3803	4471
Vaksinimi anticovid	4999	12
Laboratori	122874	195930
Radiologjia	1093	1042
Shërbime të kujdesit paliativ dhe kronik ne teren	2638	3012
Vizit për nëna dhe fëmijë në shtëpi	1268	1601
Vizitat sistematike në shkollat e Komunës e Vitisë, për klasat e I, V dhe IX-ta	1317	1418
Vizita ne QMF Pozheran dhe AMF tjera	45677 - Pozheran 3308-Amf tjera	45726-Pozheran 8177- Amf tjera
Participimi I pergjithshem	60051.3	73020.06

<b>Buxheti</b>	<b>1.851.347,36</b>	<b>1.861.704,00</b>
<b>Totali i vizitave</b>	<b>172126</b>	<b>181340</b>
<b>Totali I ofrimit te sherbimeve nga QKMF per qytetaret e Komnes se Vitise</b>	<b>484219</b>	<b>505560</b>



**Figure 1. Krahasimi i sherbimeve Janar -Dhjetor 2022 dhe Janar – Dhjetor 2023**

Në QPS-Viti gjatë këtij viti, nga 01. 01.2023. deri 31.12.2023 punët kanë rrjedhë në përputhshmëri me planifikimin dhe masat e ndërmarra. Janë përmbushur të gjitha detyrat shtesë në ofrimin të shërbimeve për kategoritë e rezikuara, që përfshihen në domenin e punës sociale, siç janë shpërndarja e pakove ushqimore dhuruar nga organizatat humanitare. Numri i punëtorëve të angazhuar në QPS gjatë kësaj kohe është duke llogaritur edhe drejtorin janë 10 punëtorët e angazhuar – 1 punëtorë me kontrat i ka skanduar afati kontrates. Për momentin janë të angazhuar gjithësej dymbdhjetë, 10 punëtorë aktiv, drejtori QPS-së, katër, 3 punëtorë të shërbimit, social dhe një – 1 Udhëheqs i Shërbimit, tre 3 punëtorë të Shërbimit të Asistencës dhe një – 1 udhëheqsi i shërbimit, një - 1 punëtor i administrates dhe financare.

## **SHËRBIMI SOCIAL**

<i>Kategorit e sherbimeve simbas rasteve</i>	<i>Raste te reja</i>	<i>Perseri tesa</i>	<i>Te bartura nga vitet tjera</i>	<i>Gjithë sejt</i>	<i>Vendosja ne institucione - Vrejtje</i>
Raporte te qregulluara bashkshortore-Besim i femijve	4	0	4	8	
Te mitur ne konflikt me Ligjin	61	0	27	88	
Dhuna ne familje	55	0	22	77	
Vendosje në strehimore-Dhunë në Familje	7	0	0	7	
Te mitur me sjellje asociate	13	0	7	20	
Fëmijët e keqtrajtuar fizikisht	1	0	3	4	
Kujdestari e femijeve	2	0	28	30	
Fëmijët ne strehim.familjar tek të afermit	1	0	1	1	
Fëmijë pa përkujesje prindrore	0	0	1	1	
Besim i femijëve	6	0	1	7	
Fëmijët e vendosur ne famil.strehues	0	0	0	0	
Adoptimi i femijeve	2	0	4	6	
Kujdestari e Veqant	1	0	4	5	
Kontaktimet prind-fëmij	7	0	18	25	
Keqtrajtimet-ngacmimet sex.te femijëve	2	0	3	5	
Te moshuar pa perkujdesje familjare	0	0	2	2	
Fëmijët me nevoja te veqanta	18	0	46	64	
Te rritur me nevoja te veqanta	0	0	4	4	
Ftesa gjyqesore per te mitur	43	0	43	43	
Ftesa gjyqesore per territur	28	0	28	28	
Lypes te rruges	0	0	0	0	
Masat e shqiptuara per te mitur;M.SH.P	0	0	0	3	
M.O.K	0	0	0	0	
Qortim	0	0	0	0	
Burg	0	0	0	0	
Vertetime per nenshtetësi	42	0	0	42	
Vertetime të zotsis së veprimit - për armë	274	0	0	274	
Vërtetime të zotësis së veprimit - për punë	68			68	

Fëmijët në punë të rënda	0	0	0	0
Ankesa koms.mj.shk.II	0	0	0	0
Fëmijet e vendosur ne institucionet mbrojtese	0	0	1	1
Persona te vendosur në institucione mbrotjse- Shtime	0	0	2	2
Persona te vendosur në institucione mbrotjse-shtepi e komuniteteve	0	0	2	2
Vendosje në shtepin e Pleqve-Pr	0	0	3	3
Regjistr.i mevonshem i fëmijve	0	0	0	0
Perdorues te narkotikeve	1	0	0	1
Martesa e parakoheshme	0	0	0	0
Urdher mbrojtje per viktimat e dhunes ne familje	8	0	0	0
Sherim i detyrushem psikiaktrik	1	0	0	1
Kërcnim	0	0	0	0
Ngacmim	2	0	1	3
Trafikim	0	0	0	0
Dhunim	1	0	0	1
Femijët e braktisur të posalindur	0	0	0	0
Raste tjera në nevojë për sherbime	23	0	12	35
Aktvendime të kujdestaris	0	0	0	0
Aktvendime	40	0	0	40
Aktgjykime	7	0	0	7
Njoftime për DPSF	30	0	0	30
Kërkes QPS	28	0	0	28
Njoftim ose raport per Policien	42	0	0	42
Njoftim-raport për Prokurorin	22	0	0	22
Njftimper QPS tjera	13	0	0	13
Caktim i Kustestaris	4	0	0	4
Referime nga gjykat	10	0	0	10
Referime nga Prokuroria	30	0	0	30
Njoftime –raport për Gjykat	70	0	0	70
Njoftime nga QPS tjera	3	0	0	3
Njoftime nga Spitali i gjinkologjis	0	0	0	0
Kerkes zyres se gjendjes civile	1	0	0	1
Dhenje Pelqimi	2	0	0	2

Gjithësejt raste të trajtura dhe shërbimet e ofruara	973	+	267	1240	

### SHËRBIMI ASISTENCËS

*Pasqyra e pagesave nga shërbimi i asistencës gjatë këti nëntmuajori*

Nr.	Muaji	Numri familjeve anëtar	-	Pagesa mujore
1.	Janar	390	1677	51.070.00 €
2.	Shkurt	384	1656	49.620.00 €
3.	Mars	375	16291	48.480.00 €
4.	Prill	390	1677	51.070.00 €
5.	Maj	340	1493	45.030.00 €
6.	Qershor	337	1455	44.240.00 €
7.	Korrik	327	1419	42.200.00 €
8.	Gusht	323	1383	41.210.00 €
9.	Shtator	324	1379	42.470.00 €
10.	Tetor	322	1377	41.090.00 €
11.	Nëntor	315	1350	40.220.00 €
12.	Dhjetor	313	1343	40.190.00 €
Gjithësejt	12 muaj	437 mesatarja		536.89.00 € në total

### *Gjitha rastet e shqyrtuara për Asistencë Sociale*

Rastet e shqyrtuara	Gjithësejt	Aprov	Refuzuara
Aplikim për herën e parë	17	14	3
Riaplikim	525	424	101
Gjithësejt	542	438	104

### *Lëndët e shqyrtuar nga komisioni mjekësor*

Të shqyrtuar	Të aprovuara	Të refuzuara – në shqyrtim
291	250	41
		00

### *Lëndët e shqyrtuara simbas ankesës*

Te trajtura	Aprovuara	Refuzuara	Gjithësejt
Të trajtuaraë	1	17	18

### *Kërkesa për suvencione nga DPSF-DSAS*

<i>Gjithësejt</i>	<i>Të aprovuara</i>	<i>Të refuzuara</i>
2	0	2

### *Vërtetime të lëshuar brenda vitit*

<i>Me pagesë</i>	<i>Papagesë</i>	<i>Gjithësejt</i>
		210

### *Të atakuar nga ATK 16 familje*

#### *Vertetima për student*

<i>Gjithësejt</i>	6
-------------------	---

#### *Propozim pelqimi për autorizim për tërheqjen e mjeteve*

<i>Gjithësejt</i>	2
-------------------	---

## **Drejtoria për Arsim**

Zhvillimi i procesit mësimor në Komunën e Vitisë zhvillohet që nga çerdhet, parashkollorët, mësimi i ulët i mesëm dhe ai i lartë mesëm si dhe ai i mesëm profesional. Fillimi i procesit mësimor për gjysmëvjetorin e dytë në vitin shkollor 2022/2023, sipas vendimit të MASHT-it nr.01/B-2592 të datës 04.10.2022, ka filluar me datë 06.02.2023. Mësimi është zhvilluar sipas planifikimeve të mësimdhënësve të bazuar në kalendarin e MASHT-it si dhe sipas planit dinamik të DKA-së.

- Takime me kolegjin e drejtorëve të shkollave për planifikimin, zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë gjysmëvjetorit të dytë;
- Raportimet dhe takimet e rregullta me drejtorët e shkollave dhe DKA-në;
- Mbajtja e takimeve të kolegjit të drejtorëve komunal me MASHTI-in;
- Raportimet e rregullta ndërmjet DKA-së e MASHT-it dhe inspektoratit arsimor;
- Takime me OJQ të ndryshme për donacione në shkolla.

## **Zhvillimi i procesit edukativo-arsimor**

- Viti shkollor 2022/23 ka përfunduar në të gjitha shkollat me data të parapara nga kalendarin i rivlerësuar i MASHT-it, sipas Vendimit Nr.01B/2592, me 04.10.2022 për ndryshimin e kalendarit të vitit shkollor 2022/23 në arsimin parauniversitar;
- Klasët parafillorë, I-VIII përfunduan mësimin me 30.06.2023;
  - Klasa (1-5), 2737 nxënës përfunduan vitin shkollorë me notë mesatare 4.33;
  - Klasa (6-9), 2267 nxënës përfunduan vitin shkollor me notë mesatare 3.63;
- Klasët IX-X dhe XI përfunduan mësimin me 27.06.2023;
- Klasa (10-12), 1382 nxënës përfunduan vitin shkollor me notë mesatare 3.2;
- Klasa e XII përfunduan më 05.06.2023;
- Në vitin shkollor 2022/23 janë mbajtur garat e diturisë, kulturës dhe sportive;




- Garat e diturisë janë mbajtur në nivel shkolle, janë mbajtur në të gjitha shkollat fillore (1-5);
- Garat e diturisë, arti figurativ me pikturë si dhe garat me Ese, niveli 6-9 janë mbajtur. përveç garat në shkollë janë mbajtur edhe komunalet, ndërsa garat sportive janë mbajtur edhe në nivel regional, ku shkollat e Vitisë kanë zënë vende të mira;
- DKA-ja për të gjitha shkollat fituese të garave është perkujdesur për shpërblime të nxënësve dhe mësimitdhënësve në ditën e mësuesit, me 7 mars;
- Këtë vit kemi pasur edhe një garë dhe ekspozitë në lëndën e Artit Figurativ me Pikturë e organizuar nga MASHT-i për nderë të Pavarësisë së Kosovës bashkë me shtetin e Shqipërisë, ku edhe Komuna jonë ka marrë pjesë;
- Janë organizuar aktivitete të ndryshme në shkolla, trajnime për mësimitdhënës, ligjerata nga psikologët në shkolla për çdo datë me rëndësi;
- Trajnimi i mësimitdhënësve, pilot projekt nga Bashkimi Evropian KOSED dhe MASHT-i është mbajtur në dy shkolla të Komunës së Vitisë, SHFMU "Skender Emërllahu" në Ramjan dhe SHFMU "Dëshmorët e Pesë Prillit" në Smirë, ku është vlerësuar si trajnim i suksesshëm;
- Ligjerata për data të caktuara të temave me rëndësi janë mbajtur në të gjitha shkollat ku janë të mbuluara me psikolog;
- Në bashkëpunim me MASHT-in janë organizuar me nxënës aktivitet "Drejt Malit", ku kanë marrë pjesë 26 nxënës të SHFMU "Dëshmorët e Vitisë" në Viti, janë edukuar për skijim, aktiviteti për siguri me klasët e XI, ku kanë marrë pjesë rreth 80 nxënës të SHML Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës" në Viti si dhe "Kongresi i Manastirit" në Pozharan;
- Janë mbajtur disa teste të jashtme e ndërkombtare këtë vit: testi TIMSS me klasën e katërt, ku të përzgjedhura kanë qenë SHFMU "Halil Alidema" - Pozharan, "Njazi Rexhepi" - Sllatinë, "Ndre Mjeda" - Kabash dhe "Skender Emërllahu" – Ramjan;
- Testi ICLS me klasën e tetë, ku të përzgjedhura kanë qenë SHFMU "Bafti Haxhiu" - Viti dhe "Njazi Rexhepi" - Sllatinë.

Testi maturës është mbajtur në dy afate, qershor dhe gusht 2023, ku 447 maturant ju nënshtruan testit të maturës. Nga këta 282 kaluan testin ose 63.09%, si dhe 130 dështuan në test apo 36.91% (shif grafikoni e më poshtëm).

Testi maturës është mbajtur në dy afate, qershor dhe gusht 2023, ku 447 maturant iu nënshtruan testit të maturës. Nga këta 282 kaluan testin ose 63.09%, si dhe 130 dështuan ne test apo 36.91% (shif grafikoni e më poshtëm).

#### GJITHSEJ MATURANT-AFATI I QERSHORIT DHE GUSHTIT /2023

NR	PJESMARRËS	KANË KALUAR	KANË DËSHTUAR
1	447	282	165
	Shprehur në %	63.09%	36.91%



- Testi i Arritshmërisë këtë vit është mbajtur më 4 korrik pjesa e parë dhe me 11 korrik pjesa e dytë, këtij testi iu nënshtruan 595 nxënës të klasëve të nënta, rezultatet e këtij testi u publikuan me 17 korrik.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT-VITI

Totali i suksesit në Testin arritshmërisë për klasën e IX / të , në nivelshkolle -komune, 2022-2023

Emri / Adresa (Viti)	Niveli / shkollor	Përfitimet Shkollore -Komune																				Totali									
		Gjuhë shqipe		Gj. Anglisht		Histori		Gjeografi		Matematikë		Informatikë		Fizikë		Kimi		Bilogji		Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar										
		Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar	Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar	Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar	Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar	Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar	Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar	Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar	Pjesë e kaluar	Pjesë e dështuar														
"Nisim Pajtim"	26	900	624	60.673	420	276	66.19	730	505	72.1	700	401	57.29	900	642	69.51	420	336	80.48	470	290	62.00	440	320	72.7	470	371	77.9	5600	372	67.4
"Alban Shtet"	26	1015	650	64.31	430	330	72.56	720	520	72.2	720	344	47.80	1010	510	50.74	430	280	65.07	460	310	67.26	464	310	67.26	460	300	79.1	9800	3614	63.2
"Kosovë Jeta"	26	1010	717	71.64	430	290	67.52	720	440	61.1	720	304	42.22	1010	570	56.39	430	250	57.93	460	210	45.65	464	300	64.66	460	250	54.35	5000	3404	68.1
"Dëshmorët e Vitisë"	87	3290	2020	61.40	1450	940	64.83	2420	1520	62.8	2420	1412	58.35	3290	2160	65.65	1450	750	51.72	1640	850	51.83	1640	850	51.83	1640	850	51.83	19400	11183	57.6
"Mëkë Abdona"	42	1470	881	60.00	630	387	61.43	1050	530	50.4	1050	570	54.29	1470	770	52.38	630	371	58.89	714	321	45.10	714	321	45.10	714	321	45.10	3400	4701	58
"Niveli Shtet"	21	720	440	61.11	310	190	61.3	520	310	59.6	520	260	50.0	720	320	44.44	310	170	54.84	350	141	40.3	350	141	40.3	350	141	40.3	4200	2254	53.7
"Dëshmorët e Lulës"	34	940	456	48.51	300	150	50.0	450	210	46.7	450	210	46.7	940	450	47.87	300	150	50.0	450	210	46.7	450	210	46.7	450	210	46.7	4200	2254	53.7
"28 Nëntori"	41	1400	730	52.14	670	350	52.1	1020	550	53.9	1020	500	49.0	1400	730	52.14	670	350	52.1	1020	500	49.0	1020	500	49.0	1020	500	49.0	4800	2572	53.6
"Skender Ferri"	14	400	250	62.50	210	110	52.38	350	180	51.4	350	180	51.4	400	250	62.50	210	110	52.38	350	180	51.4	350	180	51.4	350	180	51.4	1800	920	51.1
"Shkollë Jeta"	64	2240	1380	61.56	960	580	60.4	1440	870	60.4	1440	770	53.5	2240	1380	61.56	960	580	60.4	1440	870	60.4	1440	870	60.4	1440	870	60.4	5200	4223	81.2
"Dëshmorët e 1 Prillit"	21	1200	740	61.67	560	320	57.14	820	470	57.3	820	400	48.78	1200	740	61.67	560	320	57.14	820	400	48.78	820	400	48.78	820	400	48.78	3800	1401	36.9
"Klari Kosovë"	50	1820	1074	59.01	780	460	59.0	1260	740	58.7	1260	610	48.4	1820	1074	59.01	780	460	59.0	1260	610	48.4	1260	610	48.4	1260	610	48.4	4800	3000	62.5
"Dona Mëkë Tashari"	9	280	150	53.57	120	60	50.0	200	100	50.0	200	100	50.0	280	150	53.57	120	60	50.0	200	100	50.0	200	100	50.0	200	100	50.0	1800	720	40.0
"Shtëpi Kosovë"	9	280	130	46.43	120	50	41.67	200	100	50.0	200	100	50.0	280	130	46.43	120	50	41.67	200	100	50.0	200	100	50.0	200	100	50.0	1800	720	40.0
"Haxhi Aliu"	10	630	330	52.38	270	120	44.4	390	180	46.2	390	180	46.2	630	330	52.38	270	120	44.4	390	180	46.2	390	180	46.2	390	180	46.2	1800	800	44.4
"Haxhi Tashari"	20	800	360	45.00	340	140	41.2	520	210	40.4	520	210	40.4	800	360	45.00	340	140	41.2	520	210	40.4	520	210	40.4	520	210	40.4	1800	800	44.4
"Haxhi Mëkë"	40	1520	750	49.34	640	270	42.19	1070	500	46.7	1070	500	46.7	1520	750	49.34	640	270	42.19	1070	500	46.7	1070	500	46.7	1070	500	46.7	4800	2300	47.9
<b>Total</b>		879	2020	230.0	1070	490	45.8	1450	700	48.3	1450	690	47.6	3020	1520	50.3	1070	590	55.1	4200	2100	50.0	4200	2100	50.0	4200	2100	50.0	19800	9812	49.6

### Fillimi i vitit të ri shkollor 2023/24

- Viti shkollor 2023/24 ka filluar më 01.10.2023;
- Komuna e Vitisë me gjithsej 17 shkolla fillore të mesme të ulëta amë si dhe 17 paralele të ndara, 3 shkolla të mesme të larta e katër çerdhe për fëmijë (dy publike dhe dy private), ka gjithsej 7028 nxënës, duke përfshirë këtu edhe çerdhet.
- Staf i qenë i përgaditur në fillim të vitit shkollorë 2023/24 për fillimin e mësimin, ku të angazhuar kanë qenë për këtë vit shkollor: në çerdhet publike, 11 edukatore të rregullta dhe 4 edukatore me kontratë bashkëpunim me Caritasin KosovLuxemburg, 1 logopede, 2 administratë, 4 punëtorë teknik pastruese, 4 kuzhinierë. Për mësimin parafillor, arsimi fillor, arsimi i mesëm i ulët janë të angazhuar 508 mësimdhënës të rregullt dhe 27 zëvendësime, pushime mjekësore; arsimi i mesëm i lartë 145 mësimdhënës të rregullt

- dhe 4 zëvendësime; janë të angazhuar 5 asistent për fëmijë me nevoja të veçanta, 5 mësues mbështetës, 13 psikolog, 4 prej tyre me Caritas Kosovë Luxemburg, 30 punëtor të administratës, 70 punëtor teknik.
- Gjatë kësaj pjese të vitit shkollor 2023/24 procesi mësimorë është mbajtur në mënyrë të rregullt në vështersi të lëndës së fizikës, teknologjisë me TIK dhe matematikë në disa shkolla ku në konkursin e rregullt kemi pasur mungesë dhe jemi detyruar që të rishpallim konkurse dhe kemi humbur disa orë të mësimi.
  - Angazhimi i psikologeve, mësuesve mbështetës dhe asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta na ka ndihmuar shumë në gjithëpërfshirjen edhe të fëmijeve me nevoja të veçanta në klasë të rregullta, ekipa vlerësuese në kuadër të DKA-së është duke funksionuar shumë mirë për përfshirjen edhe të kësaj kategorie në shkolla të rregullta. Kjo pjesë është për tu vlersuar pasi që Komuna e Vitisë në kuadër republikan është më e mira sa i përket këtij stafi në shkolla dhe gjithëpërfshirjes.

### **Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve**

Në kuadër të planifikimeve të DKA-së për zhvillim profesional të mësimitdhënësve në bashkëpunim me MASHT-in, OJQ dhe donatorë të ndryshëm kemi organizuar disa trajnime për mësimitdhënës;

- Është mbajtur trajnimi i shtatë mësimitdhënësve në kuadër të pilot projektit për nxënësit me aftësi të kufizuara, organizuar nga MASHT, UNICEF dhe IDRA;
- Ngritja e kapaciteteve të shkollave në lidhje me përdorimin e përmbajtjeve digjitale për qëllime kreative dhe edukative;
- Trajnim për kompjuter;
- Kryqi i Kuq;
- Kanë përcjell disa trajnime të organizuar nga SBASHK-u;
- MASHT "Edukimi Seksual Gjithëpërfshirës sipas Kurrikulës së Kosovës për Mësimitdhënës";
- MASHT "Gjithëpërfshirja dhe Individualizimi i Mësimi për Nxënësit me Nevoja të Veçanta Arsimore (PIA)" nëntor;
- IDRA, çertifikatë për pjesëmarrje, nëntor 2022;
- Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimitdhënie Word 2013, Excel 2013, PowerPoint 2013;
- Vlerësimi kolegu kolegen;
- Vlerësimi i brendshëm i shkollës;
- Ngritja e kapaciteteve arsimore në shkolla.

### **Aktivitetet të ndryshme të zhvilluara në shkolla gjatë periudhës Janar-dhjetor 2023**

Në mesin e shumë aktiviteteve që janë zhvilluar në shkollat e Komunës së Vitisë, disa nga më të rëndësishme i kemi listuar si më poshtë:

- **Garat e ditorisë:** Janë mbajtur në nivel shkolle, janë mbajtur në të gjitha shkollat fillore (1-55) Garat e di me pikturë si dhe garat me Ese, niveli 6-9 janë mbajtur. Përveç garave në shkollë janë mbajtur edhe kom
- Garat e robotikës (kodimi)
- **Garat sportive** janë mbajtur edhe në nivel regjional, ku shkollat e Vitisë kanë zënë vende të mira:
  - Garat në nivel të komunës u mbajtën në shah;
  - Garat komunale në pingpong;

- Garat regjionale të pingpongut, nxënësit zënë vendin e tretë;
- Garat në futboll për djemë dhe vajza;
- Nxënëset arritën të zënë vendin e dytë në garat regjionale të futbollit;
- Nxënëset në garat komunale të volejbollit arritën të zënë vendin e dytë;
- Garat regjionale të hendbollit;
- Garat e projektit "Girls just want to play football" dhe shumë aktivitete të tjera.

### **Aktivitete të ndryshme jashtkurrikulare**

- Java për promovim të leximit, aktivitete të ndryshme;
- Aktivitete për nder të Pavarësisë së Kosovës;
- Aktivitete për Ditën Botërore të Mjedisit;
- Dita Botërore e Njerëzve me Sindrom Down;
- Edukimi medial;
- Zhvillimi inovativ për avancimin e arsimit në Kosovë;
- Vizitë në kampin Boonsteal;
- Grupi i artistëve - murale në shkolla;
- Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut;
- Shënimi i Ditës Botërore të Personave me Nevoja të Veçanta;
- Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve;
- Dita Botërore Kundër Dhunës ndaj Gruas;
- Ligjerata "dhuna në familje dhe dhuna ndaj fëmijëve";
- Aktivitet për termete, dita e shkollës, muralet e shkollës në koridore;
- Aktivitet me temën "Braktisja e Shkollimit", organizuar nga anëtari i EPRBM-së në nivel shkolle;
- Nga këshilli i nxënësve u prezantua tema "Bullizmi", me klasët e IX;
- IDRA Research & Consulting mbledhën të dhëna nga mësimdhënësit dhe prindërit e klasëve të II, III dhe të VI për CFM (Modulin e Funkionimit të Fëmijëve) dhe modulin gjithëpërfshirës;
- Aktivitete për Festën e Pavarësisë së Kosovës;
- Youth Initiative for Human Rights, mbajti ligjëratë me 70 nxënës të klasëve të teta dhe nënta, pjesë e projektit "Fuqizimi i të Rinjëve – Përmirësimi i Sundimit të Ligjit dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut" mbështetur nga misioni i EULEX-it në Kosovë;
- Të shpëtojmë natyrën – Espozitë;
- Gatujmë për bamirësi;
- Aktivitet për 1 Qershorin - Dita Botërore për të Drejtat e Fëmijëve.

### **Shërbimi psikologjik**

#### **Psikologia në DKA**

- Evidentimi i rasteve që kanë nevojë për shërbim psikologjik;
- Evidentimi dhe vlerësimi psiko - fizik i fëmijëve, të cilët do të fillojnë klasën e parë në shtator, të rekomanduar nga shkollat përkatëse;
- Punë në vazhdimsi me seanca individuale e grupore, duke e përfshirë këshillimin psikologjik, psikoedukimin etj.
- Takime të rregullta me ekipin për vlerësim pedagogjik;

- Fuqizimi i ekipit për vlerësim pedagogjik për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, duke u bazuar në formularët e KNF-së;
- Vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Rivlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- Takime me mësimdhënësit dhe ndihmë rreth planit individual të arsimit;
- Takime me trajnerët për kurrikulë;
- Vlerësimi i dosjeve të mësimdhënësve, të cilët e kanë përfunduar trajnimin për kurrikulë në vitin shkollor 2022/23;
- Çertifikimi i mësimdhënësve të cilët e kanë përfunduar trajnimin për kurrikulë;
- Bashkëpunim me QPS-në;
- Bashkëpunim me MASHT-in;
- Prezentim në takime, seminare e trajnime të ndryshme.

#### Psikologët në shkolla (Temat të cilat janë zhvilluar në shkolla)

- Sjellje problematike dhe pengim i ores mesimore;
- Vonesa në zhvillim intelektual dhe çrregullime të tjera;
- Vështirësi në të nxënë;
- Këshillim psikoemocional dhe motivues;
- Mungesat e nxënësve;
- Këshillim mbi sjelljen dhe ndërtimin e raporteve të mira shoqërore;
- Rëndësia e bashkëpunimit familje-shkollë;
- Konsultime individuale me prindërit për qasjen ndaj fëmijëve me vështirësi të ndryshme;
- Këshillim dhe bashkëbisedim me stafin e shkollës për mënyrën e sjelljes me nxënës të ndryshëm problematik dhe me çrregullime të ndryshme emocionale dhe të sjelljes;
- Ligjeratë - Sindromi Down;
- Ligjeratë - personat me aftësi të kufizuara;
- Ligjerarata në klasë me temë, stresi dhe menaxhimi;
- Ligjeratë me temë: "Shëndeti mendor", përfshirë edhe rolin e psikologut dhe bullizmin;
- Ligjeratë vetëdijësuese: 20 nëntori "Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve", ligjeratë e mbajtur me kl. VI, VII, VIII dhe IX;
- Ligjeratë vetëdijësuese: "Parandalimi i dhunës ndaj gruas", ligjeratë e mbajtur me kl.VIII dhe IX;
